

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

FAKULTETI JURIDIK



TEMA E MAGJISTRATURES

TEMA: KUNDËREKZAMINIMI SIPAS LIGJIT TË RI TË PROCEDURËS PENALE NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË

KANDIDATI: ARMEND ILIJAZI

MENTOR: PROF DR BESA ARIFI

TETOVË 2019

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I. KUNDËREKZAMINIMI SIPAS LIGJITË RI TË PROCEDURËS PENALE

1. SHQYRTIMI KRYESOR

1.1. Vërejtje hyrëse

1.2. Procedura penale akuzatore

2. ROLI I PALËVE DHE I GJYQIT NË SHQYRTIMIN KRYESOR

3. TË PYETURIT E DREJTPËRDREJTË, TË KRYQËZUAR DHE PLOTËSUES

3.1. Vërejtje të përgjithshme

3.2. Të pyeturit e drejtpërdrejtë

3.3. Të pyeturit e kryqëzuar/kundërekzaminimi

3.4. Të pyeturit plotësues

3.5. Marrja në pyetje e të akuzuarit

3.6 Teknikat e kundërekzaminimit

4. SHQYRTIMI KRYESOR SIPAS LPP

4.1. Fillimi i shqyrtimit kryesor

4.2. Procedura dëshmuese

4.3. Fjalët përfundimtare dhe përmbyllja e shqyrtimit të parë

5. RREZIQET

KAPITULLI II. MARRJA E DËSHMITARËVE NË PYETJE TË DREJTPËRDREJTA, TË KRYQËZUARA DHE PLOTËSUESE

1. HYRJE

2. ANGLIA DHE UELLSI (BRITANIA E MADHE)

2.1. Hyrje

2.2. Pyetjet e drejtpërdrejta

2.3. Dëshmitarët armiqësor

2.4. Deklaratat e përputhshme paraprake

2.5. Rifreskimi i kujtesës

2.6. Kundërekzaminimi/Pyetjet e kryqëzuara

2.7. Pyetjet plotësuese

2.8. Pyetjet e gjykatësit ose të jurisë

3. ITALI

3.1. Hyrje dhe përshkrim

3.2. Procedura paraprake

3.3. Seanca gjyqësore në përgjithësi

3.4. Marrja në pyetje të drejtpërdrejta

3.5. Pyetjet e kryqëzuara

3.6. Pyetjet plotësuese

4. BOSNJA E HERCEGOVINA

4.1. Hyrje dhe përshkrim

4.2. Seanca gjyqësore

4.3. Marrja në pyetje të drejtpërdrejta

4.4. Pyetjet e kryqëzuara

4.5. Pyetjet plotësuese

5. GJYKATAT DHE TRIBUNALET NDËRKOMBËTARE PENALE

5.1. Hyrje dhe përshkrim

5.2. Tribunali ndërkombëtar për krime për Ish-Jugosllavinë

5.3. Tribunali ndërkombëtar për krime

5.4. Gjykata evropiane për të drejtat e njeriut

KUNDËREKZAMINIMI - DORACAK PËR PROFESIONISTËT

KAPITULLI III. UDHËZIME MBI TË PYETURIT E KRYQËZUAR

1. BAZAT E MARRJES SË KRYQËZUAR NË PYETJE

1.1. Hyrje

1.2. Përgatitja

1.3. Qasja e përgjithshme ndaj pyetjeve të kryqëzuara

1.4. Fushëveprimi i marrjes së kryqëzuar në pyetje

1.5. Bazat e marrjes së kryqëzuar në pyetje

1.6. Ndërtimi i rrëfimit nga pyetjet e kryqëzuara

1.7. Konkluzioni

2. ZHVLERËSIMI/DISKREDITIMI I DËSHMITARIT

2.1. Udhëime për diskreditim dhe rehabilitim dëshmitarësh

2.2. Mostër diskreditimi – para dhënies së një deklarate joadekuate

2.3. Konkluzioni

3. VËREJTJE PËR ROLIN E GJYKATËSIT

4. REGJISTRI PËR MARRJEN NË PYETJE TË KRYQËZUAR

5. KUNDËRSHTIMET GJATË GJYKIMIT

6. DHJETË URDHËRAT E KUNDËREKZAMINIMIT

LITERATURA

Aspekti teorik

Kunderekzaminimi është një komponente kyçe në një gjykim dhe kesaj teme i kushtohet vëmendje e konsiderueshme gjatë proesit gjyqësor. Mendimet e një jurie apo gjyqtari ndryshohen shpesh gjatë shqyrtimit të kryqëzimit, nëse dyshohet në dëshminë e dëshmitarit.

Definicioni dhe qëllimi kryesor i kunder ekzaminimit

Kunderekzaminimi perkufizohet si metode qe avokatet perdorin per te marre informacion nga nje dëshmitar. Informacioni qe jep dëshmitari eshte dëshmi. Gjate marrjes ne pyetje avokati do t'i kerkoj dëshmitarit pergjigje qe kane te bejne me rastin qe do te gjykohet.

Qellimet kryesore te kunder ekzaminimit jane te nxjerrin fakte te favorshme nga dëshmitari, ose te kerkojne besueshmerine e dëshmitarit dëshmuar per te zvogluar peshen e dëshmise se pafavorshme.

Kunderekzaminimi shpesh prodhon prova kritike në gjykime, veçanërisht nëse një dëshmitar është në kundërshtim me dëshmitë e mëparshme.

1. SHQYRTIMI KRYESOR

1.1. Vërejtje hyrëse

Reforma e shqyrtimit kryesor me qëllim të ngritjes së saj në stad qendror të procedurës paraqet aspekt të rëndësishëm në konceptin e ri të procedurës penale gjatë së cilit në mënyrë kundërshtuese dhe nëpërmjet aktiviteteve të palëve do të prezantohen dëshmitë dhe në bazë fakteve të vërtetuara relevante juridike, edhe atë pas vlerësimit të dëshmimeve të prezantuara, gjyqi do të sjellë aktgjykim të drejtë dhe ligjor.

Shqyrtimi kryesor karakterizohet me rol dominant të gjyqit i cili kishte për obligim ta vërtetojë të vërtetën materiale, marrjen në pyetje të akuzuarit, marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe të ekspertëve, e bile edhe prezantimin e dëshmimeve sipas detyrës zyrtare, të cilat palët aspak nuk i kanë propozuar. Tendencë për ridefinim të esencës së shqyrtimit kryesor rrjedh nga konstatimet se në procedurën ekzistuese penale shqyrtimi kryesor në vend që të jetë në vend qendror të procedurës, në praktikë u shndërrua në stad kontrollues ku kontrollohet e gjithë ajo që është ndërmarrë gjatë hetimit, me ç'rast trupi gjyqësor formon qëndrim sa i përket fajit dhe sanksionit eventual penal në bazë të akteve të lëndës që janë formuar gjatë hetimit.

Në Ligjin e ri të procedurës penale,¹ shqyrtimi kryesor merr karakteristika akuzatore, bazohet në aktivitete të palëve që propozojnë dhe prezantojnë dëshmi, me ç'rast gjykimi zhvillohet si kontest gjyqësor në mes të palëve me kundërshtitë të theksuar. Me shqyrtimin kryesor të vendosur

¹ "Ligji ekzistues" i referohet Ligjit për procedurë penale të vitit 1997 me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme, ndërsa „Ligji i ri“ për Procedurë Penale i referohet Ligjit për Procedurë Penale i cili u soll në vitin 2010.

në këtë mënyrë, gjyqi është i liruar nga obligimi për të vërtetuar të vërtetën materiale që çon kah braktisja e elementeve inkuizitore të cilat krijojnë obligim që gjyqi me vetiniciativë të propozojë dëshmi. Nga kjo del se barra e dëshmimit në konceptin e ri bie mbi palët, me ç'rast prokuroria ka për obligim që fajin ta dëshmojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.

Megjithatë, duhet të potencohet se shqyrtimi kryesor nuk është pastër akuzator, pasi që gjyqi e ruan funksionin udhëheqës dhe kontrollues që është me rëndësi për zhvillimin e papenguar të gjykimit, vendosjen për kundërshtimet gojore të palëve, parashtrimin e pyetjeve qartësuese personave që merren në pyetje, mbajtjen e rendit dhe disiplinës në gjykatë e të ngjashme.

Njëkohësisht, ndikimi i hetimit mbi shqyrtimin kryesor, në konceptin e ri dukshëm është zvogëluar me pamundësinë që gjyqi të ketë qasje në veprimet që i kanë ndërmarrë palët gjatë procedurës hetimore, gjegjësisht gjatë veprimeve hetimore të mbrojtjes, pasi që trupi gjykues nuk ka qasje në aktet që përmbajnë deklaratat, gjegjësisht njoftime nga persona me të cilat kanë kontaktuar palët, por ka qasje vetëm në procesverbalet me deklaratat të dhëna në seancë dëshmuese dhe dëshmi materiale të dorëzuara në favor të akuzës.

Si karakteristika më të rëndësishme të shqyrtimit kryesor do të mund të përmendeshin: ▪ braktisja e obligimit që gjyqi ta vërtetojë të vërtetën materiale dhe të mbledhë dëshmi sipas obligimit zyrtar, ▪ futja e elementeve akuzatore (të palëve) në kushte kur ka mungesë të porotës klasike, ▪ aktivitetet të palëve përkundëjt pasivitetit të gjyqit në procedurën dëshmuese, ▪ potencimi i drejtësisë procedurale në vend të vërtetimit të së vërtetës materiale, ▪ mundësi më të mëdha për barabarësi të armëve dhe kundërshtim i theksuar.

1.2. Procedura penale akuzatore

Qëllimi i reformës në pjesën e shqyrtimit kryesor është përpilimi i procedurës penale moderne, në të cilën do të respektohen të drejtat dhe liritë e njeriut, mirëpo e cila njëkohësisht do të jetë mjaft efikase dhe do të mundësojë shkarkim të gjyqit nga obligimi sipas detyrimit zyrtar që vetë ta zbardhë rastin.

Forma akuzatore e procedurës penale bazohet në rolin aktiv të palëve në mbledhjen dhe prezantimin e dëshmive. Procedura kundërshtuese akuzatore implementohet nëpërmjet konceptit të kundërekza-minimit (respektivisht të pyeturit të kryqëzuar), pasi që ky lloj i procedurës mund realizohet me sukses vetëm nëse ekziston përgatitje solide e palëve për gjykim, prezantim i aftë dhe i qartë i rastit para gjyqit, marrja në pyetje e dëshmitarëve të cilët vetë i kanë propozuar, mirëpo edhe të pyeturit e kryqëzuar e dëshmitarëve që i ka propozuar pala kundërshtare, parashtrimi në kohë i kundërshtimeve ndaj pyetjeve të parashtruara, përcjellje aktive e gjithë asaj që ndodh në gjykatë. Me fjalë të tjera, të pyeturit e kryqëzuar paraqet pjesë të gjykimit kur

mbrojtësi i pyet dëshmitarët e propozuar nga pala tjetër dhe të pyeturit e kryqëzuar duhet të kuptohet si stad i procedurës, e jo vetëm si metodë e marrjes në pyetje.²

Procedura akuzatore mundëson kundërshti të theksuar, barazi të mundësive procedurale të palëve gjatë procedurës, transparencë dhe procedurë të drejtpër– drejtë, si dhe ballafaqim të argumenteve, në ç'mënyrë mundësohet vërtetimi i fakteve relevante juridike të cilat janë të rëndësishme për sjelljen e akgjykimit ligjor dhe të drejtë.

Si vërejtje ndaj llojit të përzier të procedurës gjyqësore theksohet pamundësia e përcaktimit të së vërtetës materiale si dhe pranimi i instituteve anglosaksone ka për pasojë kthimin e fokusit prej të vërtetës kah drejtësia procedurale. Teoritë që insistojnë në drejtësi nisen nga ajo se gjykimet nuk janë mënyrë e sigurt për ta zbuluar të vërtetën, pasi që e vërteta për atë se çka ka ndodhur në të vërtetë shpesh nuk mund të merret vesh, e prandaj është shumë me rëndësi që të sigurohet procedurë e drejtë për zgjidhje të kontesteve penale.³

Koncepti i cili e preferon drejtësinë procedurale e potencon kundërshtimin si metodë të prezantimit të tezave të prokurorisë dhe të mbrojtjes, me ç'rast e vërteta më së miri do të zbulohet nëse iniciativa për zbulimin dhe prezantimin e dëshmive u lihet palëve, ndërsa vlerësimi i dëshmive i besohet gjyqit i cili do të ketë rol të vlerësuesit dhe gjykuesit pasiv dhe të paanshëm.

Gara akuzatore para gjyqit është një lloj i veçantë i lojës në të cilën jo gjithmonë fiton e vërteta. Prandaj thuhet se sistemet akuzatore fokusohen te dëshmitë, ndërsa ato kontinentale te e vërteta.⁴

Megjithatë, përmenden vërejtje dhe rreziqe të cilat paraqiten edhe te procedura akuzatore - sistemet akuzatore me pjesëmarrjen e theksuar të palëve në dëshmimin e rastit të tyre kanë problemet e tyre në përcaktimin e të së vër te tës, qoftë për shkak se, njëra apo të dyja palët, mund me qëllim të fshehin dëshmi relevante për arsye taktike, apo për shkak se njëra palë (zakonisht i akuzuari) mund të ketë qasje joadekuate te mjetet dhe dija eksperte që kërkohen si baraspeshë ndaj argumenteve të palës tjetër.⁵

Koncepti i drejtësisë nënkupton gjykim në të cilin dëshmitë që i nënshtrohen testimi kundërshtues do të prezantohen para gjyqit të paanshëm. E drejta e të akuzuarit për procedurë të drejtë në këtë mënyrë është e drejtë për të pasur mundësi të ndershme për t'u mbrojtur ndaj akuzave shtetërore.⁶ Nga ana tjetër, e drejta për prezantim nga ana e mbrojtjes e avancon dhe e

² Marcus Stone, *Cross-examination in Criminal Trials*, Tottel Publishing, 2009, Marcus Stone, *Cross-examination in Criminal Trials*, Tottel Publishing, 2009, fq.1.

³ Dr. Gordan Kallajxhiev, *Futja në përdorim e procedurës penale të akuzës me të pyeturit e kryqëzuar*, RMDPK, TNK. 2/2009, fq. 285-312.

⁴ Kallajxhiev/ Raiçeviq-Vučkova/ Dimitrovski/ Vitanov/ Trajanovska, *Rirregullimi i shqyrtimit kryesor në Republikën e Maqedonisë*, RMDPK, 2-3/2008, fq. 213-234.

⁵ Shih: J. McEVAN, *Adversarial and Inquisitorial Proceedings*, во: R. BULL/ D. CARSON (Eds.) *Handbook of Psychology in Legal Contexts*, Wiley, Chichester, 1995.

⁶ Shih: *Chambers v. Mississippi*, 410 U.S. 284, 294-95.

nxit kërkimin e të së vërtetës,⁷ ndërsa nevoja që të zhvillohen dhe të prezantohen faktet, konsiderohen si çështje fundamentale për integritetin dhe besueshmërinë e publikut në legjisllacionin penal.⁸

2. ROLI I PALËVE DHE I GJYQIT NË SHQYRTIMIN KRYESOR

Koncepti i ri i shqyrtimit kryesor supozon rol aktiv të palëve nga të cilat kërkohet jo vetëm dije, por edhe përvojë, aftësi, mendjemprehtësi, precizitet dhe bindshmëri në përgatitjen dhe prezantimin e dëshmive para gjyqit. Është shumë me rëndësi të theksohet se të pyeturit e kryqëzuar kërkun respektim të rregullave për lejueshmëri dhe relevancë të dëshmive, pa marrë parasysh se për cilën palë në procedurë bëhet fjalë.⁹ Prandaj, teza e ndjekjes, gjegjësisht e mbrojtjes, mund të bazohet vetëm në dëshmitë të cilat gjyqi i ka lejuar si relevante dhe me respektim të rregullave procedurale për propozim dhe prezantim të dëshmive. Kjo është e nevojshme që pala të mund ta ndërtojë rastin e saj në mënyrë të drejtë, mirëpo poashtu që edhe t'u kundërvihet me kohë dhe në mënyrë të drejtë veprimeve që i propozon, gjegjësisht që i ndërmerr pala kun-dërshtare.

Modeli i procedurës akuzatore me të pyeturit e kryqëzuar kërkun nivel të lartë të etikës profesionale të palëve në procedurë, që del nga kodekset e sjelljes, të traditës dhe të praktikës.¹⁰

Prokuroria ka rol dukshëm të ndryshuar sipas sistemit të ri të procedurës penale. Nga ajo pritet që të jetë organ udhëheqës gjatë procedurës hetimore në krahasim me organet e tjera me autorizime hetuese, ndërsa gjatë procedurës të jetë palë aktive, obligimi kryesor i së cilës është që ta dëshmojë fajin. Prokuroria e ka barrën e dëshmimit të fajit dhe obligimin që të zbulojë, të propozojë dhe të prezantojë dëshmi me të cilat dëshmohet faji i të akuzuarit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Nga aspekti i etikës profesionale të prokurorëve, është shumë me rëndësi që ata ta paraqesin rastin me qëllim që t'i nduhmojnë gjyqit që të sjellë aktgjykim të drejtë, e jo prezantimi i rastit të jetë i orientuar kah sjellja e aktgjykimit ndëshkues.¹¹

Në funksion të dëshmimit të fajit, prokuroria mbledh dëshmi materiale, bisedon me dëshmitarë potencialë, ndërmerr ekspertizë gjatë procedurës hetimore, propozon mbajtje të seancës dëshmuese nëse vlerëson se janë plotësuar kushtet për një gjë të tillë të cilat i parasheh LPP, ndërsa dëshmia është me rëndësi të veçantë për “tezën e akuzës”.

Roli aktiv që pritet nga prokuroria supozon profesio-nalizim të prokurorëve për marrje në pyetje të perso-nave gjatë shqyrtimit kryesor. Kjo është posaçërisht me rëndësi, pasi që në sistemin e deritanishëm, marrjen në pyetje për nevojat e prokurorisë, në masën më të madhe, e bënte gjyqi.

⁷ Shih: Taylor v. Illinois, 484 U.S., 400, 408-09.

⁸ Shih: United States v. Nixon, 418 U.S. 683, 709 (1974).

⁹ Stone, citat, fq. 2.

¹⁰ Stone, citat, fq. 2.

¹¹ Stone, citat, fq. 3.

Sistemi i ri i shqyrtimit kryesor kërkon nga prokurori ndërtim të rastit nëpërmjet përgjigjeve të marra nga dëshmitarët dhe ekspertët, që paraqet aftësi në formulimin e pyetjeve dhe sistematizimin e tyre në një tërësi koherente, mirëpo poashtu edhe përgatitje solide për t'u ndërlidhur me pyetjet e përgjigjeve të marra më herët, por megjithatë në kuadër të konceptit të përgatitur të pyetjeve që duhet të parashtrohen.

Prokuroria, gjithashtu, duhet të luajë rol të suksesshëm gjatë të pyeturit të kryqëzuar të dëshmitarëve të mbrojtjes duke i shfrytëzuar anët e dobëta të “tezës së mbrojtjes” të cilat i ka vërejtur prokurori gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë të dëshmitarit nga mbrojtësi. Prokurori duhet të jetë i vetëdijshëm se dështimi i tij që ta vërtetojë fajin, gjegjësisht dështimi për të prezantuar dëshmi bindëse para gjyqit, çon drejt sjelljes së aktgjykimit lirues, që do të thotë dështim absolut i prokurorisë.

Mbrojtja duhet të jetë e përgatitur jashtëzakonisht mirë që t'i kontestojë thëniet e prokurorisë, t'i diskreditojë dëshmitarët e prokurorisë gjatë të pyeturit të kryqëzuar, të zbulojë dhe të propozojë dëshmi me të cilat do ta mbështesë “tezën e mbrojtjes”. Mbrojtja duhet të vlerësojë se a do të bëjë pranim të fajit, a do të propozojë, gjegjësisht a do të pranojë iniciativë për të filluar procedurën për marrëveshje për pranim të fajit me prokurorin publik, respektivisht a do të paraqitet i akuzuari në rolin e dëshmitarit në rastin e tij personal.

Mbrojtja do të duhet me kohë, në mënyrë të suksesshme dhe efikase të ndërmarrë veprime hetimore në dobi të mbrojtjes, të përgatitet për kundërvënie të argumenteve ndaj rastit që e ka prezantuar prokuroria.¹²

Duke e respektuar etikën profesionale, mbrojtësi duhet të përmbahet dhe të mos prezantojë dëshmi të rrejshme/të pavërteta, gjegjësisht të mos kontestojë dëshmi të vërteta të cilat i ka prezantuar prokurori.

Edhe nga mbrojtësi pritet që të bëjë realizim të suksesshëm, fillimisht të të pyeturit të drejtpërdrejtë, e pastaj edhe të të pyeturit të kryqëzuar. Do të jetë shumë me rëndësi që avokati t'i “gjuajë” gabimet e prokurorisë, ta shfrytëzojë pasigurinë e dëshmitarëve të prokurorisë, me ndihmën e këshilltarëve teknikë ta zvogëlojë vlerën dëshmuuese të ekspertizës që nuk është në favor të të akzuarit, të bëjë kun dërshtime gojore posa të konsiderojë se është parashtuar pyetje e palejueshme, apo se nga dëshmitari kërkohet mendim e jo perceptim dhe të ngjashme.

Për herë të parë, gjyqido të njihet me rastin gjatë shqyrtimit kryesor, duke pasur parasysh procedurën hetimore jokundërshtuese. Gjyqi është arbitër pasiv i cili do ta përcjellë prezantimin e dëshmimeve që i kanë propozuar palët e ai i ka pranuar, do të kujdeset për udhëheqje korrekte të procedurës, për rend dhe disiplinë në gjykatë, për respektim të autoritetit dhe dinjitetit të pjesëmarrësve në procedurë. Me afirmimin e të akzuarit si subjekt aktiv me të drejta të

¹² Stone, citat, fq. 3.

fuqishme gjatë procedurës, gjyqi u lirua nga raporti paternalist ndaj të akuzuarit, me ç'rast gjyqi duhet të aktivizohet vetëm atëherë kur mbrojtja do të tregohet e paaftë në rolin e saj.

Gjyqi tanimë nuk e ka për obligim të propozojë dhe të prezantojë dëshmi, mirëpo LPP parasheh vetëm një mundësi, kur pas përfundimit të procedurës dëshmuese, e me propozim të palëve apo sipas detyrës zyrtare, gjyqi mund të urdhërojë super ekspertizë me qëllim të eliminimit të kundërthënieve në konstatimet dhe mendimet e ekspertëve apo profesionistëve, të dhëna gjatë procedurës dëshmuese. Ky përjashtim është paraparë me qëllim që të eliminohen kundërthëniet e vërejtura në konstatimet e ekspertëve dhe profesionistëve, por jo edhe në deklaratat e dëshmitarëve. Të gjitha aspektet e përmendura që e definojnë rolin e gjyqit, mund të numërohen në njërin nga funksionet e mëposhtme të gjyqit: ▪ kontrollues – kujdeset për parashtrimin dhe prezantimin e ligjshëm të dëshmive, vendos për pyetjet dhe kundërshtimet e lejuara dhe të palejuara të palëve, ▪ udhëheqës – pranon propozime të dëshmive nga palët, vendos për fuqinë e tyre dëshmuese dhe udhëheq me procesin e prezantimit të tyre, ▪ garantues – kujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore edhe të të akuzuarit edhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë.¹³

3. TË PYETURIT E DREJTPËRDREJTË, TË KRYQËZUAR DHE PLOTËSUES

3.1. Vërejtje të përgjithshme

Me qëllim që të fitohet një pasqyrë e plotë për mënyrën e marrjes në pyetje, për do methënien dhe thelbin e të pyeturit të kryqëzuar, duhet të arsyetohen tre format e mundshme të marrjes në pyetje të cilat plotësohen në mes vete dhe përbëjnë një tërësi. Për shkak të rolit aktiv të palëve gjatë marrjes në pyetje, të tre format duhet të analizohen dhe të arsyetohen nga aspekti i rolit të prokurorit dhe të mbrojtësit.

Me qëllim që marrja në pyetje të jetë e suksesshme, duhet që secila palë ta përgatisë dëshmitarin e saj për të pyeturit e drejtpërdrejtë, e posaçërisht për të pyeturit e kryqëzuar, e cila është e rëndësishme për kredibilitetin e dëshmitarit si personalitet, mirëpo edhe për vlerën dëshmuese të deklaratës së dhënë. Gjatë kësaj, nga dëshmitari nuk pritët që të japë deklaratë të rrejshme, të thotë gjëra të pavërteta në dobi të palës që e ka propozuar, por duhet që ai të përgjigjet në mënyrë precize në pyetjet gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë, të jetë i sigurt dhe i qetë, të mos hutohet gjatë të pyeturit të kryqëzuar, të mos tregojë pasiguri, jokonsekuencë në deklaratë e të ngjashme.

Duhet të theksohet aftësia e palëve që pyetjet të cilat i parashtrojnë të ndërlidhen me atë që e ka thënë paraprakisht personi i cili merret në pyetje, e megjithatë ato të jenë në kontekst të pyetjeve të përgatitura më parë, që e shtjellojnë dhe e vërtetojnë tezën që e përfaqëson vet pala, të koncentrohen në një aspekt, e pasi ai aspekt të vërtetohet, të sqarohet dhe të elaborohet detajisht,

¹³ Kallajxhiev/Raiçeviq-Vučkova/Dimitrovski/Vitanov/Trajanovska, Rirregullimi i shqyrtimit kryesor në RepublikëneMaqedonisë, citat.

të kalohet në pyetje që ndërlidhen me ndonjë aspekt tjetër të ngjarjes që shkon në favor të palës e cila pyet.

Palët duhet të jenë dëgjues të kujdesshëm që të jenë pyetës të mirë. Kjo do të thotë se duhet me kujdes të veçantë të përcillen përgjigjet që i jep personi gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë, i cili zhvillohet si tregim i perceptimeve që i ka dëshmitari për ngjarjen, që të mund të përpilohen pyetjet sugjestive gjatë të pyeturit të kryqëzuar.

Palët duhet të mësohen që të mos manifestojnë emocione gjatë marrjes në pyetje si për shembull, nervozë, shpejtim, padurim që të dëgjohet dëshmitari deri në fund, hutë, skuqje, harresë, mospërgatitje e të ngjashme.

Nga ana tjetër, duhet të dihet si të shfrytëzohen këto manifestime të dëshmitari, posaçërisht kur ai hutohet, kur mundohet të mos japë përgjigje direkte në pyetjen e parashtruar, kur nuk i kujtohet se ç'ka thënë saktë gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë, kur në vend të perceptimit do të fillojë të japë mendime dhe interpretime personale që nga ai nuk priten, e ai as që është kompetent për një gjë të tillë.

3.2. Të pyeturit e drejtpërdrejtë

Të pyeturit e drejtpërdrejtë është forma e parë e marrjes në pyetje që shërben për fitim të njohurive për ngjarjen nëpërmjet marrjes në pyetje të dëshmitarëve nga pala që i ka propozuar si dëshmitarë në procedurën konkrete penale. Të pyeturit e drejtpërdrejtë nënkupton:

- marrje në pyetje të dëshmitarëve të propozuar nga vetë pala,
- parashtrim të pyetjeve të shkurtra që të merren përgjigje të plota nga dëshmitari,
- pyetjet duhet të strukturohen sipas fakteve të rastit dhe të ndërlidhen me përgjigjet e dhëna paraprakisht,
- dëshmitarët duhet të përgatiten për marrje në pyetje pasiqë të pyeturit e drejtpërdrejtë pyetje është bazë e të pyeturit të kryqëzuar.

Mënyra e parashtrimit të pyetjeve – pyetjet nuk duhet të jenë sugjestive, por duhet të jenë të shkurtra dhe të kërkohet nga personi i cili merret në pyetje të tregojë, të sqarojë, gjegjësisht të përshkruajë se çka di për ngjarjen.

Gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë pritet elaborim nga personi që merret në pyetje, prandaj edhe pyetjet janë të përgjithshme. Nëpërmjet të të pyeturit të drejtpërdrejtë duhet të jepet përgjigje për aspektet e ngjarjes që japin përgjigje për pyetjet: kush është autori i ngjarjes inkriminuese, ku dhe kur saktë ka ndodhur ngjarja, si është kryer vepra penale dhe me kë ka vepruar autori i veprës, në çfarë mënyre është kryer vepra, përse është bërë ajo, gjegjësisht cili është motivi i veprës, çka i ka paraprirë ngjarjes, cili është (dhe a ka sadopak) kontributi i viktimës për kryerjen e veprës, cilat janë pasojat e veprës, gjegjësisht çfarë pasojash ka shkaktuar vepra dhe të ngjashme.

Të pyeturit e drejtpërdrejtë është bazë për të pyeturit e kryqëzuar, gjegjësisht pyetjet gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë ndërlidhen me atë që e ka thënë personi gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë.

Veçanërisht problematike është situata kur dëshmitari që e ka propozuar pala, gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë shndërrohet në të ashtuquajtur dëshmitar armiqësor (hostile witness), gjegjësisht në dëshmitar të palës kundërshtare. Në situatë të këtillë, pala që e ka propozuar dëshmitarin mund të thirret në deklaratën që personi ia ka dhënë pyetësit në stadin paraprak të procedurës (procedurën hetimore gjegjësisht veprimeve hetimore të mbrojtjes) dhe mund të kërkojë nga gjyqi të vazhdojë me të pyeturit të kryqëzuar të dëshmitarit.

Të pyeturit e sërishëm të drejtpërdrejtë realizohet pasi që pala kundërshtare e ka marrë në pyetje dëshmitarin gjatë kundëre kzaminimit dhe gjatë të njëjtës e ka nxitur dëshmitarin që të përgjigjet në pyetje për fakte për të cilat dëshmitari aspak nuk është pyetur gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë, gjegjësisht kur ka arritur që për një pjesë ta zvogëlojë vlerën dëshmuese të deklaratës që e ka dhënë dëshmitari gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë.

3.3. Të pyeturit e kryqëzuar/Kundërekzaminimi

Të pyeturit e kryqëzuar paraqet mundësi që të merren në pyetje dëshmitarët që i ka propozuar pala kundërshtare. Kjo formë e marrjes në pyetje kërkon përgatitje të veçantë, aftësi, rutinë dhe përvojë.

Të pyeturit e kryqëzuar ka të bëjë me atë që dëshmitari e ka thënë gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë. Me fjalë të tjera, deklarata e dëshmitarit gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë paraqet bazë për pyetjet që do të parashtrihen gjatë të pyeturit të kryqëzuar.

Qëllim i të pyeturit të kryqëzuar - zvogëlimi i vlerës dëshmuese të deklaratës që e ka dhënë dëshmitari gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë. Është gabim që në konceptin e të pyeturit të kryqëzuar diskreditimi të lidhet me personalitetin e dëshmi ta rit, në ç'mënyrë bëhet defokusim nga përmbajtja e deklaratës te karakteri i personalitetit të dëshmitarit. Kredibiliteti në fakt ka të bëjë me mënyrën se si do ta trajtojë gjyqi një dëshmi të caktuar, e jo si do ta trajtojë personalitetin e dëshmitarëve.¹⁴

Nëpërmjet të të pyeturit të kryqëzuar, dëshmitari duhet të paraqitet në dritë tëpersonit që është gjykuar më parë të cilit nuk mund t'i besohet, të potencohen disa mangësi të tija fizike si për shembull, shikim apo dëgjim i dobësuar, aftësi të zvogëluara motorike dhe të ngjashme, nëse kjo është e rëndësishme në aspekt të fakteve për të cilat është deklaruar gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë.

¹⁴ Stone, citat, fq. 61-62.

Është me rëndësi që të krijohet përshtypja se deklarata e dhënë gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë nuk është konzistente deri në fund, ka paqartësi, fakte që nuk ndërlidhen njëri me tjerin, deklarata është joprecize, përmban supozime të dëshmitarit dhe të ngjashme.

Nëpërmjet të të pyeturit të kryqëzuar përgënjeshtrohet teza e palës kundërshtare.

Është me rëndësi të veçantë aftësia që dëshmitari i palës kundërshtare të futet në “akull të hollë” dhe të futet dyshim në reputacionin e tij, edhe atë jo në kuptim të asaj se ka dhënë deklaratë të rrejshme, por se nuk është plotësisht i sigurtë në atë që e ka thënë gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë.

Gjatë të pyeturit të kryqëzuar shfrytëzohet deklarata që e ka dhënë dëshmitari gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë dhe duke u nisur nga këto arsye, gjithmonë parashtrihen pyetje sugjестive. Pyetjet janë të gjata dhe përmbajnë përkujtim të asaj që e ka thënë dëshmitari gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë.

Përgjigjet gjatë të pyeturit të kryqëzuar janë të shkurtra, më shpesh nga dëshmitari kërkohet që të përgjigjet me “po” ose me “jo”.

Dëshmitarit nuk duhet t’i lejohej asnjë lloj sqarimi gjatë të pyeturit të kryqëzuar.

Të pyeturit e kryqëzuar ka për qëllim ta vërtetojë ose ta përgënjeshtrojë atë që është thënë më parë, dhe nuk është bazë për elaborime dhe sqarime të reja.

Në rast se të pyeturit e kryqëzuar është i suksesshëm, pason të pyeturit e drejtpërdrejtë plotësues, ku pala që e ka propozuar dëshmitarin do t’i mundësojë atij që të japë sqarime plotësuese. Gjatë të pyeturit të kryqëzuar secila palë duhet të koncentrohet te ato fakte që i ka thënë dëshmitari gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë e të cilat janë në favor të tezës vetjake, gjegjësisht vërtetohen disa thënie të palës që e bën marrjen e kryqëzuar në pyetje. Ekziston rast kur gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë, dëshmitari ka dhënë mendimin e tij për disa fakte që nuk janë në favor të palës kundërshtare, mirëpo gjatë të pyeturit të kryqëzuar pala kundërshtare do të arrijë që nga dëshmitari të marrë përgjigje për fakte të tjera, për të cilat dëshmitari ka njohuri dhe të cilat janë në favor të palës që e bën të pyeturit e kryqëzuar.

Të pyeturit e kryqëzuar kërkon përgatitje të veçantë, bashkëpunim të avokatit me klientin, punë me dëshmitarët vetjakë me qëllim që të përgatiten për të pyeturit e kryqëzuar nga pala kundërshtare.

Çdo pyetje nga të pyeturit e kryqëzuar duhet të ketë qëllim të qartë përfundimtar – pala duhet ta dijë se çka dëshiron të arrijë dhe duhet që më parë ta dijë përgjigjen që do ta marrë nga personi që merret në pyetje.

Mbrojtja duhet të vlerësojë se a do ta pyesë në formë të kryqëzuar ndonjë dëshmitar apo jo. Gjatë kësaj, është i rëndësishëm vlerësimi se gjatë të pyeturit të kryqëzuar, sa do të vërtetohen apo do të kontrollohen fakte të caktuara që janë të rëndësishme për mbrojtjen.

Është mjaft me rëndësi që pala e cila pyet në formë të kryqëzuar, të vlerësojë se në cilin moment të ndalet me të pyeturit e kryqëzuar - kur nga dëshmitari do ta marrë përgjigjen që është shumë e rëndësishme për tezën vetjake të rastit. Të pyeturit e kryqëzuar ka efekt më të madh kur arrihet qëllimi për të cilin pala ka vendosur që personin ta pyesë në formë të kryqëzuar.¹⁵

Të pyeturit e kryqëzuar mund të mos realizohet nëse mbrojtësi vlerëson se kjo është në interes të mbrojtjes.

3.4 Të pyeturit plotësues

Të pyeturit plotësues paraqet pyetje të sërishme të drejtpërdrejtë të dëshmitarit pasi që ai është pyetur në formë të kryqëzuar nga pala kundërshtare.

Të pyeturit plotësues është e kufizuar në atë që ka qenë subjekt i të pyeturit të kryqëzuar.

Të pyeturit plotësues shihet si korigjues i të pyeturit të kryqëzuar.¹⁶

Këtë formë të marrjes në pyetje e bën pala që e ka propozuar dëshmitarin edhe atë për sa i përket fakteve të cilat kanë qenë subjekt i të pyeturit të kryqëzuar, mirëpo të cilët nuk janë përmendur aspak apo janë elaboruar në mënyrë të paqartë gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë.

Qëllimi i të pyeturit plotësues - të sqarohen arsyet për mospërputhjen e deklaratës së dhënë, të përmirësohet reputacioni i dëshmitarit, që është luhatur gjatë të pyeturit të kryqëzuar (poqese një gjë e tillë është e mundur), të manifestohet siguri dhe bindshmëri e dëshmitarit, të përmirësohet ajo që gjatë të pyeturit e kryqëzuar pala kundërshtare ka arritur ta luhatë, gjegjësisht ta përgënjeshtrojë.

Të pyeturit plotësues duhet të fillojë me pyetjen që dëshmitari të sqarojë se pse nuk ka qenë në përputhshmëri me deklaratën e dhënë më parë, pse atë që ka dalë si rezultat i të pyeturit të kryqëzuar nuk e ka thënë gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë. Në këtë mënyrë dëshmitarit i mundësohet që ta përmirësojë gabimin dhe ta kompletojë deklaratën, si dhe ta rikthejë kredibilitetin e tij, besimin në deklaratën e dhënë dhe se ajo që e ka thënë është e vërtetë. Në fund të të pyeturit plotësues parashtrihen pyetje me të cilat potencohen faktet kyçe të rastit të cilat janë vërtetuar dhe të cilat janë në favor të palës që e realizon të pyeturit plotësues.

3.5. Marrja në pyetje e të akuzuarit

¹⁵ Kurtë pyeturitekryqëzuar dotë përfundojë medeklaratë që është në favor të tezës së palës që e bën të pyeturit e kryqëzuar, kjo le përshtypje të madhe të gjyqi për dëshmitarin konkret, Stone, citat, fq. 59.

¹⁶ Stone, citat, fq. 4.

Mbrojtja ka mundësi të vendosë se a do të paraqitet i akuzuari në rolin e dëshmitarit në rastin e tij personal. Askush nuk mund ta detyrojë të akuzuarin që të dëshmojë në rastin e tij personal. Vendimi që i akuzuari të dëshmojë duhet të silltet pas vlerësimit të kujdesshëm të dëshmvive të propozuara, shkallës së përgjegjësisë penale, duhet të kihet parasysh rrezikun që e mban me vete të pyeturit e kryqëzuar e të akuzuarit, kur domosdo do të paraqiten aspekte që çojnë kah vetakuzimi.

Dëshmia në rastin personal nuk ka për qëllim pranimin e fajit dhe nuk paraqet prezantim të pranimit të krimit. Është e kundërta, i akuzuari paraqitet në rolin e dëshmitarit në raste kur mbrojtja ka argumente të fuqishme kundër akuzës së parashtruar dhe do të vlerësojë se nëpërmjet të marrjes në pyetje të të akuzuarit, këto argumente do të prezantohen para gjyqit në mënyrë më efikase dhe më të suksesshme.

Nëse i akuzuari vendos që të dëshmojë, për të vlejné të njëjta rregulla si edhe për dëshmitarët – pas të pyeturit të drejtpërdrejtë pason të pyeturit e kryqëzuar, e sipas nevojës edhe të pyeturit plotësues për një pjesë të përgjigjeve të dhëna.

Prokuroria mund ta diskreditojë të akuzuarin si personalitet (varësitë e tij, dënimet e mëparshme, prind i keq, bashkëshort i keq, qytetar i keq, person me kualitete të dyshimta morale, aktivitete të dyshimta biznesi dhe të ngjashme) vetëm gjatë të pyeturit të kryqëzuar, gjegjësisht vetëm nëse i akuzuari paraqitet në rolin e dëshmitarit në rastin e tij personal. Në të kundërtën, prokuroria nuk ka mundësi të përmendë aspekte nga jeta e mëparshme e të akuzuarit me qëllim të diskreditimit të tij.

3.6. Teknikat e kundërekzaminimit

Organizo: Mos e ndiqni detyrimisht urdhrin e kundërshtarit të ekzaminimit të drejtpërdrejtë të avokatit nga dëshmitari. Përdorni parimet paresore dhe të fundit. Ajo që juria dëgjon e para dhe e fundit është më e vlefshme

Shfrytezoni te dy llojet e kundërekzaminimit si te pershtatshme: Kemi dy lloje te kundërekzaminimit konstruktive dhe destruktive .Me kundërekzaminimin konstruktiv avokati deshiron te mare deshmi te dobishme nga deshmitari. Dëshmia e tillë mund të vërtetojë dëshminë e njërit prej dëshmitarëve tuaj ose të fajësojë një dëshmitar tjetër, ose ose të dyja mund të jenë të dobishme për rastin tuaj.Me ekzaminim destruktiv ose ndryshe shkaterues qellimi eshte te shkateroj ose te pakten te demtoj seriozisht kredibilitetin e dëshmitarit ose të kufizojë efektin e dëshmisë së tij.

Inkuadrim i pyetjeve tuaja: Pyetjet tuaja duhet të jenë të ngushta dhe të kufizuara në një fakt për pyetje. Sa më komplekse një pyetje apo më e ngarkuar është me fakte, aq më lehtë dëshmitari mund të lëkundë me të ose ta mohojë atë. Dëshmitari mund të mohojë në mënyrë të drejtë pyetjen bazuar në faktin se një nën-pjesë ose fakt i vogël, për shembull, është teknikisht i pasaktë.

Deshmitar i paqarte: Dëshmitari është i paqartë, nuk do të përgjigjet drejtpërdrejt në pyetjen tuaj me një "po" ose "jo" ose pretendon se nuk e din se çfarë kuptimi është "është". Mos e ndërprisni kurrë dëshmitarin, thjesht kthehuni dhe përsërisni pyetjen tuaj. Asnjëherë mos e

riformuloni atë. Përsëriteni atë fjalë për fjalë. Nëse paqartësia vazhdon, vazhdo te pyesni te njejten pyetje duke ngadalësuar dhe duke pushuar midis fjalëve .

4. SHQYRTIMI KRYESOR SIPAS LPP

Shqyrtimi kryesor sipas Ligjit të ri për procedurë penale nuk i ka karakteristikat e procedurës së pastër akuzatore të llojit anglosakson, duke pasur parasysh faktin se shqyrtimi nuk udhëhiqet si kontest i palëve para porotës e cila vendos për fajin e të akuzuarit, kurse gjyqi është tërësisht pasiv, por prezantimi i dëshmive në shqyrtimin kryesor zhvillohet para trupit gjykues që është kompetent të vendosë për fajin, por edhe ta përcaktojë sanksionin penal.

Me të drejtë thuhet se gjyqi, i cili është përgjegjës për sjelljen e aktgjykimit të ligjshëm, patjetër të ketë vegla minimale njohëse në aspekt të përcaktimit të bazës faktike të rastit për të cilin duhet të gjykojë. Prandaj, në masë të madhe kufizohen elementet inkuizitore, dhe është gabim të thuhet se ato janë braktisur në tërësi.¹⁷

Pjesa më e madhe e zgjidhjeve të propozuara me Ligjin e ri për procedurë penale në këtë pjesë janë marrë nga Ligjet për procedurë penale të Bosnjë dhe Hercegovinës dhe të Italisë.¹⁸

4.1. Fillimi i shqyrtimit kryesor

Fjalët hyrëse të palëve

Shqyrtimi kryesor fillon me mbajtjen e fjalëve hyrëse. Në vend të leximit të aktakuzës, që deri tani ishte momenti i fillimit të shqyrtimit kryesor, sipas Ligjit të ri për procedurë penale, leximi i aktakuzës është zgjeruar në dhënien e fjalës hyrëse nga ana e paditësit si veprim i parë që konsiderohet fillim i shqyrtimit kryesor. Fjalën e parë hyrëse e mban paditësi, e më pas mbrojtja, gjegjësisht mbrojtësi apo i akuzuari. Sipas rolit procedural që e kanë palët dhe barrës së dëshmimit, prokurori publik ka për detyrë që të mbajë fjalë hyrëse, ndërsa mbrojtja vet vlerëson se a do të japë fjalë hyrëse apo do të përmbahet nga një mundësi e këtillë procedurale. I akuzuari ka të drejtë të mos mbajë fjalë hyrëse.

Sa i përket përmbajtjes së fjalëve hyrëse, LPP përmban një dispozitë të përgjithësuar se palët në fjalët hyrëse mund të theksojnë se cilat fakte vendimtare kanë ndërmend t'i dëshmojnë, t'i përmendin dëshmitë që do t'i prezantojnë dhe t'i përcaktojnë çështjet juridike të cilat duhet të zgjidhen.

Në praktikën anglosaksone, qëllimi i fjalëve hyrëse është që pala t'i paraqesë aspektet kryesore të cilat do të jenë subjekt i dëshmimit, cilët dëshmitarë do të thirren, cilat dëshmi do të

¹⁷ Kallajxhiev, Futja në përdorim e procedurës penale akuzatore me të pyeturit e kryqëzuar, cita

¹⁸ Shih: R. BARBERINI/ A. XHORXHETI, Shqyrtimi kryesor i akuzës, Materiale nga projekti Tuining i prokurorisë publike për kriminalitet të organizuar, Ohër/Shkup, 2009.

propozohen dhe cilat fakte do të dëshmohen me dëshmitë e propozuara, supozimet që duhet të vërtetohen apo të kontestohen dhe për çfarë përfundimi do të përpiqet pala gjatë gjykimit.

Fjalët hyrëse nuk janë mjet për diskreditim të të akuzuarit, prandaj LPP në mënyrë të prerë ndalon që në fjalët hyrëse të prezantohen fakte për gjykimet e mëparshme të të akuzuarit.

Duke e potencuar rolin e fjalëve hyrëse si prezantim jokundërshtues i “tezës vetjake të rastit”, palët nuk mund t’i shfrytëzojnë fjalët hyrëse për deklarim sa i përket konstatimeve dhe dëshmive të ofruara nga pala kundërshtare.

Fjalët hyrëse, zakonisht, nuk janë të kufizuara sa i përket kohëzgjatjes. Në kuadër të rolit udhëheqës të kryetarit të trupit gjykues gjatë shqyrtimit kryesor, është paraparë që ai, megjithatë, të mund t’i kufizojë fjalët hyrëse të palëve me një kohëzgjatje të caktuar.

I dëmtuari nuk mban fjalë hyrëse, mirëpo nëse i dëmtuari apo i autorizuari i tij janë të pranishëm në shqyrtimin kryesor, kanë të drejtë të paralajmërojnë kërkesë pronësore-juridike.

Udhëzim për të akuzuarin për të drejtat e tij dhe mundësitë procedurale

Deklarata e të akuzuarit, edhe pse me të drejtë konsiderohet si njëra nga dëshmitë më të rëndësishme në procedurën penale, ka status tjetër në kontekst të shfrytëzimit të saj si burim i njohurive për ngjarjen penale, varësisht nga natyra e procedurës ndëshkimore.¹⁹ Kështu për shembull, në procedurën ndëshkimore angleze, i akuzuari mund të heqë dorë nga e drejta e tij për të heshtur, dhe nëse do, mund të japë deklaratë para gjyqit dhe në atë rast ai shndërrohet në “dëshmitar në çështjen e tij personale”, i cili si edhe dëshmitarët e tjerë i nënshtrohet obligimit që ta flasë të vërtetën.²⁰

Sipas LPP, pas fjalës hyrëse të paditësit, kryetari i trupit gjykues i ka këto obligime: ▪ të bindet se i akuzuari e ka kuptuar akuzën (sipas nevojës është i obliguar që shkurtimisht ta paraqesë përmbajtjen e akuzës në mënyrë të thjeshtësuar dhe, për të akuzuarin, në mënyrë më të kuptueshme), ▪ ta udhëzojë të akuzuarin për të drejtën që të heshtë apo të japë deklaratë, ▪ ta këshillojë të akuzuarin që me kujdes ta ndjekë ecurinë e shqyrtimit kryesor, ▪ t’i tregojë të akuzuarit se mund të prezantojë dëshmi në mbrojtje të tij, t’u parashtrojë pyetje të bashkakuzuarve, dëshmitarëve dhe ekspertëve dhe të japë vërejtje sa i përket deklaratave të tyre dhe ▪ ta ftojë të akuzuarin që të deklarohet për të gjitha veprat penale të akuzës se a ndihet fajtor apo jo.

4.2. Procedura dëshmuese

¹⁹ Shih: Kallajxhiev, Futja në përdorim e procedurës penale akuzatore me të pyeturit e kryqëzuar, citat V. BAYER, Kazneno procesno pravo, odabrana poglavja, knjiga I: Uvod u teoriju kaznenog procesnog prava, Zagreb, 1995, 269; D. KRAPAC, Kazneno procesno pravo, II izdanje, Narodne novine, Zagreb, 2003, 356-364.

²⁰ Njësoj.

Renditja e dëshmive dhe mënyrat e marrjes në pyetje

Duke e pasur parasysh rolin e palëve gjatë shqyrtimit kryesor dhe barrën e dëshmimit, LPP e përcakton renditjen sipas së cilës prezantohen dëshmitë edhe atë: ▪ dëshmitë e akuzës dhe dëshmitë që ndërlidhen me kërkesën pronësore-juridike, ▪ dëshmitë e mbrojtjes, ▪ dëshmitë e akuzës për përgënjeshtim të dëshmive të mbrojtjes (replikë) dhe ▪ dëshmitë e mbrojtjes si përgjigje ndaj përgënjeshtimit (duplikë).

Procedura dëshmuese fillon me prezantimin e dëshmive që i ka propozuar prokurori e gjyqi i ka pranuar. Dëshmitë e prokurorisë kanë të bëjnë me fajin dhe sanksionin penal si dhe kërkesën pronësore-juridike të të dëmtuarit, interesat e të cilit i përfaqëson prokurori. Procedura dëshmuese pastaj vazhdon me prezantim të dëshmive të mbrojtjes, e më pas paraqiten dëshmitë si replikë me të cilat prokuroria i përgënjeshton dëshmitë e mbrojtjes, gjegjësisht duplika – dëshmitë me të cilat mbrojtja i përgjigjet përgënjeshtimit të prokurorisë. Është e qartë se ruhet privilegji që mbrojtja ta ketë fjalën e fundit (favor defensionis).

Nga renditja që është përcaktuar në këtë mënyrë shihet qartë se nuk ka dëshmi që prezantohen me propozim të gjyqit, në ç'mënyrë definitivisht braktiset obligimi i deritanishëm që gjyqi të propozojë dëshmi sipas detyrës zyrtare, për shkak të nevojës që të përcaktohet e vërteta materiale si kusht për të gjykuar.

Gjatë prezantimit të dëshmive lejohet të pyeturit e drejtpërdrejtë, të kryqëzuar dhe plotësues, me ç'rast të pyeturit e drejtpërdrejtë e bën pala që e ka propozuar dëshmitarin, gjegjësisht ekspertin apo këshilltarin teknik, të pyeturit e kryqëzuar e bën pala kundërshtare, ndërsa të pyeturit plotësues përsëri e bën pala që e thirr dëshmitarin gjegjësisht ekspertin.

LPP parasheh mundësi që kryetari i trupit gjykues dhe anëtarët e tij të mund t'i parashtrojnë pyetje personit që merret në pyetje, mirëpo pasi të përfundojë marrja në pyetje nga palët. Ky rregull është pranuar për shkak të frikës se nëse i mundësohet kryetarit të trupit gjykues dhe anëtarëve të tij që dëshmitarit, ekspertëve apo të akuzuarit t'i parashtrojnë pyetje në çdo moment, do të ekzistojë rrezik real që gjykatësit, në praktikë ta mbizotërojnë hapësirën e marrjes në pyetje, të vazhdojnë me praktikën e vjetër të marrjes në pyetje dhe të bëhen bartës kryesor të marrjes në pyetje, në vend që këtë rol ta kenë palët. Me këtë kufizim potencohet se pyetës kryesorë janë palët, ndërsa kryetari dhe anëtarët e trupit gjykues mund të parashtrojnë pyetje pasi të ketë përfunduar të pyeturit e kryqëzuar, gjegjësisht të pyeturit plotësues (poqese ka pyetje plotësuese).

Rregullat e gjyqit në procesin e prezantimit të dëshmive

Me braktisjen e rolit të pyetësit aktiv, gjyqit i mbetet që me përpikëri t'i zbatojë tre funksionet e lartpërmendura: garantues, kontrollues dhe udhëheqës. Realizimi i tyre në masë të madhe vjen në shprehje mu gjatë shqyrtimit kryesor.

Në procesin e prezantimit të dëshmimeve gjyqi i ka këto obligime: ▪ ta kontrollojë mënyrën dhe renditjen e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe të ekspertëve dhe prezantimin e dëshmimeve, duke mbajtur llogari që procedura të jetë efikase dhe ekonomike, ▪ të refuzojë prezantim të dëshmisë për të cilin konsideron se është e panevojshme dhe pa domethënie për lëndën dhe për këtë të japë sqarim të shkurtër, ▪ të miratojë të pyeturit e kryqëzuar, nëse për shkak të deklaratës që e jep dëshmitari gjatë shqyrtimit kryesor, ai nuk mund më të konsiderohet si dëshmitar i palës që e ka propozuar, ▪ të kujdeset për lejueshmërinë e pyetjeve, validitetin e përgjigjeve, marrjen e drejtë në pyetje dhe arsyeshmërinë e kundërshtimeve, ▪ gjatë prezantimit të dëshmimeve kujdeset për dinjitetin e palëve, të të akuzuarit, të dëshmitarëve dhe të ekspertëve.

Përveç sipas vlerësimit vetjak, gjyqi vepron edhe në bazë të kundërshtimeve të palëve. Në fakt, pas kundërshtimit gojor nga palët, me aktvendim, gjyqi mund: ▪ të ndalojë ndonjë pyetje apo ndonjë përgjigje të ndonjë pyetjeje që tanimë është parashtruar, nëse e vlerëson si të palejueshme apo si irelevante ose ▪ të ndalojë parashtrim të pyetjeve që në vete përmbajnë edhe pyetje edhe përgjigje, përveç gjatë të pyeturit të kryqëzuar.

Marrja në pyetje e dëshmitarit

Rregullat e marrjes në pyetje të dëshmitarëve parashohin obligim për kryetarin e trupit gjykues që para se të fillojë marrja në pyetje e dëshmitarit, t'ia tërheqë vërejtjen për obligimin që gjyqit t'ia thotë gjithë atë që e di për lëndën, e poashtu edhe se dëshmia e rrejshme është vepër penale. Para dëshmimit nga dëshmitari mund të kërkohet që të betohet.

Marrja në pyetje bëhet sipas rregullave për të pyeturit e drejtpërdrejtë, të kryqëzuar dhe plotësues.

Dëshmitarët e marrë në pyetje mbeten në gjyq, nëse kryetari i trupit gjykues nuk vendos që t'i lirojë apo t'i largojë përkohësisht nga gjykata. Me propozim të palëve apo sipas detyrës zyrtare, gjyqi mund të urdhërojë që dëshmitarët e marrë në pyetje të largohen nga gjykata dhe më vonë përsëri të ftohen dhe përsëri të merren në pyetje në prani apo në mungesë të dëshmitarëve apo ekspertëve të tjerë.

Nëse në shqyrtimin kryesor merret vesh se dëshmitari nuk mund të vijë para gjyqit apo se ardhja e tij është vështirësuar mjaft, mund të vendosë që ai të merret në pyetje nëpërmjet lidhjes për video-konferencë sipas dispozitave të LPP. Gjyqi është i obliguar që t'i lajmërojë palët dhe të dëmtuarin në ç'kohë dhe në ç'vend do të merret në pyetje dëshmitari, me qëllim që ata të jenë të pranishëm dhe të mund të realizohet marrja në pyetje.

Në kontekst të obligimit të gjyqit që të kujdeset për dinjitetin e dëshmitarëve, LPP parasheh mundësi që kryetari i trupit gjykues ta paralajmërojë, gjegjësisht ta dënojë me të holla, pjesëmarrësin në procedurë apo cilindo person tjetër që i kërcënohet, e ofendon apo e rrezikon sigurinë e dëshmitarit. Me propozim të palëve, gjyqi mund t'u urdhërojë organeve policore të ndërmarrin masa të nevojshme për mbrojtje të dëshmitarit. Nëse gjatë kërcënimit, ofendimit apo

rrezikimit të sigurisë së dëshmitarit është kryer verpë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, gjyqi pa vonesë e informon prokurorin publik kompetent.

Marrja në pyetje e ekspertit dhe e këshilltarit teknik

Ngjashëm sikur edhe te dëshmitari, edhe gjatë marrjes në pyetje të ekspertit, kryetari i trupit gjykues është i obliguar që t'ia tërheqë vërejtjen ekspertit për obligimin që ta thotë mendimin e tij në mënyrë të qartë dhe në përputhje me rregullat e profesionit, dhe t'ia tërheqë vërejtjen se deklarata e rrejshme për konstatimin dhe mendimin e tij paraqet vepër penale. Edhe nga eksperti mund të kërkohet që të betohet para fillimit të marrjes në pyetje.

Nëse ndonjëra nga palët kërkon që eksperti të merret në pyetje në shqyrtimin kryesor, konstatimi dhe mendimi me shkrim do të pranohet si dëshmi materiale vetëm nëse eksperti që e ka përgatitur konstatimin dhe mendimin ekspert ka dhënë deklaratë në shqyrtimin kryesor dhe është dhënë mundësia që ai të merret në pyetje në formë të kryqëzuar.

Ekspertët e marrë në pyetje mbeten në gjykatë, nëse kryetari i trupit gjykues nuk vendos t'i lëshojë apo përkohësisht t'i largojë nga gjykata. Me propozim të palëve ose sipas detyrës zyrtare, gjyqi mund të urdhërojë që ekspertët e marrë në pyetje të largohen nga gjykata dhe më vonë përsëri të thirren dhe përsëri të merren në pyetje, në prani apo në mungesë të dëshmitarëve apo ekspertëve të tjerë.

Dispozitat për marrjen në pyetje të ekspertit në mënyrë adekuate zbatohen edhe kur merret në pyetje këshilltari teknik.

Marrja në pyetje e të akuzuarit

I akuzuari mund të merret në pyetje vetëm nëse për këtë ekziston propozim nga mbrojtja.

Para se të fillojë marrja në pyetje, gjyqi është i obliguar që të akuzuarin ta udhëzojë për të drejtat e parapara me LPP.

Në rast ku mbrojtja do të propozojë që të merret në pyetje i akuzuari, ai merret në pyetje sipas rregullave për të pyeturit e drejtpërdrejtë, të kryqëzuar dhe plotësues, si edhe personat e tjerë në procedurë. I akuzuari nuk mund t'i shmanget të pyeturit të kryqëzuar nëse është dhënë propozimi që ai të merret në pyetje.

Nëse në shqyrtimin kryesor i akuzuari nuk jep deklaratë apo jep deklaratë të ndryshuar për fakte apo rrethana të caktuara, prokurori publik mund të kërkojë të lexohet apo të riprodhohet deklarata e të akuzuarit që e ka dhënë gjatë marrjes në pyetje të të akuzuarit nga prokurori publik apo në prani të tij, e me ç'rast të akuzuarit i është tërhequr vërejtja se deklaratat e incizuara mund të shfrytëzohen më vonë gjatë procedurës.

Trupi gjykues, me përjashtim, mund të vendosë që i akuzuari përkohësisht të largohet nga gjykata, nëse i bashkakuzuari apo dëshmitari refuzon të japë deklaratë në prani të tij apo nëse

rrethanat thonë se në prani të tij nuk do ta thotë të vërtetën. Pasi të kthehet në gjykatë, të akuzuarit do t'i lexohet deklarata e të bashkakuzuarit, gjegjësisht dëshmitarit.

Përrjashtim nga prezantimi i drejtpërdrejtë i dëshmitëve

Është rregull që dëshmitë të prezantohen sipas principit të drejtpërdrejtë dhe gjithmonë kur dëshmimi i një fakti bazohet mbi atë se dikush e ka parë atë, ai duhet personalisht të merret në pyetje gjatë shqyrtimit kryesor, përveç në rastet kur merret në pyetje dëshmitari i mbrojtur.

Marrja në pyetje nuk mund të zëvendësohet me lexim të procesverbalit nga deklarata që ai e ka dhënë më parë, e as me deklaratë me shkrim.

Megjithatë, LPP parasheh disa përjashtime të principit të drejtë përdrejtë: ▪ deklaratat e dëshmitarëve të dhëna në procedurën hetimore dhe deklaratat e mbledhura në kuadër të veprimeve hetimore të mbrojtjes mund të shfrytëzohen gjatë të pyeturit të kryqëzuar apo gjatë përgënjeshtimit të konstatimeve të prezantuara apo gjatë dhënies përgjigje ndaj përgënjeshtimit, me qëllim të përcaktimit të vërtetësisë së ndonjë deklarate dhe kredibilitetit të personave që merren në pyetje, ▪ procesverbalet me deklarata të dhëna në seancë dëshmuese, me vendim të gjyqit mund të prezantohen si dëshmi me lexim apo riprodhim, ▪ nëse pas fillimit të shqyrtimit kryesor paraqiten indikacione, në bazë të të cilave mund të vihet në përfundim se ndaj dëshmitarit ka qenë e ushtruar dhunë, se është kërcënuar, se i janë premtuar para apo ndonjë përfitim tjetër, që të mos dëshmojë apo të dëshmojë rrejshëm gjatë shqyrtimit kryesor, deklaratat e dëshmitarit të dhëna para prokurorit publik në procedurë paraprake, me vendim të gjyqit mund të prezantohen si dëshmi, ▪ procesverbalet me dëshmitë e dhëna para prokurorit publik, me vendim të gjyqit, mund të prezantohen si dëshmi me lexim apo reproduktim, nëse për soni që e ka dhënë deklaratën ka vdekur, është sëmurë psikikisht apo edhe përkundër të gjitha masave të parapara me ligj, ai ka mbetur i pakapshëm.

Plotësim i procedurës dëshmuese

Pas mbarimit të procedurës dëshmuese, ekziston mundësia që të kërkohet plotësim i saj. Propozim për plotësim të procedurës dëshmuese mund të japin palët dhe i dëmtuari sa i përket dëshmitëve që ndërlidhen me rrethana të reja që janë paraqitur gjatë shqyrtimit kryesor.

Pas mbarimit të procedurës dëshmuese, e me qëllim të mënjanim të kundërthënive në konstatimet dhe mendimet e ekspertëve apo profesionistëve, gjyqi, me propozim të palëve apo sipas detyrës zyrtare, mund të përcaktojë super ekspertizë. Super ekspertizën gjyqi mund ta përcaktojë në mënyrë elektronike me zbatim të rregullit të zgjedhjes së rastësishme nga regjistri i ekspertëve, në prani të paditësit dhe të mbrojtësit.

Nëse pas përfundimit të procedurës dëshmuese nuk jepen propozime për plotësim të saj apo nëse propozimi i palëve refuzohet nga gjyqi, kryetari i trupit gjykues do të shpallë se procedura dëshmuese ka përfunduar.

4.3 Fjalët përmbyllëse dhe përfundimi i shqyrtimit kryesor

Pas përfundimit të procedurës dëshmuese pasojnë fjalët përmbyllëse. Përveç palëve dhe mbrojtësit, fjalë përmbyllëse mban edhe i dëmtuari. Për dallim nga fjalët hyrëse të cilat i mbajnë vetëm palët dhe mbrojtësit, i dëmtuari mban fjalë përmbyllëse në të cilën flet për faktet që janë të rëndësishme për kërkesën pronësore-juridike që e ka bërë gjatë shqyrtimit.

Nëse akuzën e përfaqësojnë më shumë prokurorë, ose i akuzuari ka më shumë mbrojtës, të gjithë mund të mbajnë fjalë përmbyllëse, mirëpo nuk guxojnë të përsëriten dhe mund të kufizohen sa i përket kohëzgjatjes së fjalimit, me qëllim që t'i iket zgjatjes së panevojshme të procedurës në fazën e saj përfundimtare.

Pas fjalëve përmbyllëse, kryetari i trupit gjykues shpall se shqyrtimi kryesor ka për funduar dhe me procesverbal e konstaton kohën e përfundimit të shqyrtimit.

Pas përfundimit të shqyrtimit kryesor, trupi gjykues tërhiqet për këshillim dhe votim për të sjellë aktgjykimin.

5. RREZIQET

Në kuadër të rreziqeve për zhvillim të suksesshëm të shqyrtimit kryesor akuzator me rol aktiv të palëve dhe pozitë pasive të gjyqit, vëmendje të veçantë meriton brenga për mospërvojën e palëve sa i përket asaj se çka do të thotë përgatitje e suksesshme e lëndës para gjyqit. Nga palët pritet që të ushtrjnë mirë gjatë përgatitjes së dëshmitarëve për të pyeturit e drejtpërdrejtë dhe të kryqëzuar, të përgatisin pyetje sipas rëndësisë dhe lëmisë, të parashohin se cilat pyetje do t'i parashtrijë pala kundërshtare gjatë të pyeturit të kryqëzuar, poashtu probleme janë edhe përvoja e pamjaftueshme gjatë vlerësimit se a duhet të merret në pyetje në formë të kryqëzuar ndonjë dëshmitar i palës kundërshtare apo jo, serioziteti i mbrojtjes gjatë vlerësimit se a duhet të paraqitet i akuzuari në rolin e dëshmitarit në rastin e tij personal, a të angazhohet këshilltar teknik apo jo, realizimi i suksesshëm i veprimeve hetimore që janë në dispozicion të mbrojtjes dhe shfrytëzimi i mundësive ligjore që gjatë kësaj të ndihmohen nga prokurori publik, gjegjësisht gjyqi.

Është më se e qartë se do të nevojitet trajnim intensiv dhe gjithëpërfshirës i prokurorëve dhe avokatëve për metodat e reja të punës që priten nga ata, operativitet më i madh i prokurorëve, për të cilët duhet të pranohet se janë të papërvojë në marrjen në pyetje të personave, pasiqë deri tani këtë gjë, për nevojat e tyre, e bënte gjykatësi.

Do të jetë me rëndësi që edhe gjyqi ta kuptojë rolin e ri të arbitrit pasiv sa i përket prezantimit të dëshmimeve, e njëkohësisht të përkujdeset për realizim të funksionit të trefishtë, që sipas LPP pritet nga ai.

Koncepti i të pyeturit të kryqëzuar mundëson që gjatë procedurës akuzatore më lehtë të vihet në përfundim për arsyeshmërinë dhe vërtetësinë e një dëshmie të caktuar, gjegjësisht të vlerësohet “pesha” e saj nga aspekti i fakteve relevante.

KAPITULLI II. MARRJA E DËSHMITARËVE NË PYETJE TË DREJTPËRDREJTA, TË KRYQËZUARA DHE PLOTËSUESE

1. HYRJE

E drejta për të marrë në pyetje dëshmitarët kundra një personi në një seance të hapur gjyqësore, është e drejtë themelore. Deklarata e OKB-së për të Drejtat e Njeriut garanton “të drejtën e barazisë së plotë për dëgjim gjyqësor të drejtë dhe publik si dhe instrumente të tjera për të drejtat e njeriut siç janë: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike garantojnë të drejtën për dëgjimin e dëshmitarëve kundër një individ si dhe ftesën e dëshmitarëve në pyetje²¹. Mënyra se si bëhet një gjë e tillë varet nga modeli i gjykimit që aplikohet. Dallime të mëdha ekzistojnë mes qasjeve të sistemeve të ligjit zakonor/kundër-shtues/ligjit të akuzës dhe të drejtës civile/të përmbajtur/hetuese në seancat penale.

Është formuar një divergjencë historike në mes sistemeve që janë pasojë e sistemit inkuizitor të seancës gjyqësore dhe atyre që janë pasojë e sistemit kundërshtues. Modelet kundërshtuese normal paraqesin seanca gjyqësore të udhëhequra nga një zyrtar gjyqësor dhe prezantim të provave nga ana e palëve pjesëmarrëse në rastin e dhënë. Në seancat kundërshtuese, në një juri gjyqësore, juria e vendosur përcakton fajësinë dhe gjykatësi dënon të pandehurin pasi juria ta ketë dhënë verdiktin e fajësisë. Megjithatë, jashtë Shteteve të Bashkuara të Amerikës, një numër i madh i rasteve penale të gjykuara me juridiksion të të drejtës zakonore janë proceduar pa juri.

Sistemet e së drejtës civile në mënyrë më tipike përfaqësojnë sisteme ku një ose më shumë gjykatës bëjnë dëgjimin e rastit në shkallën e parë, nga ndonjëherë me anëtarë të vendosur të jurisë të cilët asistojnë panelin gjyqësor. Për shembull, gjykatat italiane të Assizesë, që bëjnë dëgjimin e shkeljeve më serioze, janë të përbëra nga dy gjykatës dhe nga gjashtë anëtarë të jurisë. Gjykatat e Anglisë dhe Uellsit në Britani të Madhe kanë nëpunës drejtësie të vendosur dhe të ndihmuar nga nëpunës me kualifikim drejtësie në gjykatat e magjistratëve ku bëhet dëgjimi i shumicës së rasteve.

Në seancat gjyqësore kundërshtuese kurrfarë dosje apo skedar me prova nuk sigurohet për gjykatë. Në vend të saj, gjykata bën dëgjimin e provave gojore të dhëna nga palët pjesëmarrëse për secilin rast. Gjykata, ose së paku fakt-gjetësi në rastin e jurive të vendosura, zakonisht pritet që të mos ketë dijeni për rastin para se të fillojë seanca gjyqësore.

²¹ Neni 10 in Deklaratës së KB për të Drejtat e Njeriut, Neni 6 (1) dhe (3) i KEDNJ, Neni 14 i MNDP.

Seancat gjyqësore kundërshtuese të rasteve penale favorizojnë principin e dëshmisë gojore. Palët i ftojnë dëshmitarët e tyre dhe i marrin në pyetje. Pasi që njëra palë të mbarojë me marrjen në pyetje të dëshmitarëve të vet, pala (ose palët) kundërshtare mund që t'i bëjnë pyetje të kryqëzuara dëshmitarit.

Në disa sisteme të cilët përdorin procedura gjyqësore kundërshtuese gjykatat mund të ftojnë dëshmitarët e tyre, por kjo në përgjithësi mund të ndodhë në rrethana të jashtëzakonshme (edhe pse në rastet që nuk janë penale në juridiksionet e të drejtës zakonore nuk është e pazakonshme që gjykatat të emërojnë ekspertë për dhënien e provave për çështje kontestuese të cilat kërkojnë ekspertizë teknike). Gjykatat e të drejtës zakonore aplikojnë rregulla rigoroze për pranimin e provave në seancat gjyqësore penale, e aplikohen rregulla pak sa me të relaksuara për rastet që nuk janë penale.

Në sistemet hetuese seancat gjyqësore më shumë përqendrohet në provën me shkrim, siç janë deklaratat e dhëna gjatë fazës së hetuesisë së zbatuar, nga ana e gjykatësit hetues ose ato nga prokurori ose hetuesit. Skedari jepet në gjyq në formë të provës. Dëshmitarët mund të ftohen, mirëpo zakonisht gjykata merr në pyetje dëshmitarët para se palët të bëjnë një gjë të tillë. Gjyqi ose palët mund të sjellin dëshmitarët e tyre në gjykatë. Por nuk është jo e zakonshme të kërkohet nga dëshmitarët vetëm të konfirmojnë dëshminë e dhënë gjatë fazës hetimore.

Rregulla rigoroze për renditjen e prezantimit të provave aplikohen në seancat gjyqësore penale në sistemet e të drejtës zakonore. Në seancat penale prokuroria prezanton provat e veta dhe në fund të “rastit” të vet gjyqi sjell vendim nëse i pandehuri ka rast për t’u përgjigjur (rasti prima facie) që do të thotë nëse ata mund të dënohen në bazë të provave të prezantuara. Rasti në fjalë mund të përfundojë nëse gjykata vendos se nuk është rast prima facie, që do të thotë se prokuroria nuk ka prezantuar provë për secilin element të akuzës, dhe me të vërtetuar të kësaj, rasti përfundon. Nëse gjykata vendos kundër të pandehurit, mbrojtja mund të kërkojë prova përfshirë këtu edhe ftesën e të pandehurit të japë dëshmi (ose, në disa sisteme, të japë deklaratë pa dhënë betimin). I pandehuri nuk e ka patjetër të kërkojë prova; në vend të saj, pas fjalës përfundimtare të prokurorit, adresuar trupit gjykues, mbrojtja mund të parashtrojë se prokuroria nuk e ka mbështetur rastin e saj me prova përtej dyshimeve të bazuara, pavarësisht se gjyqi është i kënaqur me ekzistimin e një rasti prima facie. I pandehuri që jep dëshmi llogaritet si një dëshmitar.

Në rast se mbrojtja thërret një rast, në përfundim të tij, prokurorisë mund – edhe pse kjo rrallë ndodh në praktikë – t’i lejohet të sjellë provë kundërshtuese. Rregulla rigoroze mbizotërojnë në rast se lejohet një gjë e tillë. Kjo është për shkak se prokuroria mban barrën e provës, andaj nuk duhet të lejohet që “rasti të ndahet” duke pritur deri sa mbrojtja të sjellë rastin në vend dhe pastaj të kërkojë përgjigje për të.

Seancat gjyqësore hetuese janë më “të rrjedhshme” për nga natyra e tyre. Në përgjithësi nuk ekziston “rast i prokurorisë”, nuk ekziston testim për “raste që nuk janë prima facie” në ç’rast

dëshmitarët e cilëso palë apo ato të gjykatës të ftohen sipas çfarëdo renditjeje. Gjyqtari mund ta angazhojë edhe të pandehurin në dialog. Mund të kërkohet nga ai t'i komentojë dëshmitë. I pandehuri mund të japë edhe deklaratat spontane gjatë seancës gjyqësore. Procedurat nuk ndahen.

Sistemet kundërshtuese, gjithashtu, kanë rregulla shumë më strikte sa i përket dorëzimit të dëshmiave. Në sistemet e të drejtës zakonore, me preferencën e tyre për formën orale të provave, thashethemet (si deklaratat të dhënë jashtë gjykatës) llogariten të papranueshme edhe pse janë bërë shumë përjashtime prej rregullave të përgjithshme kundrejt thashethemeve. Seancat gjyqësore në sistemet e të drejtës civile janë më fleksibile në lejin e provave të thashethemeve që mund të sillen në seancë. Në fund të fundit, prapëseprapë mund të arrihet një rezultat i njëjtë, edhe pse sistemet e të drejtës civile mund të lejojnë që në provat e veta të ketë më shumë thashetheme, është gjykata ajo e cila duhet të vlerësojë kredibilitetin dhe besueshmërinë (nëse është konfirmuar) dhe pastaj t'i jepet provës pesha e nevojshme.

Në seancat e të drejtës zakonore, i pandehuri, përveç rasteve kur nuk është i përfa qësuar, nuk merr pjesë aktive në seancë. Sistemet kundërshtuese njohin principin e unitetit të mbrojtësit me klientin që do të thotë se ata flasin njëzëri. Avokati mbrojtës prezanton rastin, merr në pyetje dëshmitarët dhe dorëzon paraqitjet ligjore. I pandehuri i jep udhëzime avokatit mbrojtës kur paraqitet nevoja për një gjë të tillë. Ai, në disa sisteme, mund të japë deklaratë pa dhënë betimin.

Në sistemet kundërshtuese viktimat ose “të dëmtuarit” ose “dëmtuesit” nuk janë palë të çështjes dhe në përgjithësi nuk kanë të drejtë të paraqiten. Disa sisteme, megjithatë, lejojnë pjesëmarrjen e viktimës në fazën e shqiptimit të dënimit, por zakonisht përmes dhënies së provës ose dhënies së deklaratave që ofrojnë përvijim të mënyrës së ndikimit të veprës penale tek ata. Duke përdorur mënyrën e kontrastit, palët e grindura në sistemet hetuese mund të marrin pjesë në seanca si palë në vete. Në disa sisteme atyre iu lejohet të ftojnë dëshmitarë në seancë.

Në përgjithësi, në sistemet e të drejtës zakonore ose kundërshtuese, nuk kërkohet nga gjykata që të kërkojë të vërtetën, por më shumë të zbulojë rezultate për provat e prezantuara nga palët e përfshira në rast. Seancat gjyqësore në sistemet hetimore, si për krahasim kanë për qëllim që të zbulojnë të vërtetën dhe gjyqtari hetues/ prokurori/ hetuesi kanë për detyrë që të kërkojnë për dëshmitë favorizuese për të pandehurin.

Procedurat gjyqësore kundërshtuese gjithnjë e më shumë po aplikohen në sistemet civile ose hetuese. Italia dhe Bosnja e Hercegovina janë shembujt më të ri të sistemeve hibride ose të modeleve të përziera ku aplikohen procedurat kundërshtuese.

Një sistem hibrid ose i përzier mund të kombinojë veti edhe të sistemit hetues edhe të atij kundërshtues. Për shembull, sistemi i Bosnjës tani është i udhëhequr nga pala në mënyrë që palët pjesëmarrëse në seancë të prezantojnë rastet e veta duke ftuar dëshmitarët e vet dhe duke ofruar dokumentet e veta për prova. Megjithatë, për dallim nga seancat e të drejtës zakonore, në Bosnjë e Hercegovinë renditja rigoroze e prezantimit të provave së pari prokuroria e pastaj mbrojtja mund të shmanget nga ana e palës e cila fton dëshmitarët jashtë renditjes. Në përmbjlljen e rastit

të mbrojtjes prokurorisë i lejohet që të paraqesë prova shtesë nëse shprehë dëshirë të tillë, që do të thotë se të pandehurit jo domosdo kanë njohuri për përmasat e rastit kundër tyre para se të fillojnë me rastin e tyre. Gjykata mund të marrë në pyetje dëshmitarët në çdo kohë gjatë dhënies së dëshmimeve dhe madje të ftojë edhe dëshmitarë të vet, veçanërisht dëshmitarët ekspertë.

Të pandehurit i lejohet që të luajë rol aktiv në seancën gjyqësore dhe mund të marrë t'i marrë dëshmitarët në pyetje ose të bëjë paraqitje pasi që këshilli mbrojtës ta ketë bërë një gjë të tillë.

Gjykata nuk ndalet së dëgjuari provat me mbarimin e rastit të prokurorisë, madje edhe atëherë kur prova nuk mund të vërtetojë rastin e prokurorisë përtej dyshimit të bazuar në atë pikë të seancës gjyqësore. Për këtë arsye çështja kundër të pandehurit nuk llogaritet e plotë deri atëherë, derisa mbrojtja të ketë dhënë provën e vet dhe prokuroria të ketë dhënë ndonjë provë shtesë, në rast se ajo ka shfaqur dëshirë për një gjë të tillë.

Dy gjykatat e para moderne ndërkombëtare për krime, Gjykata Ndërkombëtare për Krime për Ish Jugosllavinë (TNKJ) dhe Gjykata Ndërkombëtare për Krime për Ruandën (TNKR), u themeluan kryesisht sipas linjave kundërshtuese, por edhe me disa aspekte hetuesie. Një shembull i përbashkët për të dy gjykatat, që autorizon Dhomën Gjyqësore për të prezantuar prova shtesë dhe proprio motu, e cila fton dëshmitarët e vet për të marrë pjesë në seancë. Me kalimin e kohës, siç zgjatej kohëzgjatja e seancave dhe dyfishoheshin provat që lidheshin me raste të ngjashme, TNKJ-ja paraqiti rregulla të reja për të shpejtuar seancat e gjata përfshirë këtu edhe imponimin e kufizimeve në procedurën e marrjes në pyetje, madje deri në masë të pranimit të deklaratave të dëshmitarëve pa iu dhënë lejen palëve kundërshtare për t'i pyetur rishtas dëshmitarët.

Në seancat gjyqësore kundërshtuese, si në sistemet e të drejtës zakonore ashtu edhe në ato të së drejtës civile, që zbatojnë procedura kundërshtuese, qëllimi i marrjes në pyetje të drejtpërdrejta, pyetje të kryqëzuara dhe plotësuese, në thelb është i njëjtë.

Qëllimi i marrjes kryesore në pyetje është të merren dëshmitë që mbështesin rastin e palës që fton dëshmitarin, përderisa funksioni i pyetjes së kryqëzuar është që të “testojë” atë dëshmi dhe nëse është e nevojshme, të nënvlerësojë ose shkakttojë dyshime mbi të.

Pyetja e kryqëzuar ka një rëndësi të thellë në sistemin kundërshtues e në veçanti në sistemet e të drejtës zakonore. Për shembull, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kjo konsiderohet si gurthemel i procesit gjyqësor të të drejtës zakonore dhe quhet “makina më e fuqishme juridike e zbuluar deri më tani i të vërtetës”²².

Pyetja plotësuese gjithashtu mund të jetë shumë e rëndësishme gjatë prezantimit të pro vave duke i lejuar palës të sqarojë provën e të vet pas mbarimit të pyetjeve të kryqëzuara.

²² John HeTNKy Wingmore – Marrëveshjet në sistemin Anglo-Sakson mbi dëshmitë gjatë Seancave gjyqësore të të drejtës zakonore – Boston, 1940.

Nuk duhet nënvlerësuar vështirësitë e marrjes së suksesshme në pyetje të sipas rregullave rigoroze të marrjes kryesore në pyetje të drejtpërdrejta, pyetjeve të kryqëzuara, dhe pyetjeve plotësuese. Për të zbatuar këtë në mënyrë adekuate, duhet të zotërohen mirë teknikat për parashtrim të pyetjeve sugjestive dhe josugjestive, dhe si she kur të kundërshtohen pyetjet e oponentit. Sikur që është rasti edhe me shumë aftësi tjera profesionale, edhe për këto mund të nevojiten vite të tëra për të arritur nivelin e zotërimit të plotë. Në sistemet e së drejtës zakonore, avokatia ligjërohet si lëndë e vazhdueshme juridike për të gjithë ata që duan të ushtrojnë detyrën e avokatit. Rregullat e provave më me rigorozitet aplikohen në seancat gjyqësore penale se sa në procedurat civile: gjithsesi, nuk është aspak e pazakonshme për gjykatat civile dhe për tribunalët të mos lidhem me rregulla rigoroze për prova. Në sistemet e të drejtës zakonore, juristët (ashtu si në çdo vend tjetër) në përgjithësi, specializojnë në këtë fushë, mirëpo për shkak të sfidave dhe natyrës së specializuar të aftësive të avokaturës gjyqësore, vetëm një numër i vogël i juristëve vendosin të që të specializohen në këtë lëmi.

2. ANGLIA DHE UELLSI (BRITANIA E MADHE)

2.1. Hyrje

Anglia dhe Uellsia aplikojnë një sistem të pastër të drejtës zakonore kundërshtues. Seanca gjyqësore vështrohet si një kontest mes palëve kundërshtare – në seancat penale në mes të Shtetit, të njohur si Kurora” dhe të pandehurit.

Përcaktimi i së vërtetës nuk është objektivi i procesit gjyqësor penal. Kur parashtrohet nevoja për mekanizëm për gjetjen e të vërtetës, Qeveria ose Parlamenti formojnë një anketë siç është Komisioni Anketues Mbretëror për një lëndë specifike ose përpilojnë një anketë Parlamentare.

Këto anketa janë të dizajnuara për të gjetur të vërtetën dhe të japin rekomandime ose përfundime në ç`rast dëshmitarët mund të ftohen dhe të detyrohen të dëshmojnë kundër interesit të tyre personal.

Dispozitat ligjore në lidhje me marrjen në pyetje të dëshmitarëve nuk janë domosdoshmërisht të kodifikuara, siç janë ato në sistemet e të drejtës civile dhe, shumë prej tyre, burojnë nga vendimet e gjykatave më të larta që janë marrë me shekuj pas nga dispozitat e dhëna nga ana e gjyqtarëve në të drejtën zakonore, të cilat janë referuar më poshtë. Disa dispozita të të drejtës zakonore janë përfshirë në legjislaturë.

Si rregull e përgjithshme është vetëm një avokat, në emër të secilës palë, ta marrë dëshmitarin në pyetje. Kjo vjen në kundërshtim me sistemet e së drejtës civile ku njëra palë ka më shumë se një avokat, atëherë marrja në pyetje jo domosdoshmërisht duhet bërë vetëm me një avokat.

2.2. Pyetjet e drejtpërdrejta

Me hapjen e rastit prokuroria bën prezantimin e rastit të vet duke ftuar dëshmitarët të japin dëshmitë e veta gojarisht në gjykatë. Pastaj prokurori merr në pyetje dëshmitarin. Termi

“marrjen në pyetje në përgjithësi” i përdorur, pothuajse, në të gjitha sistemet e të drejtës zakonore, e cila në Shtetet e Bashkuara njihet si “pyetje e drejtpërdrejtë”²³.

Qëllimi i marrjes kryesore në pyetje është nxjerrja e provave nga dëshmitari – me fjalë të thëna me gojë të vet – për të mbështetur rastin e palës që ka ftuar dëshmitarin. Rregull i të drejtës zakonore në Angli dhe në Uells është mosparashtrimi i pyetjeve sugjestionive gjatë marrjes në pyetje në përgjithësi. Pyetjet duhet të parashtrohen ashtu që të mos sugjerojnë përgjigjen e dëshmitarit (me disa përjashtime). Mësimi i qartë që nxirret nga kjo në sistem të udhëhequr nga pala është se dëshmitari është ai që dëshmon, e jo avokati.

Palët marrin normalisht “provë të dëshmisë” – një deklaratë të dëshmisë së pritur për mbrojtjen dhe për prokurorinë, e po ashtu edhe për policinë. Pyetjet për dëshmitarët zakonisht janë të mbështetura në këto dokumente. Avokatëve nuk ju lejohet të “udhëzojnë” me dëshmitarët para se të japin dëshminë.

Përgjigjet e pyetjeve sugjeruese janë të papranueshme si dëshmi edhe pse një peshë e vogël mund të ju përshkruhet atyre. Përjashtim nga kjo rregull janë pyetjet hyrëse ose ato që kanë të bëjnë me materiale të pakontestueshme.

2.3. Dëshmitarët armiqësor

Një përjashtim i rëndësishëm është kur gjykata, me rast të kërkesës së palës për të ftuar dëshmitarin, e ka deklaruar atë si “armiqësor”²⁴. Ajo palë pastaj mund ta pyesë sërish dëshmitarin e vet.

Dëshmitarët “armiqësorë” janë në kundërshtim me palën që i fton, meqenëse ata nuk janë të gatshëm për t’ua treguar të vërtetën kësaj pale. Kjo mund të demonstron, për shembull, me krahasimin e dhënies së dëshmisë në gjykatë me deklaratat e dhëna jashtë gjykatës në lidhje me të njëjtën çështje.

Dëshmitarët e papërshtatshëm, nga ana tjetër, dështojnë të vërtetojnë faktin për të cilin ata, në të vërtetë, janë ftuar ose në fakt vërtetojnë faktin e kundërt. Një dëshmitar i papërshtatshëm nuk mund të shpallet armiqësor.

Pala që fton dëshmitarin armiqësor mund të vërë në dyshim dëshmitarin duke dëshmuar “karakterin e tyre të dobët”²⁵. Dëshmitari, gjithashtu, mund të kundërshtohet me deklaratat e tij paraprahe kontradiktore, por fillimisht duhet të pyetet nëse ai ka dhënë atë deklaratë. Kur ballafaqohet me deklarata kundërtë, me të dhëna nga ana i njëjti dëshmitar, gjykata ka të

²³ Për shembull, shumë vende me sisteme të së drejtës zakonore e quajnë i marrje e përgjithshme në pyetje duke përfshirë këtu edhe Australinë, Kanadën, Hong Kong-un, Indinë, Fixhi, Zelandën e Re, Pakistanin dhe Afrikën e Jugut. Rregullorja procedurale i GJKIJ, GJKR, Gjykata speciale për Siera Leonen, Tribunali special për Libinë që të gjitha përdorin të njëjtën terminologji. Rigjykimi përdoret si zëvendësim i “ridirekt” Amerikan.

²⁴ Seksioni 3 Akti i Procedurës Penale 1865.

²⁵ Shiko Archbold Procedurën Penale të Pranim Fajit 2010 në [8.94]-[8.98].

drejtë të konsiderojë deklaratat paraprake kontradiktore si dëshmi e të vërtetës përkundër deklaratës të dhënë më vonë në gjykatë²⁶.

2.4. Deklaratat e përputhshme paraprake

Ndryshe nga sistemet civile, deklaratat paraprake të dëshmitarëve të cilat përputhen, në përgjithësi, nuk janë të pranueshme si dëshmi në procedurat gjyqësore. Në ligjin anglez “palës nuk i lejohet të japë dëshmi” për vetveten²⁷. Përjashtim janë dëshmitë që janë pjesë e res gestae, për shembull, në rastet e sulmeve seksuale për të refuzuar sugjerimet e ankesës së fundit, për të refuzuar thëniet që dalin nga trillimi i fundit i versionit të dhënë në gjykatë²⁸. Po ashtu mund të lejohet dëshmia e ankesës së fundit në rrethana të caktuara.

2.5. Rifreskimi i kujtesës

Dëshmitarët mund të rifreskojnë kujtesën e tyre me anë të një incizim i dokumentuar që i përkujton për një kohë të mëparshme. Mund të jetë ky një dokument i shkruar, zë i incizuar ose i transkriptuar²⁹. Avokatët mund të kërkojnë nga dëshmitari të rifreskojnë kujtesën e tyre cilëndo fazë të marrjes në pyetje. marrjes kryesore në pyetje nga dëshmitari normalisht pyetet, kur bëhet e qartë se ai ose ajo më nuk mban mend diçka, atëherë mund të intervenohet, nëse ekziston, me ndonjë dokument tjetër që do t’i ndihmonte dëshmitarit për t’u kujtuar.

2.6. Kundërekzaminimi/Pyetjet e kryqëzuara

Të gjithë dëshmitarët detyrohen t’i nënshtrohen pyetjeve të kryqëzuara pasi të kenë dhënë dëshminë e tyre kryesore (disa përjashtime të vogla prapëseprapë ekzistojnë siç është të ftuarit e dëshmitarit vetëm për të verifikuar dokumentet).

Pyetjet e kryqëzuara kanë për qëllim të nxjerrin dëshmi në favor të palës që parashtron pyetjet, por nga dëshmitari që ka ftuar pala kundërshtare. Po ashtu mund të kenë për qëllim – në varësi nga rrethanat dhe nga dëshmia – të hidhet dyshim në saktësinë e dëshmisë së dhënë gjatë marrjes kryesore në pyetje (nga ana e atij dëshmitari apo nga një tjetër). Ai duhet të jetë relevant lidhur me çështjet e rastit. Pyetësi mund – por nuk është i detyruar – të parashtrijë pyetje sugjестive por, ato në përgjithësi, parashtrohen gjatë pyetjeve të kryqëzuara. Avokati nuk duhet t’i sugjerojë dëshmitarit në formë fakti apo opinionit atë që pritet të thotë dëshmitari tjetër. Forma e marrjes në pyetje duhet të dizajnohet në mënyrë që të nxjerrë fakte, e jo vetëm të ftojë në diskutim.

²⁶ Seksioni 119 (1) Akti i Drejtësisë Penale 2003.

²⁷ R v. Roberts 28 Crim. App. R 102

²⁸ Seksioni 120 Akti i Drejtësisë Penale 2003

²⁹ Seksioni 139 Akti i Drejtësisë penale 2003

Pyetja e kryqëzuar është një aftësi profesionale e cila mësohet, ndërsa Kodeksi i Etikës për Avokatët e Anglisë dhe të Uellsit jep rregulla të caktuara në lidhje me pyetjet e kryqëzuara joadekuate. Kodeksi i Etikës së Avokatëve, po ashtu, thekson se avokati,³⁰

- nuk guxon të japë deklaratat e të parashtrorë pyetje të cilat janë mjaft skandaloze dhe kanë për qëllim të shpifin, të ofendojnë, zemërojnë një dëshmitar ose ndonjë person tjetër;
- nuk guxon të vërë në dyshim dëshmitarin të cilin e pyet në kryqëzim, përveç rasteve kur i jep mundësinë atij, që gjatë pyetjeve të kryqëzuara, të japë përgjigje në lidhje me deklaratën; dhe
- nuk guxon t'i sugjerojë viktimës, dëshmitarit apo ndonjë personi tjetër se ai është fajtor për krimin, mashtrimin apo sjelljen e keqe, as ti thotë fjalë të këqija fyese për sjelljen e ndonjë personi tjetër, apo t'ia përshkruajë ndonjë personi tjetër krimin apo sjelljen e keqe për të cilën është i pandehur klienti i tij i kontraktuar, përveç rasteve kur deklaratat e tilla bëhen pjesë e rastit (përfshirë këtu kredibilitetin e dëshmitarit) të klientit të kontraktuar si një gjë e mbështetur në baza të arsyeshme.

Nëse pala që bën pyetjet e kryqëzuara do të kërkojë nga gjykata që të mos i besohet dëshmitarit, atëherë kjo kërkesë duhet bërë haptas përderisa dëshmitari është duke dhënë dëshminë. Avokati, po ashtu, ka të drejtë të përdorë qasjen e quajtur “vetulla e ngritur” më tepër kur, për shembull, do të sugjerojë se dëshmitari po gënjen.

Trupi gjykues, duke përdorur fuqinë e vet për mbajtjen në kontroll të seancës gjyqësore, mundet gjer në një shkallë të rregullojë procesin e pyetjeve të kryqëzuara. Gjykatësi mund të mbajë nën fre pyetjet e kryqëzuara e tepruara, kështu që këtë duhet ta zbatojë me masë. Gjyqi mund të mos lejojë pyetje joadekuate apo të tilla që bëhen me presion. Ai, po ashtu, mund të imponojë kufizime kohore në rast se të pyeturit përsëritet apo bëhet në mënyrë jo e drejtë. Gjykatësi i seancës, po ashtu, duhet të përmbahet nga parashtrimi i pyetjeve të panevojshme gjatë pyetjeve të kryqëzuara të dëshmitarit.

I pandehuri i vetë-përfaqësuar nuk mund të parashtrorë pyetje të kryqëzuara paditësin në rastet seksuale as edhe fëmijët si dëshmitarë. I pandehuri duhet të caktojë një avokat për të bërë këtë, ose në rast se nuk mund të caktojë një, atëherë gjyqi do të emërojë një avokat për këtë qëllim³¹.

Dëshmitari gjatë pyetjeve të kryqëzuara mund të bie ndesh me deklaratën kontradiktore të dhënë më parë³². Siç u cek më lartë, gjyqi mund ta konsiderojë deklaratën e mëparshme si të vërtetë.

³⁰ Kodi i sjelljes së Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit dhe Standardet e shkruara për Zbatimin e punës profesionale, botimit i 8-të 2004, paragrafi 5.10.

³¹ Seksioni 35 deri më 38 Drejtësia për të rinj dhe Akti për Evidentimin Penal 1999 dhe Pjesa 31 nga Regullat për Procedurë Penale 2005.

³² Seksioni 3 dhe 4 Akti për procedurë Penale 1865

Nga dëshmitarët mund të kërkohet ta rifreskojnë kujtesën e tyre me parashtrim të dokumenteve për rikujtim. Ata mund të pyeten në mënyrë të kryqëzuar deri sa të fitohet besimi i tyre. Kjo mund të përmblihet në lidhje me: a) njohurinë e tyre të fakteve; b) mosinteresimin e tyre; c) integritetin e tyre; d) vërtetësinë e tyre, dhe e) njohurinë e tyre se vërtetësia është obliguese³³.

Dëshmitarët mund të pyeten për të paraardhësit e tyre, për dosjet kriminale, për lidhjet dhe për mënyrën e tyre të jetesës. Kjo vijë e pyetjeve duhet të qëndrojë brenda kufijve të përkufizuar në Kodeksin e Etikës së Avokatëve. Po ashtu mund të parashtrihen pyetje për “karakterin e dobët” të dëshmitarit³⁴, për prirjet ndaj sjelljeve të këqija, që dallojnë nga pyetjet që kanë lidhje me kundërvajtjet³⁵. Kjo ka implikime për të pandehurin në mënyrë se prokurorit i mundësohet të nxjerrë si dëshmi “karakterin e dobët” të pandehurit.

Në përgjithësi, pala është e lidhur me përgjigjen e dëshmitarit gjatë pyetjeve të kryqëzuara dhe, a do të lejohet apo jo dëshmia gjatë ose pas kundërshtimit, varet nga “sensi për lojë pa hile i prokurorit dhe i trupit gjykues e jo aq shumë nga ndonjë proces filozofik apo analitik”.³⁶ Si rregull, dëshmitar tjetër për të kundërshtuar përgjigjet e dhëna gjatë pyetjeve të kryqëzuara, nuk mund të ftohet. Në disa përjashtime përfshihen dëshmi për të treguar se dëshmitari ka qenë i njëanshëm dhe me bindje të mëparshme kriminale³⁷. Dëshmia mjekësore mund të paraqitet për të vërtetuar jo besueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarit³⁸.

Të gjitha palëve u lejohet ta pyesin dëshmitarin i cili nuk është ftuar nga ana e tyre, madje edhe në rast se dëshmitari është i bashkë-pandehuri.

2.7. Pyetjet plotësuese

E drejta zakonore lejon që një palë të mund të pyesë dëshmitarin e vet pasi të ketë mbaruar pyetja e kryqëzuar, zakonisht për të sqaruar çështjet e nxjerra me pyetjet e kryqëzuara. Me pyetjet plotësuese zakonisht përpiqet për të sqaruar çështjen nga pyetjet e kryqëzuara ose të “rehabilitojë” dëshmitarin pas një sulmi mbi besueshmërinë ose vërtetësinë. Nuk duhet parashtruar pyetje sugjestionuese³⁹.

Sikur se edhe gjatë marrjes në pyetje të drejtpërdrejta, në rrethana të përshtatshme, dëshmitarët mund të shpallen si armiqësorë dhe të pyetën në mënyrë të kryqëzuar, e atyre, po ashtu, u lejohet të rifreskojnë kujtesën e vet nga materialet gjyqësore që u parashtrihen.

2.8. Pyetjet e gjykatësit ose të jurisë

³³ Shiko Archbold Procedurën Penale të Pranim Fajit 2010 në [8.37

³⁴ Seksioni 100 Akti për Drejtësinë Penale 2003

³⁵ Seksioni 98 Akti për Drejtësinë Penale 2003

³⁶ R v. Funderburk [1990] 1 WLR 587, at 598, R. v. Somers [1999] Crim LR 744

³⁷ Seksioni 100 dhe 331 i Aktit për Drejtësi Penale 2003.

³⁸ Toohey v. Metropolitan Komisioni Policor [1965] AC 595 (Pallati i Lordëve).

³⁹ Irlanda v. Tajlor [1949] 1 KB 300

Gjykatësi mund ta pyesë dëshmitarin në cilën do fazë të seancës, por duke u përmbajtur (duke mos e tepruar) në mënyrë të konsiderueshme. Gjykata e Apelit i përmbahet asaj që “është dispozitë fundamentale e seancës angleze, atëherë kur një i pandehur jep dëshmi, atij duhet t’i lejohet që këtë ta bëjë pa e ngacmuar ose pa e ndërprerë” nga ana e gjykatësit të seancës⁴⁰. Juria ka të drejtë të kufizuar për të parashtruar pyetje dëshmitarit.

3. ITALI

3.1. Hyrje dhe përshkrim

Sistemi italian gjyqësor bën kombinim të dy elementeve, atë të procedurës kundërshtuese dhe asaj hetuese. Deri në miratimin e Kodit të Procedurës Penale të vitit 1988 sistemi penal Italian ishte i bazuar mbi sistemin hetues duke promovuar gjyqtarin hetues dhe përdorimin e dosjeve dhe shënimeve në gjykatë të cilat janë grumbulluar gjatë hetimit. Gjyqtari i lëndës ka shumë besim në në dosjet dhe ai kontrollon çdo dëshmitar i cili thirret për të dëshmuar.

Reformat kryesore të 1988 treguan se cilat ishin risitë në sistemi kundërshtues, kështu që sistemi Italian tani i kombinon elementet e të dy sistemeve të procedurës kundërshtues dhe hetuese.

Reformat zëvendësuan gjyqtarin hetues me prokurorin dhe garantuan që principi i kundërshtimit të dëshmive verbale gjatë seancës gjyqësore. Seksioni 111 i Kushtetutës Italiane deklaroi si më poshtë: “Të gjitha seancat gjyqësore mbahen me procedurë kundërshtuese dhe palët kanë të drejtë për kushte të barabarta para një gjykatësi të paanshëm në pozitën e palës së tretë.”

“Në procedurat penale gjyqësore , formimi i dëshmive është bazuar në principin e dëgjimit kundërshtues. Fajësia e të pandehurit nuk mund të vendoset në bazë të deklaratave të dy personave të cilët, për shkak të përzgjedhjes së tyre personale, gjithmonë janë shmangur vullnetarisht nga procesi i pyetjeve të kryqëzuara nga ana e mbrojtjes apo këshillit mbrojtës.”

Përskaj faktit se kjo i jep mandat principit gojor të procedurës gjyqësore, gjyqi mund të pranojë të fusë në dëshmi deklaratat hetuese në rrethana të veçuara.

Kodi i Procedurës Penale i vitit 1988 rregullon procedurat gjyqësore ku përfshihet mënyra e pyetjes së dëshmitarit, pranimi i dëshmive dhe rregullin e procedimit. Procedurat gjyqësore në Itali nuk janë as përafërsisht të rregulluara siç janë ata të rregulluara në vendet e pastra të sistemeve të të drejtës zakonore siç janë për shembull në Angli dhe në Uells ku vendimet e gjykatave më të larta për disa pika dëshmuese janë të obligueshme për të gjitha gjykatat më të ulëta në atë hierarki të veçantë.

3.2. Procedura paraprake

Secila fazë e një procesi gjyqësor penal është e dizajnuar që të garantojnë principin gojor të dëshmive të cilat do të përdoren në një proces gjyqësor. Faza e parë është dëgjimi preliminar

⁴⁰ R. v. Hulusi dhe Purvis 58 Cr. App. R. 378 at 385

përpara gjyqtarit giudice per l'udienza preliminare (gup) i cili vendos nëse rasti duhet të kalojë në seancë gjyqësore apo duhet të lirohet.

Si përjashtim për principin gojor në seancë gjyqësore, gup mund të mbajë dëgjim dëshmie të njohur si incidente probatorio. Këto procese gjyqësore kanë për qëllim “ruajtje” ose “pritje” të dëshmisë me anë të “ngrirjes” së dëshmisë. Kjo i mundëson ose prokurorisë ose mbrojtjes që të mbledhin dëshmi të dëshmitarit për seancë gjyqësore me anë të sigurimit të dhënies së dëshmisë gjatë fazës preliminare. Personi i fyer (pala e dëmtuar) po ashtu mund të kërkojë që prokurori të iniciojë një incidente probatorio⁴¹.

Incidente probatorio përdoret kur ekzistojnë arsye detyruese për të mbrojtur dëshmitarin nga dëmtimi ose për të siguruar dëshminë nga ndonjë person që është në prag të vdekjes dhe, kjo mund të bëhet në rrethanat në vijim kur: a) besohet me arsye se dëshmitari nuk do të jetë i aftë për t'u paraqitur në seancën gjyqësore për shkak të sëmundjes ose ndonjë pengese tjetër të madhe; (b) ekzistojnë baza të arsyeshme për të besuar se personi është ekspozuar në dhunë, kërcënime, oferta ose premtime të parave apo të përfitimeve të tjera për të mos dëshmuar ose për të dëshmuar rrejshëm; (c) marrja në pyetje e të pandehurit është në lidhje me faktet që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e të tjerëve; ç) të merren në pyetje ata persona që ngarkohen për raste të ngjashme; d) caktimi i ballafaqimit mes atyre personave që kanë dhënë deklarata kundërthënëse, për të ruajtur dëshminë; dh) marrja e dëshmisë eksperte ose kryerja e një eksperimenti gjyqësor nëse një person, send apo vend është subjekt i modifikimit të pashmangshëm; dhe e) gjatë kryerjes së identifikimit nëse ai nuk mund të bëhet gjatë seancës gjyqësore⁴².

Dëgjimi bëhet përpara kamerës. Pjesëmarrja e prokurorit dhe e avokatit mbrojtës është e detyrueshme. Avokati i palës së dëmtuar gjithashtu mund të marrë pjesë.⁴³ Palët marrin në pyetje dëshmitarin dhe evidentimi bëhet sipas rregullave të seancës gjyqësore, kryesisht me marrjen në pyetje të drejtpërdrejta, pyetjet e kryqëzuara dhe pyetjet plotësuese. Procesi lejon që palët të testojnë dëshminë në mënyrë kundërshtuese njëllor sikur që do të bënin edhe gjatë seancës gjyqësore, duke lejuar pranimin e tij si dëshmi gjatë seancës⁴⁴. Dëshmia e pritur është e pranueshme në seancë vetëm në lidhje me të pandehurit, avokati i të cilëve ka qenë prezent gjatë marrjes së dëshmisë.⁴⁵

Përjashtim të procesit gojor bëhet në rast të rasteve të terrorizmit ose krimit të organizuar. Në këto raste, nëse një dëshmitar veç më ka dhënë dëshmi të depozituar në incidente probatorio, të

⁴¹ Neni 394 i Kodit të procedurës Penale 1988.

⁴² Neni 394 i Kodit të Procedurës Penale 1988.

⁴³ Neni 401 i Kodit të Procedurës Penale 1988

⁴⁴ Ka disa ngjashmëri më procesin e deponimit të procesit para gjyqësor në disa juridiksione Amerikane dhe të ngjashme me deponimin e procedurës në Rregulloren 71 të Rregullave procedurale dhe Dëshmive të GJNIIJ.

⁴⁵ Neni 403 i Kodit të Procedurës Penale 1988.

drejtat e palëve për të dëshmuar në seancë janë të kufizuara me nevojën për parashtrimin e pyetjeve të reja ose në rrethana tjera të limituara⁴⁶.

3.3. Seanca gjyqësore në përgjithësi

Seanca gjyqësore tani duhet që të fillojë formatin klasik kundërshtues me atë që prokurori të fillojë çështjen dhe të thërras dëshmitarët për të dëshmuar të gjitha palët. Prokurori në Itali është një palë në procedurën gjyqësore, sipas profesionit konsiderohet të jetë anëtar i gjyqësorit dhe nga ai pritet të jetë udhëheqës në seancat kundërshtuese⁴⁷. Gjykata kushtetuese Italiane ka vërejtur që e ka për obligim që të jetë i saktë dhe indiferent në rezultatin kështu që ai nuk duhet që të ndjekë dënimin por duhet që të veprojë në mënyrë që të mos sigurojë vetë e në rast të dënimit por gjithashtu të japë edhe vendim lirues nëse i pandehuri meriton një vendim të tillë⁴⁸. Edhe për skaj këtij kushti në seancën gjyqësore, gjatë hetimit prokurori është i obliguar që të gjejë edhe dëshmi që janë në favor të të pandehurit dhe këta dëshmi ti prezantojë përpara mbrojtjes.⁴⁹

Kur rasti është caktuar të dalë në seancë, gjyqtari i seancës pranon dosjen e seancës.

Përmbajtja e dosjes së seancës përbëhet me dokumente të padisë, me dëshmi materiale të lidhura me veprën, me dëshmitë e grumbulluara me përdorimin e “incidente probatorio”, me dosjen kriminale të të pandehurit, deklaratat civile, dhe nëse nuk është e mundur që përsëri të merren, me regjistrim të dëshmimeve të grumbulluara nga policia ose prokurori⁵⁰.

Sipas nenit 190 të Kodit për Procedurë Penale dëshmia “merret me kërkesë të palës”, që do të thotë se secila palë përfaqëson rastin e vet me anë të ftuarit të dëshmitarëve për të dhënë dëshmi dhe pastaj për t’u marrë në pyetje. Palët sigurojnë dëshmi dhe gjykatësi mund të përjashtojë vetëm dëshminë e cila nuk është relevante dhe e nevojshme.

Në seancë prokurori hapë procedurën gjyqësore dhe më pastaj vazhdojnë ndonjëra nga palët private pjesëmarrëse ose ato palë të cilat kërkojnë dëmshpërblim dhe, më në fund i pandehuri⁵¹. Palët mund që të dërgojnë për gjykatën deklaratat të shkruara si aide memories. Dëshmia e prokurorisë prezantohet e para, e më pas vijnë ekspertët dhe dëshmitarët teknikë ose ndonjë palë tjetër privatë e cila ka dhënë pëlqimin e saj për t’u ekzaminuar. Renditja e pyetjeve si në të drejtën zakonore ashtu edhe në sistemin kundërshtues janë marrja në pyetje të drejtpërdrejta, pyetje të kryqëzuara dhe marrja e serishme në pyetje⁵². Pas pyetjeve të kryqëzuara gjykatësit

⁴⁶ Neni 190 bis Kodi i Procedurës Penale 1988.

⁴⁷ Neni 190 i kodit të Procedurës Penale 1988.

⁴⁸ Shiko Astolfo Di Amato “Italia” në Enciklopedinë ndërkombëtare të Drejtësisë, Volumi 3, E drejta penale, Kluver 2008, para. 396, duke ju referuar Vendimit të Gjykatës Kushtetuese Italiane nu. 190/170, 88/1991, 11/1993 dhe 241/1994 (“Astolfo Di Amato, ‘Italy’”).

⁴⁹ Neni 354 i Kodit të Procedurës Penale 1988.

⁵⁰ Neni 431 i Kodit të Procedurës Penale 1988.

⁵¹ Neni 396 i Kodit të Procedurës Penale 1988.

⁵² Neni 498 i Kodit të Procedurës Penale 1988

mund ta pyesin dëshmitarin.⁵³ Sidoqoftë, në praktikë procesi është shumë më fleksibil se në sistemin e të drejtës zakonore procedura kundërshtuese.

Gjyqtari (ose gjykata) ka një rol më aktiv në këtë procedurë se sa në sistemin e të drejtës zakonore atij i lejohet të thërrasë dëshmitarët sua sponte “çdoherë kur është absolutisht e domosdoshme” në fund të dëshmive të palëve. Gjykatësi kryesues merr në pyetje së pari dëshmitarin dhe vendos renditjen e marrjes në pyetje nga ana e palëve⁵⁴. Gjykata Supreme Italiane përshkruan këtë fuqi si “fuqi suplementare por, me siguri se, jo të jashtëzakonshme”⁵⁵. Më së shpeshti në praktikë gjykata emërton dhe thërret një dëshmitar ekspert si një dëmtar gjykate, zakonisht gjykata i vë ekspertët mes dëshmitarëve të parë të cilët duhet që të dëgjohen në një seancë gjyqësore. Gjykata mund që gjithashtu të grumbullojë dëshmitë e veta pasi që palët të kenë mbaruar me dëshmitë e tyre.⁵⁶

Meqë seanca hibride kundërshtuese Italjane nuk është e degëzuar siç është tek sistemi i të drejtës zakonore kundërshtuese koncepti i rastit prima facie, si i tillë, nuk ekziston. Andaj rasti nuk përfundon automatikisht pas prezantimit të rastit të prokurorisë, madje edhe nëse prokurori nuk ka prezantuar dëshmi mbi të cilat gjyqi do të mund të ndëshkonte të pandehurin për veprën me të cilën ngarkohet. Dërgesat ndëshkuese, jo sikurse në të drejtën zakonore, bëhen përpara gjykatës përpara se gjykata të themelojë fajin e të pandehurit.

Roli dhe pjesëmarrja e të pandehurit dallon nga ajo e sistemeve të të drejtës za konore. I pandehuri mund të jep dëshmi, por ndryshe nga sistemi i të drejtës zakonore, ai ose ajo nuk japin betimin kur dëshmojnë, përkundër dhënies së deklaratës në gjyq pa betim të dhënë. Nëse i pandehuri zgjedh të dëshmojë, çdo gjë e thënë ose e pa thënë mund të përdoret në vlerësimin e dëshmisë. Ndryshe nga sistemet e ligjit zakonor, i pandehuri mund të japë deklarata spontane gjatë seancës.⁵⁷ I pandehuri nuk mund që ti ike pyetjeve për përgjegjësinë e mundshme të një personi tjetër.⁵⁸ I pandehuri mund që të mbrohet me të drejtën e tij ose saj me heshtje gjatë seancës gjyqësore por kjo në anën tjetër i mundëson gjykatës që të pranojë si dëshmi çdo deklaratë e dhënë më parë tek prokurori, policia gjyqësore, gip ose gup.⁵⁹

Dëshmitë e fituara me shkelje të “ndalesave të vendosura me ligj mund të mos përdoren” në seancë dhe me këtë ato janë të përjashtuara.⁶⁰ Megjithatë, polemika ekziston në aspekt nëse bëhet fjalë për shkelje procedurale apo ligj përmbajtjesor dhe kjo është një çështje e hapur për interpretim.

⁵³ Neni 506 i Kodit të Procedurës Penale 1988

⁵⁴ Neni 507 i Kodit të Procedurës Penale 1988

⁵⁵ Vendimi i gjykatës Supreme Italiane, Cass.penale No. 1317 2224, 2231 -32, 2234 (1993)

⁵⁶ Neni 507 i Kodit të Procedurës Penale 1988

⁵⁷ Neni 494 i Kodit të Procedurës Penale 1988

⁵⁸ Astolfo Di Amato, “Italy”, para. 475, i cili i referohet vendimit të gjykatës kushtetuese Italiane no. 361/1998.

⁵⁹ Neni 513 (1) i Kodit të Procedurës Penale 198

⁶⁰ Neni 191 i Kodit të Procedurës Penale 1988

Dëshmitë e nxjerra nga secila palë mund që të shfrytëzohen nga të gjithë palët tjera të përfshira në procedurë.⁶¹

Gjykata kontrollon mënyrën e pyetjeve duke u siguruar në saktësinë dhe drejtësinë e pyetjeve dhe vërtetësinë e përgjigjeve. Pyetjet duhet që të janë të ndërlidhura me ndonjë fakt relevant të procedurës.⁶² Pyetësi gjithashtu duhet që të tregojë respekt drejt dëshmitarit.⁶³

Mundet që të ketë konfrontime mes dëshmitarëve të ndryshëm, të cilat janë të pa pranueshme për të drejtën zakonore kundërshtuese, në këto raste seanca do vazhdojë.⁶⁴ Gjykata gjithashtu mund që të lejojë njohjen e dëshmime ricognizioni ku një objekt apo një person është vendosur pranë ose së paku dy objekteve të tjera ose personave në gjyq.⁶⁵

3.4. Marrja në pyetje të drejtpërdrejta

Pala që fton dëshmitarin është e detyruar të sigurojë njoftim paraprak për gjykatën dhe oponentin në lidhje me emrat e dëshmitarëve dhe të tregojnë subjektin që është çështje e marrjes në pyetje. Të pandehurit, si kundërshtues të prokurorisë, nuk ju kërkohet të bëjnë një gjë të tillë në seancat gjyqësore të të drejtës zakonore në përgjithësi.

Avokatët nuk duhet që të pyesin pyetje jo udhëheqëse siç është rasti në sistemin e të drejtës zakonore në marrjen në pyetje në përgjithësi esame dirreto. Janë të ndaluara pyetjet sugjestionuese, për shkak se ata janë pyetje të cilat do të dëmtonin “sinqeritetin” e përgjigjeve.⁶⁶ Përgjigjet e dhëna në pyetjet sugjestionuese janë të papranueshme gjatë marrjes kryesore në pyetje, por ato janë të pranueshme nëse merren gjatë pyetjeve të kryqëzuara.

Në përmbyllje të marrjes në pyetje gjykatësi mund t’ju parashtrojë pyetje dëshmitarëve, dhe mund të tregojë çështje tjera plotësuese të cilat duhet të adresohen. Ndryshe nga sistemet e të drejtës zakonore ku gjykatësi pritet të qëndrojë neutral në raste të këtilla.

Edhe në marrjen kryesore në pyetje edhe në pyetjet e kryqëzuara dëshmia e karakterit të dëshmitarit është e papranueshme përderisa ajo nuk përdoret si provë e modus operandi.⁶⁷ Mund të lejohet një gjë e tillë nëse palët pajtohen për pranimin e tij. Thashethemet në përgjithësi nuk janë të pranueshme pa pasur pëlqimin e palëve dhe gjyqi mund të kërkojë provë origjinale të dëshmisë me thashetheme.⁶⁸

⁶¹ Neni 495 i Kodit të Procedurës Penale 1988

⁶² Neni 194, 499 (2) i Kodit të Procedurës Penale 1988

⁶³ Neni 499 (4) i Kodit të Procedurës Penale 1988.

⁶⁴ Neni 211 dhe 212 i Kodit të Procedurës Penale 1988

⁶⁵ Neni 214 (2) i Kodit të Procedurës Penale 1988

⁶⁶ Neni 499 (2) dhe (3) i Kodit të Procedurës Penale 1988

⁶⁷ Neni 194 i Kodit të Procedurës Penale 1988

⁶⁸ Neni 195 Kodi i Procedures Penale 1988.

Deklaratat e dhëna jashtë gjykatës në princip duhet të përdoren vetëm për qëllim të vënies së tyre në dyshim, përveç rasteve kur palët pajtohen, ose kur është e qartë se dëshmitari ka qenë shënjestër dhune, i kërcënimit, ose i paguar me para, apo nuk ka dëshirë të japë dëshmi.⁶⁹

Dëshmitarët - ekspertë janë të caktuar nga gjykata dhe ata mund të merren në pyetje ex officio nga gjykata⁷⁰. Pastaj palët mund të pyesin ekspertin.

3.5. Pyetjet e kryqëzuara

Seksioni 111 (3) i Kushtetutës Italiane garanton se të gjitha palët pjesëmarrëse në seancë trajtohen në baza të barabarta,

“I pandehuri duhet të ketë të drejtën për pyetje të kryqëzuara ose të ketë pyetje të kryqëzuara përpara gjykatësit dhe personave të cilat e akuzojnë dhe i ekzaminonë personat për mbrojtje në të njëjtën gjendje si edhe prokuroria, si dhe të drejtën që të prodhojnë të gjitha dëshmitë e tjera në dobi të mbrojtjes”.

Lejohet parashtrimi i pyetjeve sugjestionuese dhe qëllimi i pyetjeve të kryqëzuara është në thelb ajo siç është përshkruar më lart në relacion me Anglinë dhe Uellsin, me qëllim që të zhvillojnë rastin për mbi pyetjet e kryqëzuara me qëllim që të shkaktojë dyshim në çështjen e palës kundërshtuese.

Avokatëve u lejohet të sulmojnë kredibilitetin dhe besueshmërinë e dëshmitarëve gjatë pyetjeve të kryqëzuara dhe sikur se tek proceset gjyqësore të të drejtës zakonore, avokati që bën pyetjet e kryqëzuara mund që të përdorë deklaratat paraprake të dhëna jashtë gjykatës me qëllim që të sulmojë kredibilitetin dhe besueshmërinë e dëshmitarëve. Deklaratat paraprake mund që të pranohen si dëshmi të së vërtetës.

Kushtetuta gjithashtu siguron që asnjë i pandehur të mos dënohet në bazë të deklaratës së dhënë gjatë fazës preliminare nga ana e ndonjë personi i cili qëllimisht i shmanget pyetjeve të kryqëzuara nga ana e mbrojtjes.⁷¹

Në disa rrethana, i pandehuri që jep dëshmi mund të pyetet në kryqëzim për ti kundërshtuar ata me dëshminë e dhënë jashtë gjykatës.

3.6. Pyetjet plotësuese

Kodi nuk lejon pyetjet plotësuese siç është rasti me Bosnjë e Hercegovinën. Sidoqoftë, funksioni i pyetjeve plotësuese në seancat gjyqësore në Itali është, në realitet, ajo që u përshkrua më lartë në lidhje me Anglinë dhe me Uellsin, ashtu që pyetjet jo sugjestionuese mund që të parashtrihen me qëllim që të sqarohen çështje nga pyetjet e kryqëzuara dhe të “rehabilitojnë” një dëshmitar.

⁶⁹ Neni 513 Kodi i Procedurës Penale 1988.

⁷⁰ Nenet 224, 468 dhe 501 i Kodit të Procedurës Penale 1988.

⁷¹ Seksioni 111 (4) Kushtetuta Italicane.

4. BOSNJA E HERCEGOVINA

4.1. Hyrje dhe përshkrim

Bosnja e Hercegovina, tradicionalisht ka sistem të së drejtës civile hetuese, tani ajo aplikon një metodë të seancave kundërshtuese me rastet e qarta të sjella nga ana e prokurorit dhe mbrojtjes. Para shpalljes së Kodit për Procedurë në vitin 2003, sikur edhe në sistemet tjera juridike në ish Jugosllavi, gjykatësi udhëhiqte marrjen në pyetje të dëshmitarit. Reformat e vitit 2003 sollën një sistem hibrid kundërshtues e cila i jepte rëndësi të veçantë shkarkimit të gjyqtarit hetues në dobi të një prokurori të pavarur, duke miratuar ndarjen e çështjeve të prokurorisë në seancën gjyqësore, në mënyrë që më sollën një mënyrë më të rregulluar për marrjen e dëshmitarëve në pyetje të ngjashëm me atë të sistemit të së drejtës zakonore. Tani më palët thërrasin dëshmitarët e vet gojarisht ndërsa palët e lënduara ose dëmtuara nuk marrin pjesë si palë në procedurë siç janë parties civiles në sistemin hetues.

Sistemin hibrid kundërshtues të Bosnjës dhe sistemi gjyqësor Italian, dallojnë nga e drejta zakonore në disa pika të rëndësishme. Ndër këto përfshihet edhe ajo se dëshmia mund të merret edhe pa respektuar renditjen rigorozë të paraparë në të drejtën zakonore, ku i pandehuri mund të flasë në mënyrë spontane në çdo kohë, që prej tij nuk kërkohet të japë dëshmi nën betim, dhe në përmbllje të rastit të prokurorisë nuk ekziston procedurë “nuk ka rast” ku ai mund të anulohet për shkak të mungesës së rastit *prima facie*.

Kodi për Procedurë ka dispozita të ngjashme me incidente probatorio Italiane, në kapitullin “Ruajtja e Dëshmive nga ana e Gjykatës”. Me kërkesë të palës gjykatësi i seancave preliminare mund të japë urdhër për dëgjim special të dëshmisë së një dëshmitari i cili mund të mos jetë në dispozicion për seancën kryesore. Dëgjimi kryhet në pajtim me nenin 262 (është marrja në pyetje e drejtpërdrejtë, pyetjet e kryqëzuara dhe pyetjet plotësuese – termet e përdorura në përkthimin anglez). Deklarata mund të përdoret si dëshmi vetëm në seancën kryesore nëse vërtetohet se të gjitha përpjekjet për të siguruar prezencën e dëshmitarit kanë nuk ka qenë e suksesshme. Disa gjykata kanë përkthyer në mënyrë liberale këta më qëllim që të përfshijnë situatat në të cilat dëshmitarë nuk duan që të dëshmojnë.

Kjo procedurë gjithashtu është në dispozicion për ruajtjen e dëshmive të cilat mund të zhduken para seancës ose mund të mos jenë në dispozicion në seancë. Me kërkesë të palës, gjykatësi mund të ndërmerr “çfarëdo hapash të nevojshme” për sigurimin e dëshmisë⁷².

4.2. Seanca gjyqësore

Kodi i Procedurës penale përcakton një renditje të qartë të palëve në seancën gjyqësore si prokurori, i pandehuri, dhe avokati mbrojtës si dhe një të drejtën e të pandehurit (ose të “akuzuarit” siç është në përkthimin anglez) si “palë” për të marrë në pyetje dëshmitarët ose të

⁷² Neni 223 i Kodit të procedurës penale 2003

flasë në mënyrë spontane dhe natyrisht janë të drejtuar për të mbrojtur çdo koment në procesin gjyqësor për argumentet përmbyllëse të tyre.

Seanca gjyqësore tani më tepër përngjan menjë garë mes palëve se sa thjesht kërkim i së vërtetës, njëlloj si në sistemet e të drejtës zakonore. Me Nenin 239 (2) sigurohet që “Gjykatësi ose gjykatësi i çështjes e ka për obligim që të sigurojë se çështja e lëndës është ekzaminuar plotësisht, e vërteta është gjetur”. Ndryshimet e Kodit në 2008 fshinë referencën për obligim e gjetjes së të vërtetës, sidoqoftë referenca për gjetjen e së vërtetës mbetet në Nenin 262 (3) nga ku kërkohet që gjyqtari hetues të “ushtrojë kontrollin mbi mënyrën dhe renditjen e pyetjeve të dëshmitarëve dhe prezantimit të dëshmive të jetë në mënyrë që të rrjedhë e vërteta”. (Statuti i Gjykatës ndërkombëtare të Krimeve ka një referencë të ngjashme për të vërtetën, shiko më poshtë).

Si në Angli dhe Uells dhe në Itali, prokuroria hap çështjen dhe prezanton dëshmitë e veta duke ftuar dëshmitarët që të dëshmojnë gojarisht.

Me Kodin përcaktohen rregulla strikte për prezantimin e dëshmive në seancën gjyqësore si a) dëshmitë e prokurorisë; b) dëshmitë e mbrojtjes; c) refuzimi i dëshmive të prokurorisë; ç) dëshmitë si përgjigje për dëshmitë e refuzuara të prokurorisë; d) dëshmitë prezantimi i të cilave bëhet me urdhër të gjykatësit ose të Panelit; dhe dh) të gjitha dëshmitë relevante për kumtimin e sanksionit penal.⁷³

Gjykata mund të “urdhërojë largim nga renditja e rregullt e procedurave për shkak të rrethanave speciale dhe në veçanti nëse ato kanë të bëjnë me numrin e të pandehurve, në numrin e shkeljeve dhe në sasinë e dëshmive”⁷⁴. Kjo nuk është e pazakonshme në praktikë dhe është e kuptueshme në aspekt të kulturës juridike të gjatë të një procesi gjyqësor hetues.

Me Kodin gjithashtu parashihet se “Gjatë prezantimit të dëshmive duhet të lejohet marrja e drejtpërdrejtë në pyetje, pyetjeve të kryqëzuara dhe atyre plotësuese. Pala e cila ka ftuar dëshmitarin duhet ta marrë atë në pyetje të drejtpërdrejtë, por gjykatësi ose paneli në çdo fazë të marrjes në pyetje mundën t’i parashtrajnë pyetje dëshmitarit”⁷⁵. (Në përkthim është përdorur terminologji amerikane).

Gjykata obligohet që të ushtrojë kontrole të përshtatshme mbi mënyrën dhe renditjen e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe të prezantimit të dëshmive ashtu që marrja në pyetje dhe prezantimi i dëshmive të jenë efikas për vërtetimin e të vërtetës, të shmanget humbja e kohës, ndërsa dëshmitarët të mbrohen nga ngacmimet dhe hutimi⁷⁶.

⁷³ Neni 223 i Kodi i Procedurës Penale 2003

⁷⁴ Neni 261 i Kodi i Procedurës Penale 2003

⁷⁵ Neni 262 (1) i Kodi i Procedurës Penale 2003

⁷⁶ Neni 262 (3) i Kodi i Procedurës Penale 2003

Kodi po ashtu parasheh se gjyqi duhet të ndalojë pyetjet dhe përgjigjet e papranueshme dhe ato të cilat përsëriten, si dhe të refuzojë prezantimin e dëshmive të këtilla.⁷⁷

Janë të ndaluara të gjitha pyetjet të ndërlidhura me ndonjë përvojë seksuale që pala e dëmtuar ka përjetuar ka pasur, ose orientimit seksual (përveçse dëshmive të cilat tregojnë gjendjen psikike të të pandehurit).⁷⁸

4.3. Marrja në pyetje të drejtpërdrejta

Kodi i procedurës penale përkufizon “marrjen e drejtpërdrejtë në pyetje” si pyetje dëshmitari ose të dëshmitarit ekspert nga ana e palës ose të avokatit mbrojtës i cili fton dëshmitarin ose dëshmitarin ekspert për të dhënë dëshmi⁷⁹.

Pala e cila e thërret dëshmitarin më së pari e pyet në përgjithësi dëshmitarin. Gjykatësit mund që të pyesin dëshmitarin në çdo kohë.⁸⁰

Lidhur me pyetjet sugjestionuese, Kodi përcakton se “pyetjet sugjestionuese nuk duhet të përdoren gjatë marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje, përveç në rast se ka nevojë për sqarim të dëshmisë së dhënë të dëshmitarit. Si rregull, pyetjet sugjestive duhet të lejohen vetëm gjatë pyetjeve të kryqëzuara. Kur një palë fton dëshmitarët të një pale kundërshtare ose kur dëshmitari është armiqësor ose jo-bashkëpunues, gjykatësi ose gjykatësi kryesues, me diskrecion të vetin, mund të lejojnë përdorimin e pyetjeve sugjestionuese”⁸¹.

Një ose më shumë këshilltarë të të pandehurit, dhe i pandehuri mund të pyesin dëshmitarët gjatë marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje. Natyrisht, i pandehuri pyet çfarëdo pyetje kur të mbarojë marrja në pyetje nga ana e avokatit mbrojtës. Praktikë e gjykatës të Bosnjë Hercegovinës është që të pyesë të pandehurin nëse ai ose ajo kanë ndonjë pyetje plotësuese prej atyre të bëra nga ana e këshillit. Natyrisht, të pandehurit e lënë marrjen në pyetje plotësisht në duart e avokatëve.

Të gjitha deklaratat e dhëna paraprakisht si dëshmi gjatë fazës hetimore janë të pranueshme në pyetjet në përgjithësi.⁸² Kjo përgjithësisht kufizon deklaratat e dhëna përpara hetuesve ose prokurorëve në pajtim me Kodin. Nga sistemet e të drejtës zakonore meqë ato në përgjithësi nuk lejojnë ofrimin e këtyre deklaratave gjatë marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje. Megjithatë, efekti praktik i Bosnjë Hercegovinës thjesht siguron gjykatën edhe me dëshmi gojore brenda gjykatës dhe me deklarata hetimore që kanë të bëjnë me të njëjtën materie të rastit, pavarësisht nga rëndësia e deklaratave hetimore. Është një paraqitje e çuditshme e sistemit hibrid i cili aplikon sistemin gjyqësor kundërshtues.

⁷⁷ Neni 263 i Kodi i Procedurës Penale 2003

⁷⁸ Neni 264 i Kodi i Procedurës Penale 2003

⁷⁹ Neni 20 i Kodi i Procedurës Penale 2003

⁸⁰ Neni 262 i Kodi i Procedurës Penale 2003

⁸¹ Neni 262 (2) Kodi i Procedurës Penale 2003

⁸² Neni 273 Kodi i procedurës Penale 2003

Gjyqi mund të urdhërojë, gjithashtu, prezantimin e dëshmime⁸³. Në këtë rast gjyqi i pari pyet dëshmitarin dhe pastaj lejon që palët dhe avokati mbrojtës të marrin në pyetje atë.

Në praktikë, gjykatësi ose anëtarët e panelit në përgjithësi bëjnë pyetje pas mbarimit të marrjes në pyetje të dëshmitarit, edhe pse ato kanë të drejtën për t'i bërë pyetje dëshmitarit në çdo kohë. Praktika ndryshon në mes paneleve të seancave dhe gjykatësve individual.

4.4. Pyetjet e kryqëzuara

Të gjithë dëshmitarët mund të pyeten në kryqëzim. Kodi përkufizon “pyetjet e kryqëzuara” si marrje në pyetje të dëshmitarit ose ekspertët dëshmitarë të palës, ose avokatin e mbrojtjes si pyetje të dëshmitarit ose dëshmitarit ekspert nga ana e palës ose e avokatit mbrojtës i cili nuk ka ftuar dëshmitarin ose ekspertin dëshmitar për të dhënë dëshmi. Parashtrimin e pyetjeve sugjestionuese është i lejueshëm.⁸⁴

Neni 262 në fillim impononte kufizime rigorozë në lidhje me pyetjet e kryqëzuara duke thënë: “Pyetjet gjatë pyetjeve të kryqëzuara duhet të jenë të limituara dhe duhet të jenë në lidhje me pyetjet e parashtruara gjatë marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje”.

Më pastaj ai është ndryshuar për të bërë tërë procesin më të drejtë për të gjitha palët. Neni 262 (2) tani siguron që: “Pyetjet në pyetjet e kryqëzuara të jenë të limituara dhe duhet të jenë në lidhje me pyetjet e parashtruara gjatë marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje në mbështetje të deklaratave të bëra nga pala e cila bën pyetjet e kryqëzuara të dëshmitarit.”

Kjo mund të interpretohet gjerësisht, por më e rëndësishme është se tani është në përputhje me frymën dhe qëllimin e seancave gjyqësore kundër-shtuese. Pyetjet e kryqëzuara mund të përfshijë një sulm mbi besimin ndaj dëshmitarit.

Pyetjet e kryqëzuara gjithashtu lejohet edhe për deklaratat paraprake të dhëna gjatë fazës hetimore. Ato po ashtu mund të përdoren në kundërshtimin ose në përgjigje ku dëshmitarit duhet t'i jepet mundësia për të shpjeguar ose mohuar një deklaratë paraprake.

Përskaj vendosjes në dosje të dëshmime, dëshmitë e dhëna me betim e të marra gjatë dëgjimit gjyqësor, Ligji për Përcjellje të Rasteve (i përdorur në rastet e krimeve të luftës) bën një përjashtim të rëndësishëm i cili lejon pyetjet e kryqëzuara. Ky ligj lejon gjyqin të pranojë në dosje të dëshmime dëshminë e dhënë nga dëshmitari në seancat e mbajtura të TNKJ-së ose deklaratat e dhëna hetuesve të TNKJ-së. Gjyqi mund të pranojë dëshmi me shkrim pa kërkuar nga dëshmitari të japë dëshmi gojore.

E drejta për pyetje të kryqëzuara nuk është automatike. Neni 5 (3) thotë se pranimi i dëshmime dhe i transkriptit në dosje të dëshmime nuk paragjykon të drejtën e të pandehurit për pyetje të

⁸³ Neni 262 Kodi i procedurës Penale 2003

⁸⁴ Neni 20 Kodi i procedurës Penale 2003

kryqëzuara por “vendimin në bazë të kërkesës duhet ta sjell gjyqi”⁸⁵. Kjo dispozitë është e zbatueshme në rastet e krimeve të luftës dhe është e dizajnuar për të lehtësuar pranimin e dëshmive në rrethana të veçanta. Në praktikë panelët gjyqësorë kanë aprovuar disa kërkesa për pyetjet e kryqëzuara dhe në raste tjera i kanë refuzuar. Gjyqi në Bosnje e Hercegovinë ka përpiluar udhëzime për vendosje lidhjesh me kërkesat të cilat tregojnë nëse dëshmia është konfirmuese. Për shembull, është vërejtur se.⁸⁶

“Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme do të lejohen prokurorinë të ofrojë deklarata dëshmie nga dëshmitarët të cilët i pandehuri nuk ka pasur mundësi ta pyesë në kryqëzim. Princip i përgjithshëm është se personat e pandehur duhet të lejohen të ftojnë ose të marrin në pyetje çdo dëshmitar, dëshminë e të cilit ata e konsiderojnë relevante për rastin, dhe medoemos duhet të kenë mundësinë të marrin në pyetje secilin dëshmitar i cili thirret, ose dëshmia e të cilit mbështetet nga ana e prokurorit”.

Në rast të këtillë, paneli gjyqësor refuzon t’i japë leje Prokurorit për të ofruar për në dosje të dëshmive dëshminë e dhënë paraprakisht nga ana e viktimës së përdhunuar që nuk do të thirrej për të dëshmuar, në bazë të asaj se dëshmia e saj do të ishte e vetmja dëshmi kundër të pandehurit për atë krim të posaçëm.

4.5. Pyetjet plotësuese

Pyetjet gjatë rimarrjes në pyetje kufizohen në pyetjet të cilat janë parashtruar gjatë pyetjeve të kryqëzuara⁸⁷, sidoqoftë gjykata mund që të lirojë ndonjërin nga palët që ti përmbahet kësaj rregulle. Kjo praktikë dhe sqarimi i saj janë të ngjashme me atë të sistemeve të të drejtës zakonore si për shembull në Angli dhe Uells, siç u përshkrua më lart.

5. GJYKATAT DHE TRIBUNALET NDËRKOMBËTARE PENALE

5.1. Hyrje dhe përshkrim

Në praktikën e gjykatave dhe tribunaleve ndërkombëtare jepet një krahasim i dobishëm me sistemet tona nacionale. Sistemi ndërkombëtar synon që të shkojë drejt një sistemi hibrid të kombinuar mes të drejtës zakonore dhe sistemit hetues në seancat gjyqësore, i cili lejon që të ketë një fleksibilitet i cili jo gjithmonë është i pranishëm në sistemet e ndryshme kombëtare.

Tribunali Ndërkombëtar për Krime për Ish-Jugosllavinë (TNKJ) dhe Tribunali Ndërkombëtar për krime për Ruandën (TNKR) janë dy tribunale ad hoc të Kombeve të bashkuara, statutet e të cilëve janë përfshirë në rezolutën e Këshillit të Sigurisë. Gjyqtarët në gjykatë mbajnë përgjegjësi për rregullat procedurale si dhe për dëshmitë e tyre. Statuti i TNKR, rrjedh si rezultat i një procesi shumë të gjatë bisedimesh mes shteteve të përfshira dhe organizatave ndërqeveritare dhe OJQ.

⁸⁵ Ligji mbi Transferimin e Çështjeve të TNKJ deri tek Zyra e Prokurorit të BH dhe Përdorimi i dëshmive të mbledhura nga TNKJ në procedurën përpara BdheH, 2004.

⁸⁶ Zyra prokurorisë të Bdhe H v Gojko Jankovic X-KRZH-05/161 Vendimi, 16 Shkurt 2007.

⁸⁷ Neni 262 (1) Kodi i Procedurës Penale 2003.

Rregullat e tij u miratuan nga shtetet anëtare pas një periudhe disa vjeçare bisedimesh e negociimesh. Për këtë shkak TNK është e përfaqësuar nga një numër më i madh i shteteve se sa është për shembull TNKJ. Roli i gjyqtarëve të TNKR dhe TNKJ është në mes sistemeve të pastra të së drejtës zakonore dhe modelit të hetuesisë.

TNKJ dhe TNKR përcjellin procedurat gjyqësore sipas të drejtës zakonore kundërshtuese, me atë që pala fton dëshmitarët duke i pyetur ata në përgjithësi, palët tjera bëjnë pyetjet e kryqëzuara, në fund bëhet edhe rimarrja në pyetje. TNKR-ja është më fluide me rregulloret e veta të cilat i lejojnë dëshmitarët të japë një deklaratë në formë të lirë e cila më pas përcillet me pyetje nga ana e gjykatësve e dikur edhe nga ana e palëve.⁸⁸ Kjo procedurë mund të ndryshojë; për shembull që të dy seancat gjyqësore në Lubanga dhe Katangë kanë përvetësuar modelin kundërshtues të së drejtës zakonore për mënyrën e prezantimit të dëshmive. Kjo ka një vlerë më të lartë; në procedurat që janë të gjata dhe të ndërlikuara ku palët thërrasin dëshmitarët e tyre, pasi që kanë kaluar një proces tepër të vështirë të marrjes së deklaratave dhe përgatitjes së një çështje të veçantë, është shumë më mirë që të pyeten dëshmitarët se sa të pyeten gjykatësit të cilët për radhë të parë takojnë dëshmitarët për radhë të parë në gjykatë.

Në juridiksionin ndërkombëtar, i pandehuri ka të drejtë të japë “përgjigje dhe mbrojtje të plotë” ndaj akuzës. Pyetja e kryqëzuar lejohet dhe gjykatësit mund të pyesin dëshmitarët në çdo fazë të procesit. Në TNKJ dhe në TNKR janë futur disa kufizime për të drejtën e pyetjeve të kryqëzuara së dëshmitarëve të caktuar.

TNKJ-ja dhe TNKR-ja nuk parashohin pjesëmarrje të viktimës në procesin gjyqësor. Për dallim, TNK dhe Tribunali Special për Libinë (TSL-ja) kanë dispozita statusore për pjesëmarrjen e viktimave në seancën gjyqësore, përfshirë këtu edhe thirrjen e dëshmitarëve të vet dhe marrjen në pyetje të kryqëzuara të atyre që thirren nga ana e prokurorit dhe e mbrojtjes.

5.2. Tribunali Ndërkombëtar për Krime për ish-Jugosllavinë

Statuti i TNKJ-së garanton të drejtën e pandehuri (i ashtuquajtur “i akuzuari” në Statutin) të marrë në pyetje ose të kërkojë që tjetër kush të marrë në pyetje dëshmitarët që është kundër tij ose saj dhe të jetë prezent dhe të merret në pyetje në të njëjtat kushte sikur që është dëshmitari kundër tij ose asaj.⁸⁹ Kjo mundëson të drejtën e të pandehurit për të konfrontuar dëshmitarët dhe imponon një detyrë pozitive të Tribunalit për të asistuar të pandehurin të sigurojë pjesëmarrjen e dëshmitarëve në seancën gjyqësore.

Rregullorja e Procedurave dhe Dëshmive në fakt janë mjaft të shpërndara kur ata i krahasojmë me kodet për procedurë penale nacionale dhe me procedurat e së të drejtës zakonore. Rregulla e

⁸⁸ Shiko rregullën 21 (4) të Statutit të TNKJ

⁸⁹ Neni 21 (4) nga Statuti i TNKJ

vetme që ekziston është që një dhomë mund të dorëzojë dëshmi relevante që ajo i vlerëson të kenë vlerë dëshmuuese.⁹⁰

TNKJ ka një dispozitë që favorizon dëshminë gojore mirëpo që nga fillimi i vet ajo ka lëvizur drejt rritjes së përdorimit të deklaratave gojore, e vërteta e së cilës është vërtetuar nga dhënësi i deklaratës. Versioni origjinal i Rregullores 90 (A) parashihte që një dëshmitar duhej të dëgjohej drejtpërdrejtë nga anëtarët e dhomës përveç nëse jepej urdhër që dëshmitari të dëgjohej me dëshmi të depozituar. Me kalimin e kohës ndryshojnë rregullat për të lejuar që anëtarët e dhomës të pranojnë dëshmi me shkrim në vend të dëshmisë gojore, “aty ku lejon interesi i të drejtës”⁹¹ gjykata mund që të pranojë marrjen e deklaratave me shkrim, me pyetjet e kryqëzuara, ose me rrethanat e përshkruara.⁹²

TNKJ zakonisht ju jep kohe të mjaftueshme secilës palë për të prezantuar çështjen e tyre. Koha që i jepet mbrojtjes për pyetjet e kryqëzuara shpesh është në raport të 60% të kohës e cila i lejohet Prokurorisë. Sqarimi për këtë që përmendëm më lartë është se prokuroria duhet që të përdëftojë çështjen përtej dyshimit të arsyeshëm kurse mbrojtja duhet vetëm që të vejë dyshimin në të. Kjo me siguri që i kufizon pyetjet e kryqëzuara. Duke krahasuar me sistemet e pastra të së drejtë civile si ata të Anglisë dhe Uellsit, sigurisht që kufizimet kohore në pyetjet e kryqëzuara janë të shumë të rralla. Disa nga këshillat gjyqësorë të TNKJ refuzojnë që të specifikojnë kufizimet në pyetjet e kryqëzuara; në të vërtetë nëse kjo do të ndodhë ose jo krejtësisht varet nga përbërja e panelit tre anëtarësh të trupit gjykues.

Dhoma po ashtu ka leje të thërrasë dëshmitarët e vet dhe mund t'i merr në pyetje ata në çdo kohë dhe, mund të detyrojë nxjerrjen e materialit dëshmuues proprio motu. Megjithatë, kjo gjë paraqet një vështirësi të qartë në sistemet kundërshtuese në atë që këshilli i palëve duhet të ketë njohuri më të madhe për rastin dhe për secilin dëshmitar, duke lënë mundësi që gjykatësit të pyesin dëshmitarët “verbërisht”, madje edhe në veçanti në ato fusha në të cilat këshilli veç më i ka kërkuar jashtë gjykatës dhe i ka refuzuar.

Edhe prokurori edhe mbrojtja detyrimisht duhet të dorëzojnë “informacion paraprak” para fillimit të seancës gjyqësore duke prezantuar rastin e tyre dhe dallimet në mes çështjeve të veçuara. Para fillimit të rastit të tyre secila palë duhet të dorëzojë listën e dëshmitarëve dhe të argumenteve fizike, si dhe të përmbledhjeve të propozuara për dëshminë e menduar. Në Tribunalin Ndërkombëtar ndryshe nga sistemi i të drejtës zakonore ku palët kontrollojnë prezantimin e dëshmive, ata mund që të refuzojnë dëgjimin e disa dëshmitarëve dhe mund që të kërkojnë nga palët të shkurtojë zgjatjen e çështjeve të propozuara nga ata.

Pyetjet e kryqëzuara

⁹⁰ Rregulli 89 (C) Rregullat e Procedurës dhe Dëshmisë

⁹¹ Rregulli 89 (H) TNKJ Rregullat procedurale dhe të dëshmisë

⁹² Rregulli 92 bis, ter, quarterand quinquies të Rregullores të Procedurës dhe Dëshmiv

Palët kanë një diskrecion të gjerë për kundërekzaminimin e dëshmitarëve. Ata mund të kundërekzaminonjë për çështjet e nxjerra nga marrja në pyetje të drejtpërdrejta dhe për çështjet që ndikojnë në kredibilitetin e dëshmitarit dhe të materies që është subjekt i rastit.

Dhoma gjyqësore mundet gjithashtu të lejojë marrjen në pyetje të kryqëzuara për pyetje plotësuese.

Në fakt Rregullorja siguron më shumë liri veprimi për këshillin i cili zbaton pyetjet e kryqëzuara. Ajo që lejohet (dhe përkundër kundërshtimit) mund të varet nga përbërja e dhomës dhe përvoja vendore e gjykatësve.

Pala që bën pyetjet e kryqëzuara duhet të vendosin rastin e tyre te dëshmitari nëse kjo është në kundërtënie me dëshminë e dëshmitarit.⁹³ Mossuksesi në një gjë të këtillë mund të rezultojë tek pala që të mos marrë leje për të sjellë kundër dëshmi ose të bind për të kundërtën. Pritet gjithashtu nga pala të dorëzojë çfarëdo dëshmi specifike tek të cilat është referuar gjatë pyetjeve të kryqëzuara.⁹⁴

Pyetjet e kryqëzuara gjithashtu mund të kufizohet me vendosjen e kufizimeve kohore për pyetjet e kryqëzuara nga cilado palë⁹⁵. Dhoma gjyqësore mund të ushtrojë kontroll mbi mënyrën dhe renditjen e dëshmitarëve që merren në pyetje për qëllim që këtë ta bëjnë më efikase, së daljes së të vërtetës në shesh, si dhe të shmangies së humbjes së panevojshme të kohës. Në praktikë kjo mund të kufizojë të drejtat e këshillit për pyetjet e kryqëzuara në mënyrë efikase, veçanërisht, nëse marrja në pyetje bëhet përmes përkthimit mekanik (i cili ndan kohën e dhënë).

Dhoma gjyqësore mund të pranojë në dosjen e dëshmive deklaratën me shkrim të një dëshmitari “në vend të dëshmisë gojore e cila bëhet provë për një çështje përveç akteve të sjelljes së të pandehurit siç i cekë akuza”⁹⁶. Pas dëgjimit nga ana e palëve dhoma vendosë të kërkojë nga dëshmitari të jetë prezent për pyetjet e kryqëzuara.⁹⁷ Konsideratë thelbësore për vendosjen nëse të kërkojen pyetjet e kryqëzuara është nevoja për sigurimin e një gjykimi të drejtë.⁹⁸ Lejohet futja në dosje të dëshmive të deklaratës me shkrim, nëse dhënësi i deklaratës garanton për saktësinë e saj dhe është i pranishëm në gjykatë për pyetjet e kryqëzuara.⁹⁹ Deklarata mund të përmbajë çështje të cilat tregojnë për veprat dhe sjelljet e të pandehurit. Deklaratat nga personi i cili nuk është në dispozicion (i vdekur, nuk i dihet gjurma, ose është në pamundësi të japë dëshmi gojore shkaku i gjendjes fizike ose mendore) nëse rast se dhoma është e kënaqur me

⁹³ Regulli (90) i Regullave të procedurave dhe dëshmive të TNKJ

⁹⁴ Shiko shembullin Prosecutor v. Popović dhe të tjerëve IT-5-88-T “Regulat e vendosura për udhëhimet e procedurës sipas Regulës 90 (H) (ii)”, 6 Mars 2007.

⁹⁵ Regulli 90 (F) i Regullave të procedurës dhe dëshmive të TNKJ.

⁹⁶ Regulli 92 bis i Regullave të procedurës dhe dëshmive të TNKJ

⁹⁷ Shiko p.sh. Prosecutor v. Stanislav Galić IT-98-29/AR73.2 “Vendim mbi ankesën e bashkëpunuesit në lidhje me Regullin 92 bis (C)”, 7 Qershor 2002.

⁹⁸ Shiko p.sh. Prosecutor v. Fatmir Limaj dhe të tjerët IT-03-66-T “Vendimi mbi Ankesën e prokurorit për pranimin provizional të deklaratave të dëshmitarëve sipas rregullit 92 bis”, 15 Dhjetor 2004.

⁹⁹ Regulli 92 ter TNKJ Rregullorja e procedurës dhe dëshmive

besueshmërinë e saj¹⁰⁰. Ajo mund të përmban dëshmi të provave për veprat dhe sjelljet e të pandehurit.¹⁰¹

Në dhjetor 2009, Tribunali solli rregullore të ree cila lejon pranimin në dosje të dëshmive deklarativë e një dëshmitari në mungesë në rast se “dështimi i personit për të qenë i pranishëm ose për të dhënë dëshmi ka qenë i ndikuar nga aspekti material me ndërhyrje jo të përshtatshme, përfshirë këtu kërcënimet, frikësimin, lëndimin, ryshfetin, ose përdorimin e forcës”. Deklarata mund të shkon tek “vepra ose sjellje e të pandehurit” dhe dëshmitari nuk do këtë pyetje të kryqëzuara, mirëpo dhoma gjyqësore nuk do të mund të bazon dënimin vetëm në një deklaratë të këtillë¹⁰². Kjo rregull u soll pasi që Tribunali kishte një përvojë të keqe me vështirësitë për të siguruar dëshmi nga dëshmitarë relevant në disa raste edhe pas instancave të dokumentuara të frikësimit.

Diskreditimi i dëshmitarëve dhe deklarata paraprake kontradiktore

Pyetjet e kryqëzuara mund të përfshijnë edhe vënien në dyshim të dëshmitarit me një deklaratë të mëparshme kontradiktore.¹⁰³ Pala mund të venë në dyshim dëshmitarin e vet duke i prezantuar një deklaratë kontradiktore të mëparshme, në pyetjet e kryqëzuara për dëshmitarin e vet me deklarata kontradiktore të mëparshme. Meqë sistemi përdorë rregulla hibride të procedurave, dëshmitari nuk duhet patjetër zyrtarisht të shpallet “armiqësor” për të ndodhur kjo.¹⁰⁴ Dëshmitarët mund të konfrontohen në pyetjet e kryqëzuara me dokumente të cilët ende nuk janë ofruar për dëshmi.

Dëshmia e depozituar

Tribunali gjithashtu mund të urdhërojë procedurë për deponimin e dëshmive në seancën gjyqësore, pavarësisht nëse personi është në dispozicion të paraqitet para Tribunalit apo jo për të dhënë dëshminë. Dëshmitarët pyeten nga palët (në mënyrën e zakonit), depozitimet regjistrohen dhe merren në praninë e një zyrtari kryesues më mirë se përpara gjykatësit. Çdo vërejtje në pyetjet dhe përgjigje lihet për më vonë për vendimin nga Këshilli i Seancës Gjyqësore. Depozitimi mund të merret nga selia e Tribunalit në Hagë ose përmes video-lidhjes.¹⁰⁵

5.3. Tribunali Ndërkombëtare për Krime

Statuti i TNK-së përfshinë standardet sipas Nenit 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Politike dhe Civile (KNDPC) me të garanton të drejtën e të pandehurit (i ashtuquajtur i

¹⁰⁰ Regulli 92 ter TNKJ Regullorja e procedurës dhe dëshmive të TNKJ.

¹⁰¹ Shiko p.sh. Prosecutor v. Popović dhe të tjerët IT-05-98-T “Vendimi mbi prokurorinë për Ankesën për pranimin e Dëshmive sipas rregullit 92 quarter”, 21 Prill 2008.

¹⁰² Regulli 92 quinquies Regullorja e Procedurave dhe dëshmive.

¹⁰³ Shiko p.sh. Prosecutor v. Sefer Halilović IT-01-48-T “Vendimi mbi Pranimin e Dëshmive Paraprake nga Dëshmitarët”, 5 Korrik 2005.

¹⁰⁴ Prosecutor v. Popović dhe të tjerët IT-05-98-T “Vendimi mbi Ankesën kundër Vendimit në Dyshimin e deklaratave të dëshmitarëve të vet”, 1 Shkurt 2007.

¹⁰⁵ Rregulli 71 i Regullores së Procedurave dhe Dëshmive të TNKJ

akuzuari) për të “marrë në pyetje ose të kërkojë t`i marrin në pyetje dëshmitarët që janë kundër tij dhe të sigurojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij në kushte të njëjta si dëshmitarët që janë kundër tij. I pandehuri gjithashtu duhet të ketë të drejtën për ngritjen e mbrojtjes dhe të prezantojë dëshmi tjera të pranueshme sipas këtij Statuti”¹⁰⁶.

Rregullorja e Rregullave të Procedurave dhe të Dëshmimeve siguron se “Prokuroria dhe mbrojtja kanë të drejtë të pyesin dëshmitarin për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me dëshminë e dëshmitarit dhe me besueshmërinë e saj, kredibilitetin e dëshmitarit dhe të çështjeve të tjera relevante”. Gjykata mund ta pyesë dëshmitarin para se pala të thërrasë atë. Mbrojtja merr në pyetje dëshmitarët e fundit me radhë.¹⁰⁷

Gjykatësi kryesues mund që të japë udhëzime për drejtimin e drejtë dhe të paanshëm të procesit gjyqësor.¹⁰⁸ Gjykata ka nxjerrë udhëzime për sjelljen në seancat gjyqësore, për shembull në rastin e Katangës ku morri vendimin që Prokuroria të ketë 120 orë në dispozicion për të prezantuar rastin dhe i lejoi mbrojtjes për afërsisht 60% të asaj kohe për të bërë pyetjet e kryqëzuara për dëshmitarët e prokurorisë.¹⁰⁹ Vendimi gjithashtu ishte i mbështetur me shtojcë prej 32 faqesh me “Udhëzime për sjellje në seancë gjyqësore dhe për dhënie të dëshmimeve”. Në relacion me pyetjet e kryqëzuara ajo formulon dispozitat në vijim: “Pyetjet e kryqëzuara do të kufizohet në çështjet e ngritura gjatë marrjes në pyetje në përgjithësi dhe në çështjet që ndikojnë në kredibilitetin e dëshmitarit. Përveç kësaj, kur dëshmitari ka mundësi të japë dëshmi relevante për rastin e palës që bën pyetje të kryqëzuara, ajo mund të parashtrojë pyetje për çështjet e tilla madje edhe nëse ato nuk janë ngritur si të tilla gjatë marrjes në pyetje në përgjithësi.

Nëse rasti i palës që bën pyetjet e kryqëzuara është në kontradiktë me dëshminë e dhënë nga dëshmitari gjatë marrjes në pyetje në përgjithësi, ajo palë duhet t`ia kumtojë qartë këtë dëshmitarit para se të parashtrojë pyetje në këtë temë.

Dhoma thekson se pyetjet e kryqëzuara duhet, gjithashtu, të kontribuojë në vërtetimin e së vërtetës dhe nuk duhet të përdoret për turbullimin ose shtyrjen e procesit të gjetjes së fakteve.”

TNK-ja dallon nga TNKJ-ja dhe TNKR-ja meqë lejon pjesëmarrjen e viktimës në gjykim duke ju dhënë të drejtën për të thirrë dëshmitarët në pyetjet e kryqëzuara edhe ata nga pala tjetër. Kjo duhet bërë përmes “përfaqësuesve juridikë”. Vendimi Katanga kufizon pjesëmarrjen e përfaqësuesve juridikë të viktimave, duke udhëzuar: “Si çështje e një principi të përgjithshëm, marrjen në pyetje nga ana e përfaqësuesve juridikë në emër të viktimës të cilët marrin pjesë në seancat gjyqësore detyrimisht arrijnë të kenë për qëllim të tyre vërtetimin e të vërtetës. Viktimat nuk janë palë në seancën gjyqësore dhe sigurisht që nuk e kanë atë rol mbështetës për rastin e

¹⁰⁶ Shiko p.sh, Prosecutor v. Sefer Halilović IT-01-48-T “Vendimi mbi Pranimin e Dëshmimeve të Dekaratave Paraprake të Dëshmitarit”, 5 Korrik 2005.

¹⁰⁷ Rregulli 140 (2) (d) Rregullorja e Procedurave dhe Dëshmimeve të TNK

¹⁰⁸ Neni 64 (8) (b) i Statutit të TNK.

¹⁰⁹ Prosecutor v. Germain Katanga dhe Mathieu Ngudjolo Chui ICC-01/04-01/07 “Direkcionet për të udhëhequr procedurën dhe dëshmitë në pajtim me rregulin 140”, 20 Nëntor 2009.

Prokurorisë. Sidoqoftë, pjesëmarrja e tyre mund të jetë një faktor i rëndësishëm ndihmës për Dhomën për të kuptuar më mirë çështjet kontestuese të rastit në vijë të njohurisë së tyre lokale dhe prejardhjes së tyre shoqërore kulturore.

Kur përfaqësuesit juridikë të viktimës e dinë paraprakisht se ata kanë ca pyetje specifike për dëshmitarë ekspertë të caktuar ose për të pandehurin, që nuk kanë të bëjnë me çështjet e dëmshpërblimit, ata duhet të lajmërojnë Dhomën dhe Prokurorinë për këtë gjë me aplikacion në formë të shkruar, më së paku shtatë ditë para se dëshmitari të paraqitet për herë të parë. Aplikacioni duhet të tregojë cila pyetje e Përfaqësuesit Juridik propozon, parashtron dhe shpjegon në ç`mënyrë ato lidhen me interesat e viktimave që përfaqësohen. Në rast se Dhoma konsideron se aplikacioni duhet patjetër t'i dorëzohet Mbrojtjes për studim, në pajtim me rregullin 91(3)(a), ajo mund të vendosë që të riklasifikojë aplikacionin ashtu që të lejojë njoftimin e Mbrojtjes. Në këtë rast, Mbrojtja do të ketë tre ditë për të shprehur studimin e vet.

Nëse, pas marrjes në pyetje në përgjithësi nga ana e palës që thërret dëshmitarin, Dhoma është në mendim se çështjet e ngritura në pyetjet e propozuara të viktimës nuk janë të adresuara në mënyrë të mjaftueshme nga ana e dëshmitarit, ajo mund të autorizojë Përfaqësuesin Juridik që të parashtrorë pyetjet para se të fillojë procesi i pyetjeve të kryqëzuara.”

5.4. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

E drejta ndërkombëtar për të drejtat e njeriut garanton të drejtën për gjykim të drejtë e cila përfshin të drejtë themelore të barazisë së armëve dhe të drejtën për konfrontim të dëshmitarëve. Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut i themelojnë disa principe pa përshkrime teknike për implementimin e tyre. Praktika të ndryshme ekzistojnë mes sistemeve nacional dhe atyre internacionale. Në njohjen e rolit primar që autoritetet kombëtare, përfshirë këtu edhe gjykatat, duhet të ushtrorë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut aplikon doktrinën “margjina e vlerësimit” e një vështrimi të kufizuar të vendimeve nacionale.

Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike siguron të drejtën “Për marrje në pyetje, ose për të kërkuar për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmita rë ve në emër të tij me kushte të njëjta si për dëshmitarët kundër tij”¹¹⁰. Neni 6 (3) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut pasqyron tekstin si më poshtë. Kjo nuk i jep të pandehurit një të drejtë absolute për të thirrur dëshmitarët ose të drejtën për të detyruar gjykatat nacionale për të dëgjuar një dëshmitar të caktuar. Ligji nacional mund të rregullojë kushtet e dhënies së dëshmisë të dëshmitarit dhe gjykatat, për shembull, nuk duhet patjetër të dëgjojnë dëshmi jo relevante të dëshmitarit. Për të thyer këtë, aplikuesi duhet të

¹¹⁰ Neni 14 (3) i MNDP

tregojë patjetër se dështimi i gjykatës për të dëgjuar një dëshmitar të caktuar ka paragjykuar rastin e mbrojtjes¹¹¹.

E drejta për një dëgjim të drejtë sipas Nenit 6 (1) të Konventës Evropiane siguron të drejtën për të marrë në pyetje ose për të kërkuar për të marrë në dëshmitarët që janë kundër tij ose asaj dhe të sigurojnë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmi tarëve në emër të tij ose të saj, në kushte të njëjta si për dëshmitarët që janë kundër tij ose saj. Në princip të gjitha dëshmitë duhet të prezantohen në praninë e të pandehurit gjatë një dëgjimi publik me synim tek dëgjimi dhe argumenti kundërshtues.¹¹² Të pandehurit duhet t'i jepet mundësi e duhur dhe adekuate për të sfiduar dhe pyetur dëshmitarët në momentin kur dëshmitari jep deklaratën ose më vonë¹¹³. Palët kanë të drejtë të kenë njohuri për dëshmitë dhe të bëjnë komente për të gjitha dëshmitë që janë sjellë ose për vështrimet e bëra.¹¹⁴

E drejta për dëgjim të drejtë përfshinë principin e barazisë së armëve; në të drejtat procedurale gjyqësore që do të thotë se secila palë në seancë, medoemos, të ketë mundësi të arsyeshme për të prezantuar rastin e tyre para gjyqit në kushte të cilat nuk e vendosin atë në situatë vërtetë të jo të favorshme vis-à-vis ndaj oponentit të tyre.¹¹⁵ Një baraspeshë e drejtë duhet të pritët mes dy palëve. Megjithatë, për të garantuar barazi në procedurë gjyqësore procedura për thirrjen dhe dëgjimin e dëshmitarëve duhet të jetë e njëjtë për prokurorinë dhe për mbrojtjen.

Zbulimi i dëshmimeve dhe efekti i tyre në të drejtat gjatë gjykimit

Me qëllim të konfrontimit të dëshmitarit, i pandehuri duhet që të ketë të dhëna të nevojshme për atë së për çfarë dhe si të pyesë dëshmitarin. Aplikimi i principit të barazisë së armëve kërkon një zbulim adekuat të atyre të dhënave për të pandehurin.

Rasti Jaspers kundër Belgjikës përmbante principin e barazisë në gjykatë që sipas nenit 6 (3) (b) kërkon që prokuroria ose autoritetet hetimore të zbulojnë çdo material që ata posedojnë, ose që mund të kenë qasje, i cili mund të ndihmojë të pandehurin për të shfajësuar vetveten ose për të marrë një dënim më të vogël.¹¹⁶ Kjo përfshinë materiale që kanë mundësi të minojë kredibilitetin e dëshmitarit të prokurorisë.¹¹⁷ Mbrojtja, po ashtu, ka të drejtë qasjeje tek dosja e rastit dhe të bëjë kopje të dokumenteve për të ndihmuar në përgatitjen e mbrojtjes adekuate.¹¹⁸

¹¹¹ X v. Zvicrës, 28 DR 127

¹¹² Barberá, Messegué dhe Jabardo v. Spanjë, A-146, 6 Dhjetor 1988, paragrafi. 78

¹¹³ Stanford v Mbretërisë së Bashkuar A 282-A (1994).

¹¹⁴ Ruiz-Mateos v. Spanjë A-262 (1993), 23 Qershor 1993, para. 63

¹¹⁵ Kaufman v. Belgjikës 50 D.R. 98 at 115; De Haes and Gijssels v. Belgjikës, 24 Shkurt 1997.

¹¹⁶ Jaspers v. Belgjikës 27 DR 61 (1981).

¹¹⁷ Edwards v. Mbretërisë së Bashkuar 2002-II.

¹¹⁸ Foucher v. Francës 1997-II, 18 Mars 1997.

Shkelja do të ndodhë në rastet ku përfshihen ekspertët, nëse, për shembull, eksperti mbështetet në material i cili nuk është dhënë në dispozicion ose nuk është zbuluar për mbrojtjen.¹¹⁹

Këta të drejta janë tepër të rëndësishme në lejimin e avokatit mbrojtës që të përfaqësojë në mënyrën adekuate klientin e tij gjatë procedurës kundërshtuese. Mbrojta do të mbetet prapa pa pasur qasje në të dhënat të cilat janë të nevojshme dhe më në mënyrë efektive konfrontojnë dëshmitarin në gjykatë.

Thashethemet

E drejta për dëgjim të drejtë nuk urdhëron gjykatat nacionale të respektojnë çdo rregull të përshkruar për dëshmitë në dëgjimin e rasteve. Por, mënyra si pranohet dëshmia në procesin gjyqësor mund të shkel nenin 6.

Pranimi i dëshmisë thashetheme pa lejuar pyetjet e kryqëzuara mund të paraqet procesin gjyqësor jo të drejtë në rast se dënimi bazohet plotësisht ose kryesisht në atë dëshmi, edhe pse dispozitat në bazë të cilave disa dëshmitarë, siç janë anëtarët e familjes, lirohen nga dhënia e dëshmisë mund të mos jenë shumë jo të drejtë.¹²⁰ I pandehuri ka të drejtë të pyesë në kryqëzim një dëshmitar deklarata e të cilit është dhënë në seancë gjyqësore por nuk është thirrur të jep dëshmi. Kjo e drejtë mund të përmbushet me pyetjet e kryqëzuara e dëshmitarit në një dëgjim paraprak.¹²¹ Kjo mund të përfshijë dëgjim akuzues në Angli dhe Uells, një dëgjim special në Bosnjë e Hercegovinë, ose një incidente probatorio në Itali (ose dëgjim depozitues në TNKJ ose një dëgjim me një mundësi unike hetimore në TNK).

Gjykata do të shqyrtojë thashethemet në kontekst të procesit gjyqësor si tërësi duke vlerësuar nëse ka ndodhur shkelje. Pranimi i thashethemeve të kontestu eshme pa mundësi për pyetje të kryqëzuara është shkelje prima facie e nenit 6 (3).¹²²

Gjykata mund të arsyetohet në pranimin e dëshmisë thashetheme kur ekziston frikë e vërtetë nga represalie, por të drejtat e mbrojtjes detyrimisht duhet të ruhen duke kundërbalancuar procedurat. Këto mund të përfshijnë praninë e avokatit të mbrojtjes gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit dhe, nëse gjykatësi ka dijeni për identitetin e dëshmitarit. Si shembull, në Saïdi kundër Francës, i pandehuri u dënua për trafikim me drogë në bazë të dëshmisë thashetheme nga tre dëshmitarë me identitet anonim. Për shkak të kësaj shkeljeje të gjetur meqë kjo ishte e vetmja bazë për shqiptim dënimi, Gjykata vendosi¹²³: “Gjyqi është plotësisht i vetëdijshëm për vështirësitë e pamohueshme të luftës kundër trafikimit me drogë – veçanërisht sa i përket marrjes dhe dhënies së evidencave – dhe të dëmeve që i bëhen shoqërisë nga problemi i drogës, por konsiderata të

¹¹⁹ Mantonvanelli v. Francës 1997-II, Foucher v. Francës 1997-II, 18 Mars 1997.

¹²⁰ Unterpertinger v. Austria A-110, 24 Nëntor 1986.

¹²¹ Kostovski v. Holandës A-166 (1989) 20 Tetor 1989.

¹²² Luca v. Italisë 33354/96, 2002-II, Al-Khawaja and Tahery v. Mbretërisë së Bashkuar 26766/05 22228/06 20 Janar 2009.

¹²³ Saïdi v. Francës, A-261-C, 20 Shtator 1993, para. 44.

këttilla nuk mund të justifikojnë kufizimet në këtë shkallë e të drejtave të mbrojtjes të secilit që akuzohet me vepër penale. “

Dëshmitari anonim

Përdorimi i dëshmitarëve anonimë paraqet probleme të veçanta për shkak se mbrojtja nuk mund të sfidojë kredibilitetin e tyre. Gjykata Evropiane në lidhje me këtë u referua në rastin Kotovski kundër Holandës¹²⁴: “Nëse mbrojtja nuk ka dijeni për identitetin e personit ajo kërkon të pyesë, asaj mund të mos i mundësohen raportet e hollësishme që do t’i mundësonin të demonstrojnë se ai ose ajo është e paragjykuar, armiqësore ose e pabesueshme. Dëshmia ose deklaratat tjera që fajësojnë një të akuzuar mund të jenë qëllimisht shumë të pavërteta ose thjeshtë të gabueshme dhe mbrojtja, pothuaj se, fare nuk mund të ketë mundësi të nxjerrë në dritë këtë nëse i mungon informacioni që i lejon asaj të testojë besueshmërinë e autorit ose të hedhë dyshim në kredibilitetin e tij. Rreziqet që dalin nga një situatë e këtillë janë të qarta.”

Nga kjo del se dënimi nuk duhet të bazohet vetëm në një, e as në një shkallë vendimtare të dëshmisë nga një dëshmitar anonim.¹²⁵

Kufizimet për pyetjet e kryqëzuara

Kufizimet e imponuara për pyetjet e kryqëzuara nuk mund të thyejnë Nenin 6. Për shembull, Gjykata ka vendosur se nuk ka shkelje të Nenit 6 (3) gjatë kufizimit të pyetjeve të kryqëzuara për sulm seksual në historinë e tyre seksuale të mëparshme¹²⁶. Shkelja ndodhi në mënyrë të ngjashme në ndalimin e pyetjeve të kryqëzuara së një të mituri i cili ishte pyetur në një intervistë që u incizua me video.¹²⁷

Neni 6 nuk e kufizon pyetjen që mund ti parashtrohet. Lejohet një diskrecion i gjerë për autoritetet nacionale të cilëve iu lejohet marrja në pyetje. Shkelja ndodhi kur faji u caktua nga deklaratat e dy dëshmitarëve, të cilët nuk mundën të sfidohen nga ana mbrojtjes në fazën hetimore apo atë të gjykimit dhe nuk mundi të testojë kredibilitetin e tyre.¹²⁸

Mbrojtja mund të heqë dorë nga e drejta për pyetje të kryqëzuara por ajo duhet të jetë e qartë dhe jo kundër interesit publik.¹²⁹ Disa raste të jashtëzakonshme lejojnë që dëshmitë e disa dëshmitarëve të merren pa pyetje të kryqëzuara dhe pa shkelur nenin 6 – p.sh. për të parandaluar represaliet, për të ruajtur metodat operative të policisë, të lejohet viktimat e sulmit seksual të ballafaqohen me të pandehurin etj. Gjyqi mund të mos e bazojë dënimin e vet vetëm në një dëshmi të një dëshmitari të tillë.

¹²⁴ Kostovski v. Holandës, A-166 (1989), 20 November 1989, para. 42.

¹²⁵ Doorson v. Holandës A-166, para. 76, 20 Shkurt 1996.

¹²⁶ Oyston v. Mbretërisë së Bashkuar 42011/98, 22 Janar 2002

¹²⁷ S.N. v. Suedisë 2002-V, 2 Korrik 2002.

¹²⁸ Sadak v. Turqisë (No 1) 2001-VIII.

¹²⁹ Craxi v. Italisë 34896/97, 5 Dhjetor 2002.

KAPITULLI III. UDHËZIME MBI TË PYETURIT E KRYQËZUAR

1. BAZAT E MARRJET SË KRYQËZUAR NË PYETJE

1. 1. Hyrje

Ligji i ri i procedurës penale (LPP) paraqet mekanizma dhe procedura / parime të reja që rrjedhin nga sistemi akuzator. Kundërekzaminimi – parashtrimi i pyetjeve të cilat sugjerojnë përgjigje – është ndoshta mjete më dinamik dhe më inovativ i pranuar nga sistemi akuzator për dobinë e prokurorit dhe avokatit të mbrojtjes.

Njohja e procedurës së repenale si akuzatorenë nenin 5 të LPP-së së re nënkupton se edhe mbrojtja edhe prokuroria janë palë të barabarta të cilat mund të zhvillojnë dhe sfidojnë provat, mes tjerash, edhe përmes marrjes së dëshmitarëve në pyetje. Neni 4 i LPP-së së re e miraton parimindubio pro reo. Kjo nënkupton se avokati i mbrojtjes duhet të ketë të drejtë të parashtrijë pyetje të cilat e lejojnë mundësinë e shpjegimeve alternative bindëse, kështu duke krijuar dyshim. Neni 21 (13) i LPP-së së re e përcakton marrjen e dëshmitarëve në pyetje si “shqyrtim i një dëshmitari dhe dëshmitari ekspert nga pala e kundërt, që e paraqet mënyrën se si prezantohet një provë e tillë gjatë seancës kryesore në gjyq.”

Pikësytynimi i marrjes së dëshmitarëve në pyetje është të nxjerrë në pah pikat që e avancojnë teorinë e rastit të njëjës palë ose të tjetrës,¹³⁰ kurse i zvogëlojnë ose i shpërqendrojnë pikat e bëra të dëshmitarit gjatë shqyrtimit të drejtpërdrejtë. Kjo arrihet me anë të pyetjeve të shkurtra sugjestionuese të orientuara kah faktet (deklarata përshkruese me një modulim) të cilat prodhojnë përgjigje të parashikuara, të organizuara në renditje. Një sërë nenesh plotësuese e rregullojnë specifikën e marrjes së dëshmitarëve në pyetje (p.sh. 21 (12), 21 (13), 55 (4), 70, 216 – 217, 219, 221, 226, 229 – 232, 245, 350, 369, 378, 381, 383 – 391, 516).

Kundërekzaminimi është vetëm një nga tipet e shqyrtimit në gjykatë, të tjerat janë: pyetjet e drejtpërdrejta (ekzaminimi i drejtpërdrejtë) dhe ai plotësues. Ekzaminimi i drejtpërdrejtë ndodh kur pyetësi – prokurori ose avokati i mbrojtjes – i merr në pyetje dëshmitarët e vet. Kjo është metodë me të cilën pyetësi/ekzaminuesi (prokurori ose avokati i mbrojtjes) e përgatit teorinë e tij të rastit me ndihmën e dëshmitarëve. Ekzaminimi plotësues ndërlidhet me marrjen fillestare në pyetje pasi që këtyre pyetjeve duhet t’u përgjigjet ekzaminuesi gjatë pyetjeve plotësuese. Në këtë fazë ekzaminuesi ka mundësi të bëjë pyetje shtesë dhe ta drejtojë dëshmitarin kah pyetjet e parashtruara gjatë marrjes fillestare në pyetje me qëllim që t’i mundësojë dëshmitarit të japë shpjegime për të gjitha pikat e ngritura nga shqyrtimi i palës tjetër. Kështu, sferat të cilat ai i konsideron si të rëndësishme për përparimin e teorisë së rastit mund të plotësohen. Po ashtu, kjo

¹³⁰ Teoria e rastit nuk është kurrëgjë më tepër sesa një tregim bindës për ate se çka ka ndodhur nga perspektiva e prokurorit/mbrojtjes. Kjo është “arsyeja,” “justifikimi” ose “shpjegimi” se pse prokuroria ose mbrojtja duhet të dalin fitimtarë në gjykim. Teoria e rastit patjetër të zhvillohet logjikisht dhe vazhdimisht kështu që pas shqyrtimit të provave dhe dëshmimeve të të gjithë dëshmitarëve, trupi gjykues të marrë vendim në dobinë tuaj.

jep një mundësi për të zvogëluar ndikimin që mund të ndodhë gjatë marrjes së dëshmitarëve në pyetje.

1.2. Përgatitja

Mënyra më e mirë të përgatiteni¹³¹ për marrjen e dëshmitarëve në pyetje është t'i mësoni tërësisht faktet e lëndës. Avokati¹³², së pari, duhet ta shqyrtojë materialin në dispozicion, të takohet më palën e akuzës/palës dëmtuese dhe më të gjithë dëshmitarët e nevojshëm, dhe në fund të bëjë një mori idesh të lëndës me kolegët dhe hetuesit e tjerë.¹³³ Avokati patjetër t'i analizojë të gjitha informatat duke i pasur parasysh mospërputhjet dhe zbrazëtitrat në lëndën e palës kundërshtare. Takimi me palën e dëmtuar ose takimi me çfarëdo personi tjetër të cilët mund të kenë informata relevante, mund të sigurojë informata të cilat më vonë mund të përdoren gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve të palës tjetër. Avokati duhet t'i parashtrijë palës dëmtuese pyetje të vështira, sidomos shpjegimet e tij që lidhen me anët e forta të lëndës së palës tjetër. Avokati duhet t'i trajtojë të gjitha çështjet gjatë sesionit të morisë së ideve. Të gjitha sferat dhe teoritë që lindin duhet të vërehen dhe analizohen. Duhet të merret në konsideratë dëshmia e çdo dëshmitari të mundshëm. Çështjet dëshmuese duhet identifikuar dhe nëse paraqitet nevoja, të përcillen më tej në ekip. Duhet përgatitur propozime të mundshme preliminare. Duhet përcaktuar parametra për detyrat hetimore. Duhet organizuar një vizitë në vendin e ngjarjes dhe duhet shqyrtuar provat materiale.

Qëllimi kryesor në sesionin e morisë së ideve është të bëhet distilimi i teorisë së përgjithshme të lëndës duke pasur parasysh anët e dobëta dhe të forta të rastit.

Vetëm me anë të këtij procesi mund të përcaktohet rëndësia e parashikuar e dëshmisë së ndonjë dëshmitari dhe të përcaktohet sesi e avancon kjo lëndën e palës kundërshtare dhe si ndikon kjo në lëndën tuaj. Pikat e dobëta dhe mangësitë e lëndës suaj duhet veçuar dhe diskutuar me palën dëmtuese. Në fund të sesionit të morisë së ideve, avokati duhet të ketë një ide të përgjithshme për teorinë e rastit të tij, për anët e dobëta dhe për problemet e mundshme që mund t'i shkaktojnë dëshmitarët.

Duke supozuar se avokati ka mundësi të takohet me dëshmitarin, do të ishte pakujdesi – varësisht nga natyra dhe madhësia e dëshmisë së parashikuar – të shkohet në gjykatë dhe të merret në pyetje dëshmitari i palës kundërshtare pa pasur takim paraprak me qëllim të vlerësimit të tij/saj dhe t'i lexojë deklaratat e tij/saj (nëse ekzistojnë ato deklaratat). Mirëpo, para se të takohet me dëshmitarin është me rëndësi që avokati të përcaktojë saktësisht se çka dëshiron të arrijë me këtë takim. Duhet përcaktuar qëllime dhe parametra që pyetjet të mos i zbulojnë anët e dobëta ose të forta të lëndës. Më mirë është avokati të përpilojë një listë pyetjesh të cilat do t'i parashtrijë ai

¹³¹ Shihnenin 89(1), në bazë të cilit "Shënime do të merren për çdo veprim të ndërmarrë gjatë procedurës penale në të njëjtën kohë kur janë ndërmarrë aktivitetet, nëse është e mundur menjëherë pas saj." Mbajtja e shënimeve po ashtu është pikënisje për përgatitjen e mbrojtjes.

¹³² Termi "Avokat" i referohet shqyrtuesit, qoftë prokurori ose avokati i mbrojtjes.

¹³³ Shih po ashtu nënenin 70 dhe 79(1), (2).

ose hetuesi; kjo do ta mbajë intervistën të përqendruar. Natyrisht, duhet theksuar se përgjigjet duhen dëgjuar me vëmendje (mos mendoni për pyetjen e ardhshme derisa dëshmitari iu jep përgjigje për pyetjen e parë) që të parashtrohen pyetje plotësuese dhe të shpalosen tema të papritura. Metoda më e mirë e marrjes në pyetje gjatë intervistave të tilla është metoda e pyetjeve të drejtpërdrejta: Cili? Çka? Ku? Kur? Pse? Si? Shpjego? Përshkruaj? Qëllimi është të nxirren informata ngadëshmitari e jo t'ipërcillen informata dëshmitarit.

Pas intervistës me dëshmitarin, avokati duhet t'i shqyrtojë dhe analizojë përgjigjet e fituara. Avokati duhet konkretisht t'i analizojë vëzhgimet e dëshmitarit, njohurinë e fakteve dhe të mendimeve. Kjo analizë do të jetë e dobishme për avokatin të përpilojë një strategji se si të marrë në pyetje dëshmitarin e palës tjetër. Avokati duhet gatur kujdes të veçantë për atë se si dëshmitari iu përgjigjet pyetjeve, çfarë përpikërie kishin fjalët e tij, deri në çmasë dëshmitari i është përgjigjur pyetjeve dhe çfarëdo ndryshimeve të sjelljes së tij/saj gjatë intervistës. Të gjitha këto informata janë mjaft të dobishme për të vendosur se si do t'i qaset këtij dëshmitari avokati gjatë gjykimit. Nëse avokati s'ka mundësi të takohet me dëshmitarin, atëherë çfarëdo deklaratë e dhënë nga dëshmitari duhet analizuar dhe e njëjta të krahasohet me deklaratat e dhëna nga dëshmitarët e tjerë.

1.3. Qasja e përgjithshme ndaj pyetjeve të kryqëzuara

Ndoshta mënyra më e mirë e organizimit të marrjes së dëshmitarëve në pyetje është të fillohet me lëmin dhe me punën e përgjithshme dhe pastaj të kalohet në punët konkrete. Kjo do t'i mundësojë avokatit t'i tregojë dëshmitarit se ka njohje të fakteve. Avokati, po ashtu, dëshmon para trupit gjykues se ka njohuri të domosdoshme për t'i ndihmuar trupit gjykues të kuptojë rëndësinë e sferave të cilat janë pika kryesore të marrjes në pyetje. Me pyetje të shkurtra sugjestionuese dhe fakte konkrete, avokati mund të dëshmojë njohurinë e tij të thellë, duke e shmangur kështu probabilitetin që dëshmitari të dalë jashtë kontrolli. Në thelb, avokati po bën një dialog me dëshmitarin, por në realitet marrja e tij në pyetje s'duhet të jetë më tepër sesa një dhënie dëshmie ose rrëfim rasti nga ana e avokatit, kurse dëshmitari vetëm të pohojë (me një po) ose të mohojë (me një jo) gjatë dëshmisë së tij/saj; si pasojë del arsyeja për deklaratën përshkruese (me një modulim) gjatë marrjes në pyetje. Rrëfimi s'duhet të jetë i gjatë apo i ndërlikuar ose madje edhe interesant. Mirëpo, patjetër të jetë relevant dhe i rëndësishëm për teorinë e rastit. Mund të bëhet fjalë për një apo dy pjesë të mozaikut. Veç e veç ato pjesë mund të jenë të parëndësishme ose pavlerë, mirëpo pa to mozaiku – teoria e rastit- nuk mund të realizohet plotësisht.

Për ta ngritur deri në maksimum kontrollin e tij mbi dëshmitarin, secila lëmi e marrjes në pyetje nga ana e avokatit duhet të fillojë me një temë /deklaratë tranzicionale ose ndonjë titull, p.sh. “. Dëshmitar, ua drejtoj vëmendjen kah...” ose “Të flasim për këtë...”. Çdo kapitull i marrjes në pyetje duhet pasur një piksnim konkret që kuptohet dhe është në përputhje me teorinë dhe me temën e rastit. Pasi të arrihet pikësynimi, avokati duhet të kalojë në lëmin tjetër të marrjes në pyetje.

E pakta është më e mirë

Është me rëndësi të mbahet në mend se qëllimi i marrjes së dëshmitarit në pyetje është të përcaktohen disa pika ose të përhapet çfarëdo përshtypje gjatë marrjes të drejtpërdrejtë në pyetje të dëshmitarit. Marrja e dëshmitarit në pyetje nuk është një mjet për kënaqjen e kuriozitetit intelektual, por një mundësi për zhvillimin e një kapitulli në teorinë e rastit. “Kapitulli” përbëhet nga çështjet e bëra nga ana e avokatit gjatë marrjes së dëshmitarit në pyetje mbi të cilat do të mbështetet gjatë argumentimit përfundimtar për ta mbrojtur teorinë e tij të rastit. Një marrje në pyetje e papërqendruar, e pakontrolluar dhe e pakufizuar do t’i mundësojë dëshmitarit jo vetëm që t’i mbulojë gabimet e veta, por edhe të dëmtojë lëndën e shqyrtuesit (lëndën e palës tjetër). Avokati duhet të fitojë pika, të organizojë dëshmitarin e vet për marrje të drejtpërdrejtë në pyetje, t’i theksojë shpjegimet e mundshme alternative,¹³⁴ dhe të ulet.

Kujdes: Marrja e dëshmitarëve në pyetje është e domosdoshme për testimin e provave, sidomos dëshminë e dhënë gjatë marrjes të drejtpërdrejtë në pyetje. Pa marrë parasysh përfitimet e marrjes së kryqëzuar në pyetje (cross-examination), nëse kjo nuk bëhet siç duhet, mund të ketë efekte asgjësuese mbi lëndën. Mirëpo, nëse marrësi në pyetje nuk është përgatitur mirë, e drejta e marrjes së dëshmitarëve në pyetje – e cila nuk është e drejtë e pakualifikuar, mund të abuzohet dhe keqpërdoret. Në rrethana të tilla, gjykuesi i fakteve, gjegjësisht gjykatësi, vazhdimisht do të intervenojë në kufizimin e fushëveprimit, natyrën dhe gjatësinë e marrjes së dëshmitarëve në pyetje. Gjykatësi ka liri që ta kufizojë, madje edhe ta ndërpresë marrjen e dëshmitarëve në pyetje, nëse vlerësohet si abuzive, e kotë, e papërqendruar, e panevojshme, jo relevante ose e pavend. Shpeshherë gjykatësit mund të kenë të paqartë relevancën e marrjes në pyetje ose të jenë konfuz lidhur me atë se çfarë qëllimi qëndron pas marrjes në pyetje. Përdorimi i fjalive tranzicionale ose temore që u paraprijnë një sërë pyetjesh (si më poshtë) do të ishte e dobishme për lehtësimin e shqetësimeve të tilla nga gjykatësit. Ky është vetëm hapi i parë. Po ashtu, është e dobishme që marrja e dëshmitarëve në pyetje të jetë e organizuar dhe e përqendruar. Por në momentin kritik, sidomos kur marrja e dëshmitarëve në pyetje duket më sfiduese sesa pritej – edhe përkundër përgatitjes së duhur – kriteret themelore për çdo marrje të dëshmitarëve në pyetje janë: a) a është relevante për lëndën dhe konkretisht për teorinë e rastit? Dhe b) a përsëriten pyetjet me këtë dëshmitarë?

Mund të ndodh që kjo temë është dëshmuar me ndonjë dëshmitar tjetër paraprakisht. Mirëpo, nëse paraqitet nevoja e paraqitjes së provave plotësuese, të pavarura për ndonjë çështje të caktuar nga ndonjë dëshmitarë tjetër (pikëpamje tëndryshme), atëherë marrja në pyetje duhet lejuar. Duke i pasur parasysh këto kriteret, një shqyrtues mirë i përgatitur dhe i përqendruar duhet të jetë në gjendje, pa hamendje, t’ia sqarojë gjykatësit se pse një renditje pyetjesh ose vetëm edhe një pyetje, mund të jetë relevante. Kjo është e rëndësishme për dy arsye: -së pari ta bind gjykatësin se pse shqyrtuesi gjendet brenda kufijve të nevojshëm dhe të arsyeshëm të marrjes së

¹³⁴ Shih Nenin 4, i cili i lejon avokatit të parashtojë pyetje plotësuese për të ofruar shpjegime të mundshme alternative.

dëshmitarëve në pyetje, dhe -së dyti të fusë në procesverbal arsye për të bërë ankesa më vonë. Vlen të theksohet se shqyrtuesi të drejtpërdrejtë, i cili do duhet të bëjë një rishqyrtim, nuk duhet të qëndrojë duarkryq dhe pasiv, kur bëhet një marrje jo e duhur e dëshmitarëve në pyetje. Është e rrezikshme që të mbështetet në intervenimin e gjykatësit; shqyrtuesi të drejtpërdrejtë do të duhet të protestojë me dinakëri dhe zëshëm.

1. 4. Fushëveprimi i marrjes së kryqëzuar në pyetje

Në përgjithësi, marrja e dëshmitarëve në pyetje kufizohet me temën e shqyrtimit të drejtpërdrejtë dhe me çështjet që kanë të bëjnë me kredibilitetin e dëshmitarit. Në praktikë, kjo vepron si faktor kufizues në aftësinë e shqyrtuesit për të parashtruar pyetje lidhur me çështjet jashtë fushëveprimit të marrjes të drejtpërdrejtë të dëshmitarëve në pyetje. Mirëpo, gjykatësi (duke e ushtruar lirinë e tij të veprimit) mund të lejojë shqyrtuesin të bëjë pyetje për çështje edhe jashtë fushëveprimit të marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje. Në rrethana të tilla, marrësi i dëshmitarëve në pyetje (avokati i palës tjetër) duhet të trajtojë dëshmitarin sikur të jetë dëshmitari i tij, p.sh. a është i kufizuar të bëjë pyetje të cilat do të ishin të lejuara gjatë shqyrtimit të drejtpërdrejtë. Si rrjedhojë, ai nuk mund të bëjë pyetje sugjestionuese. Kur ballafaqohemi me një situatë kur duhet të tejkalohet fushëveprimi i shqyrtimit të drejtpërdrejtë, shqyrtuesi duhet ta mbështes çështjen e tij me arsye të bindshme.

1. 5. Bazat e marrjes së kryqëzuar në pyetje

Metoda hap pas hapi e marrjes së kryqëzuar në pyetje

Hapi i 1-rë. Filloni duke e përqendruar dëshmitarin dhe njoftuar gjykatësin dhe palët për natyrën dhe temën e pyetjeve nëpërmjet përdorimit të një deklarate tranzicionale / temë.

Shembuj:

- Z. X, u lejon t'i diskutoni marrëdhëniet tuaja me dëshmitarin;
- Znj. Y, më lejoni t'ua kthej vëmendjen kah koha e aksidentit;
- Znj. Z, tani kur na thatë për ate se çka ka ndodhur gjatë grabitjes, le të diskutojmë për ate se çka bëtë ju pastaj.

Hapi i 2-të. Përdorni deklarata të shkurtra dhe fakte konkrete me një modulim (pyetje sugjestionuese (që sugjerojnë përgjigje). Qëllimi është të kufizohet përgjigjja në një fakt thelbësor. Nëpërmjet një sërë deklaratash me një fakt / pyetjeve sugjestionuese, zhvillohet rrëfimi. Nëse prej një pyetjeje dalin më shumë se një fakt (pyetje e përbërë), atëherë përgjigjet me Po ose me Jo nuk janë të dobishme. Një përgjigje me Jo ndaj një pyetjeje të përbërë me dy fakte nënkupton Jo për faktin e parë ose të dytin ose të të dyjave. Përgjigjet e shkurtra me po ose mejo për pyetjet e përbëra nuk ndihmojnë për zhvillimin e proces verbalit gjyqësor nga e cila mund të bëhet ndonjë propozim dhe mbi të cilin do të mbështeten gjykatësit lidhur me fakte ose për qëllime ankuese më vonë.

Shembuj për deklarata të duhura me një fakt / pyetje sugjestionuese:

- Zotëri: Në ditën X ju ishit dëshmitar i aksidentit? (tema / deklarata tranzicionale)
- Ishit duke e kaluar rrugën në udhëkryqin midis rrugës A dhe 25?
- Shkonit nga lindja në perëndim në rrugën A?
- Kur ishit në udhëkryq dëgjuat zhurmë?
- Zhurma vinte nga një makinë e cila papritmas i shtypi frenat?
- Në fakt, mund ta dëgjoni si rrëshqiti makina?
- Në këtë kohë ju ishit 3 deri 4 hapa në kalim të këmbësorëve?
- Atëherë e dëgjuat këtë zhurmë?
- Nuk e patë sesi u shtypën frenat e makinës?
- Në fakt, ishte zhurma e makinës që ua tërhoq vëmendjen dhe të shihni përreth?
- Dhe kur e patë veturën, ajo vinte nga jugu në veri në rrugën 25?
- Atëherë për së pari e patë një grua në ajër?
- Ajo ishte afro 2 metra në ajër?
- Dhe pikërisht në atë moment ju e kuptuat se e ka goditur makina?
- Ju nuk e patë goditjen? ▪ Ju nuk prisnit ndonjë aksident?
- Ju vetëm e dëgjuat zhurmën e frenave?
- Pastaj edhe një zhurmë të ngjashme rënien e gruas?
- Dhe pastaj, pasi u kthyet nga drejtimi nga vinte zhurma dhe e patë gruan në ajër,
- Tani, të flasim për distancën midis udhëkryqit ku ishit ju dhe vendin e gruas dhe makinës kur i patë për herë të parë pasiqë e dëgjuat zhurmën e frenave dhe zhurmën e rënies së gruas. (tema tjetër / deklarata tranzicionale)

Hapi 3. Shkoni me radhë prej njëres pyetje në tjetrën që tregimi të zhvillohet qartë dhe me logjikë. Shembulli më lartë e sqaron këtë aspekt. Radhitja e pyetjeve është e rëndësishme për mirëmbajtjen e kontrollit të dëshmitarit.

Hapi 4. Pasiqë shqyrtuesi i palës kundërshtare ta ketë konstatuar çështjen e dëshiruar (e cila duhet të jetë e dobishme për teorinë e mbrojtjes), atëherë është koha të kaloni në temë tjetër. Kjo arrihet thjeshtë vetëm duke i parashtruar pyetjet temore të mëposhtme.

Shënim: arti i lakimit Deklarata përshkruese (me një modulim) / pyetja sugjestionuese mund të përmban më shumë se një fakt pa të qenurit e saj pyetja e përbërë. Kjo arrihet duke e marrë një fakt që sapo është konstatuar përmes përgjigjes dhe duke e bashkuar atë me deklaratën përshkruese / pyetjen sugjestionuese të ardhshme. Kjo teknikë – të përdoret rrallë dhe veçanërisht kur duhet të theksohet ndonjë çështje – quhet lakim.

Shembull: ▪ E patë makinën? ▪ Makina e kuqe shkonte në drejtim të lindjes? ▪ Dhe ishte pikërisht kjo makinë e kuqe, që shkonte në lindje që e kaloi dritën e kuqe? - Makina e kuqe e kaloi dritën e kuqe kur kishte fëmijë në kalimin e këmbësorëve?

1. 6. Ndërtimi i rrëfimit nga pyetjet e kryqëzuara

Filloni me marrjen e dëshmitarëve në pyetje duke bërë një rrëfim të hollësishëm të ngjarjes. Kjo, në përgjithësi, është dëshmi neutrale e padëmshme për dëshmitarin. Kjo u jep kontroll (të orientoni dëshmitarin kah mënyra e dhënies së përgjigjeve me Po; dëshmitari thjesht e vërteton deklaratën përshkruese) dhe ju mund të filloni të përgatisni skenën për rrëfimin. Derisa nuk e kaloni kufirin duke i shfrytëzuar faktet dhe derisa i kufizoni deklaratat përshkruese në një fakt të rëndomtë (eliminoni aq sa mundeni mbiemrat, ndajfoljet, cilësorët), do të keni kontroll të plotë, do të përfitoni kredibilitet me gjykatësin, dhe si një rrëfyes i mirë i tregimeve, do të filloni të krijoni kushte dhe ambient të mirë ashtu siç tregohet rrëfimi. Pikësynimi është të ndërtohet deklarata përshkruese me modulimin / pyetjen sugjestionuese në mënyrë të tillë që dëshmitari të mos ketë kohë të japë shumë sqarime, ose t'u shmanget përgjigjeve. Përgjigjet më së shumti duhet të jenë me po, joosenuk e di.

Pas ndërtimit të skenës, filloni t'i tregoni (rrëfeni) dëshmitarit se çka ka ndodhur. Duhet gatur parasysh se përqendrimi duhet të jetë në çështjen e zgjedhur. Për shembull, kur keni shumë dëshmitarë dhe teoria e rastit është vetëmbrojtja, vëmendja duhet përqendruar në atë se çka do të kishte parë dëshmitari. Kushtet e dritës, pengesat e mundshme etj. mund të jenë të rëndësishëm varësisht nga ajo se çka dëshironi të përcillni. Duke u përqendruar në një çështje, përshkruani se çka ka ndodhur gjatë asaj çështjeje. Ndërtoni rrëfimin tuaj për të zhvilluar atë çështje të caktuar të cilën dëshmitari do të vërtetojë nëpërmjet tregimit tuaj.

Edhe pse mund të keni zgjedhur tregimin më bindës të cilën duhet ta vërtetojë dëshmitari, prapë se prapë duhet të zbuloni sesi dëshironi ky tregim të shpalojë. Ky vendim do të varet nga shumë faktorë, siç janë: çështje të cilat dëshironi t'i vërtetoni nëpërmjet këtij dëshmitari; radhitja e kapitujve të marrjes së dëshmitarëve në pyetje për zmadhimin e kontrollit, pasigurisë, surprizave etj; dimensionin e karakterit të dëshmitarit (social, fizik dhe psiko logjik); radhitja e dëshmitarëve paraprakë dhe dëshmitë e tyre individuale.

Duhet të keni qasje holistike – çdo rrëfim i dëshmitarëve varet nga ajo çka është thënë më parë, çka do të pasojë dhe si ndërlidhen mes veti me – teorinë e juaj të rastit.

Mënyra më e mirë e ndërtimit të marrjes së dëshmitarit tuaj në pyetje është me anë të ilustrimeve. Kjo bëhet lehtë me anë të shënimeve se si duhet të avancojë rrëfimi që nga fillimi e deri në fund. Merrni parasysh qasjen e mëposhtme hap-pas-hapi.

- Bëni listën e pikave për marrjen e dëshmitarëve në pyetje;
- Bëni listën e kapitujve për marrjen e dëshmitarëve në pyetje dhe pikat të cilat dëshironi t'i zhvilloni për çdo kapitull;
- Merrni kartolina dhe vendosni çdo kapitull me pikat kyçe në kartolina veç e veç;
- Shpërndani kartolinat dhe tentoni të gjeni radhitjen e kapitujve të cilat do e maksimizojnë rezultatit e dëshiruar, duke pasur parasysh variablat e diskutuara më herët.

Duke i përdorur këto kartolina treguese, mund t'i lëvizni me lehtësi, t'i merrni dhe t'i studioni, t'i përdorni për të gjetur radhitjen ideale, dhe në fund, ato janë të dobishme gjatë marrjes së dëshmitarëve në pyetje në gjyq. Mjafton të thuhet, radhitja e rrëfimit (kartolina treguese) mund

dhe zakonisht prodhon ndryshime gjatë gjykimit, duke pasur parasysh faktin se edhe nën rrethanat më të mira, një gjykim është çdoherë i rrjedhshëm dhe dinamik i cili kërkon të bëhen adaptime dhe ndryshime. Prandaj, çdoherë të mbeteni fleksibël dhe të gatshëm që në momentin e dhënë të përfitoni ose reagoni ndaj çfarëdo përgjigjeve të papritura.

Duke e bërë vizuelizimin për atë se çka do të dëshmojë dhe shohë dëshmitari, do të keni mirënjohje më të madhe për dëshmitarin. Marrja e dëshmitarëve në pyetje do të duket si déjà vu (veç e parë) sepse ju tanimë keni qenë në lëkurën e dëshmitarit që t'i përjetoni ngjarjet në mendjen e tij/saj.

1. 7. Konkluzioni

Përgatitja për marrjen e dëshmitarëve në pyetje s'duhet të jetë një ushtrim i kotë. Natyrisht, kjo nuk nënkupton se çdoherë avokati të ketë marrë një dëshmitar në pyetje të kthehet në ulëse fitimtar. Megjithatë, më pak gabime do të bëhen nëse avokati nuk ngutet me njohjen e lëndës së tij. Moritë e ideve, konsultimet me palën e akuzuar/dëmtuar dhe me dëshmitarët, identifikimi i anëve të forta dhe të dobëta në lëndën e palës kundërshtare, takimet me dëshmitarët dhe organizimi i marrjes së dëshmitarëve në pyetje në mënyrë logjike, konsistente dhe të përpiktë, do të realizojnë rezultate më të mira. Marrja në pyetje e çdo dëshmitari duhet çdoherë të jetë e përqendruar dhe të ketë një qëllim. Në disa raste, marrja më e mirë në pyetje është të mos ketë marrje në pyetje. Për shembull, nëse nuk ka arsye bindëse për të marrë dëshmitarin në pyetje, atëherë më mire është të mos merret në pyetje dëshmitari sepse avokati mund t'i keqësojë edhe më shume gjërat duke i lejuar avokatit të palës kundërshtare të kryejë shqyrtimin e tërthortë (përsëri t'i kthehet dëshmitarit të vet).

2. ZHVLERËSIMI/DISKREDITIMI I DËSHMITARIT

Diskreditimi i dëshmitarit është pjesë e rëndësishme e marrjes së dëshmitarëve në pyetje. Neni 388 (2) i Ligjit të ri mbi procedurë penale) parasheh se “Çdo deklaratë e marrë gjatë procedurës hetimore mund të shfrytëzohet gjatë marrjes së kryqëzuar në pyetje ose t'i asgjësojë provat e prezantuara ose në përgjigje të përgënjeshtimit.” Nëpërmjet diskreditimit, avokati tenton të përcaktojë:

- anshmëri (p.sh. nëse dëshmitari ka marrëdhënie personale paraprake dhe negative me të akuzuarin);
- dënime të mëparshme për krime pandershmërie (p.sh. vjedhje, mashtrime);
- interes (p.sh. dëshmitari merret me tregti e cila është në konkurrencë me të akuzuarin dhe dëshmon që të përfitojë financiarisht nga burgimi i të akuzuarit);
- paragjykime (p.sh. të vërtetohet se dëshmitari ka paragjykime racore në një lëndë ku çështja kryesore është raca);
- mospërputhje ndërmjet deklaratave (p.sh. dëshmitari jep deklarata të kundërta brenda deklaratave të shkruara, për shembull lidhur me kohën e ngjarjeve në atë deklaratë);
- mungesë kujtese (p.sh. dëshmitarit s'i kujtohen datat e disa ngjarjeve të caktuara);

- perceptime joadekuade (p.sh. për shkak të faktorëve, siç është ndriçimi i dobët, pengesat para syve të dëshmitarit, ose mangësia fizike siç është pamja e dobët, dëshmitari nuk është në gjendje t'i perceptojë saktë ngjarjet lidhur me dëshminë e tij);
- shpjegime të pasakta të ngjarjeve (p.sh. ekzistojnë mospërputhje faktike ndërmjet dëshmimeve gojore të dy dëshmitarëve. Nëse dëshmia e një dëshmitari nuk përputhet me provat e pavarura dhe evidente lidhur me kronologjinë e ngjarjeve, ai/ajo mund të akuzohet në bazë të saj. Nëse, për shembull, një dëshmitar jep alibi, çdo prove që tregon pasaktësinë e dëshmisë së dëshmitarit do të çojë në akuzimin e dëshmitarit);
- kontradiktat nga dëshmia ose provat materiale të dëshmitarëve tjerë (p.sh. dëshmia e dëshmitarit lidhur me modelin dhe ngjyrën e ndonjë makine nuk mbështetet nga provat materiale (gjegjësisht vet makina), ose përshkrimi i ndonjë shtëpie nga dëshmitari e cila është djegur nuk mbështetet me planin e shtëpisë, provat fotografike dhe përshkrimet e shtëpisë nga dëshmitarët e tjerë);
- nxjerrja në gjyq po ashtu mund të konstatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë duke e sfiduar një dëshmitar ose dokumente të palës kundërshtare gjatë marrjes së dëshmitarëve në pyetje të dëshmitarit të dytë (p.sh. dëshmitari X dëshmon për vendndodhjen e viktimës në mbrëmjen e vrasjes. Dëshmitari Y, gjatë marrjes në pyetje, dëshmon se e ka parë viktimën në një vend tjetër në të njëjtën kohë. Nëse kjo mbështetet me prova tjera të pavarura dhe të bindshme, siç janë fotografi ose vërtetime të pagesave nga kartelat kreditore, dëshmia e dëshmitarit Y do të akuzojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dëshminë e dëshmitarit X).

Teknika që përdoret për nxjerrjen e dëshmitarit në gjyq është e njëjtë me teknikën e marrjes në pyetje të çdo dëshmitari tjetër. Me fjalë tjera, avokati do të bëjë pyetje të shkurtra me një fakt (deklarata përshkruese me modulim) me radhitje të mirë të pyetjeve. Mirëpo, metoda për nxjerrjen në gjyq kërkon strategji të organizuar paraprake. Mënyra më efektive për nxjerrje në gjyq është të shfrytëzohet qasja prej tre hapash të:

- Përsëritje;
- Akreditim; dhe
- Konfrontim

Përsëritja

Duke përsëritur, avokati e drejton dëshmitarin kah një pjesë e dëshmisë së tij më herët. Kjo është pjesë e dëshmisë mbi të cilën avokati do të mbështetet për nxjerrje në gjyq të dëshmitarit së bashku me deklaratat e mospërputhshme paraprake.

Akreditimi

Duke akredituar, avokati e bind dëshmitarin të pranojë apo të marrë meritat për një deklaratë paraprake, zakonisht jashtë sallës gjyqësore. Deklarata mund t'i jetë dhënë policisë, prokurorit apo hetuesit. Qëllimi i avokatit është që së pari ta bind dëshmitarin se ai, me të vërtetë, e ka dhënë ate deklaratë. Pasi të vërtetohet kjo, avokati duhet të përcaktojë se në çfarë rrethanash është dhënë ajo deklaratë. Kjo quhet “mbyllje e dëshmitarit.”Këtu qëllimi është të përcaktohet

se: ▪ dëshmitari ka dhënë një deklaratë të plotë dhe të saktë; ▪ deklarata është dhënë me vetëdije dhe me mbështetje të vërtetë; dhe ▪ pasi të kompletohet deklarata, dëshmitarit do t'i ofrohet çdo mundësi për ta korrigjuar ose për të shtuar diçka në te.

Konfrontimi (kundërvënia)

Duke u konfrontuar, avokati ia tregon deklaratën dëshmitarit. Dëshmitarin duhet orientuar kah pjesa e caktuar e deklaratës e cila e kundërshton dëshminë e tij gjatë shqyrtimit të drejtpërdrejtë dhe shqyrtimit të palës kundërshtare, gjegjësisht atë pjesë për të cilën avokati e ka orientuar dëshmitarin. Gjatë konfrontimit të dëshmitarit, Avokati duhet të përcaktojë se dëshmia e dëshmitarit gjatë shqyrtimit të drejtpërdrejtë dhe asaj të palës tjetër nuk përputhet, është e pasaktë dhe e pakompletuar krahasuar me deklaratën e dhënë nën rrethana kur dëshmitari ka pasur mundësi të japë deklaratë të plotë, të drejtë dhe të saktë. Qëllimi këtu është të tregohet se dëshmitari sot (gjatë gjykimit) dëshmon për hollësi të rëndësishme të cilat nuk ishin përmendur në deklaratë (diskreditim me anë të largimit); ose të tregojë se deklarata e mëparshme i kundërvihet dëshmisë gjatë shqyrtimit të drejtpërdrejtë dhe shqyrtimit të palës kundërshtare (cross-examination).

Një tjetër qëllim gjatë impiçmentit mund të jetë përcaktimi se deklarata fillestare është e pabesueshme për shkak të anshmërisë dhe paragjykimeve. Po ashtu mund të ketë qëllim për të përcaktuar se perceptimet joadekuate të dëshmitarit apo shpjegimet e gabuara për arsye të harresës dhe përshkrimit të gabuar dhe të pasaktë të ngjarjeve.

2.1. Udhëzime për diskreditim dhe rehabilitim dëshmitarësh

Diskreditimi

- Të dihet se kur nuk duhet bërë diskreditimi. Avokati nuk duhet të dijë vetëm atë se kur duhet bërë diskreditim, por duhet të dijë, nëse paraqitet nevoja, kur duhet nxjerrë dëshmitarin në gjyq. Sikurse nuk duhet marrë në pyetje dëshmitarin, nëse gjatë shqyrtimit të drejtpërdrejtë të lëndës nuk është ndikuar negativisht, avokati mund të vendos, po ashtu, edhe pse ka baza për diskreditim, të mos e përdorë këtë të drejtë. Nëse dëshmitari nuk ka ndikuar negativisht gjatë shqyrtimit të lëndës, ai s' duhet akuzuar. Nëse një dëshmi mund të kthehet në favor të palës tjetër, do të ishte kundër-produktive të akuzohet dëshmitari.
- Diskreditimi kërkon ndërtimin e bazës. Gjatë shqyrtimit të dëshmitarëve nga pala e kundërt, avokati duhet ta konfrontojë dëshmitarin me deklaratën joadekuate (të papërputhshme) të dhënë paraprakisht, e cila duhet të jetë konkrete për sa i përket kohës, rrethanave dhe përmbajtjes së deklaratës së mëparshme. Në përgjithësi, dëshmitarit duhet t'i jepet mundësi të japë sqarime ose të mohojë deklaratën e dhënë më parë. Konfrontimi i dëshmitarit me mospërputhjet e veta ka më shumë ndikim mbi trupin gjykues sesa të paraqiten prova të deklaratës së mëparshme nëpërmjet ndonjë dëshmitari tjetër.
- Diskreditimi kërkon përgatitje paraprake. Kurnjë dëshmitar e mohon deklaratën joadekuate, të dhënë më herët, avokati duhet të jetë i gatshëm të vërtetojë konkretisht dhe me përpikëri

mospërputhjet e deklaratave nëpërmjet provave jo karakteristike.

- Të vazhdohet me çështjen e diskreditimit mbasi që të vërtetohet nuk është as bindëse as efektive. Pasi që dëshmitari pranon se ka bërë një deklaratë joadekuate ose me fjalë tjera deklaratë për t'u akuzuar, avokati duhet të kalojë në çështjen tjetër të marrjes në pyetje, duke marrë parasysh se ende ka nevojë të marrë në pyetje dëshmitarin. Meqë e pakta është më e mirë, përsëritja e sendeve është e bezdisshme dhe kundërproduktive.

Rehabilitimi

- Vlerësoni vallë rehabilitimi është i nevojshëm. Vetëm nëse një dëshmitar është akuzuar për diskreditim gjatë marrjes së tij në pyetje, kjo nuk do të thotë se automatikisht duhet kërkuar rehabilitimin e tij/saj. Nëse çështja e diskreditimit është marginale apo e parëndësishme për lëndën në gjyq, avokati duhet të heq dorë nga rehabilitimi i dëshmitarit të vet.
- Kufizoni shtrirjen e shqyrtimit ri-të drejtpërdrejtë. Siç ndodh me të gjitha shqyrtimet e tërthorta, avokati duhet ta kufizojë shtrirjen e pyetjeve kur do të bëj rehabilitim lidhur me sferat/çështjet për të cilat dëshmitari duhet të japë sqarime ose t'i përforcoj përgjigjet e tij gjatë marrjes në pyetje nga pala e kundërt. Rehabilitimi përmes shqyrtimit të tërthortë (avokati i kthehet dëshmitarit të vet) nuk jep mundësi për përsëritje të dëshmisë së drejtpërdrejtë (fillestare).
- S'ka nevojë për rehabilitim nëse dëshmitari nuk është akuzuar në mënyrë efektive. Para se të tentohet me rehabilitimin e dëshmitarit, avokati duhet të jetë plotësisht i sigurt se dëshmitari është akuzuar plotësisht. Tentimi për rehabilitimin e dëshmitarit bart rrezik për zbulim të ndonjë dobësie në dëshminë e dëshmitarit, nëse i jep mundësi trupit gjykues ose prokurorit ta marrë përsëri dëshmitarin në pyetje.
- Rehabilitimi është më efektiv duke i lejuar dëshmitarit të sqarohet dhe t'i vejë çështjet në kontekst. Avokati duhet: a.t'i jep mundësi dëshmitarit të sqaron rrethanat lidhur me diskreditimin; b.të nxjerr nga dëshmitari ndonjë faktorë shfajësues; dhe c.t'i jep mundësi dëshmitarit të vendos diskreditimin në kontekst.
- Rehabilitimi përmes deklaratës adekuate të mëparshme.Nëse një dëshmitar akuzohet për dhënie të një deklaratë joadekuate, atëherë avokati duhet, nëse ka nevojë, të tentojë ta rehabilitojë dëshmitarin me ndonjë deklaratë paraprake (jashtë gjyqit) që ai e ka dhënë. Deklaratat adekuate, të dhëna më herët, janë relevante, të cilat duhet të merren parasysh nga gjykata, nëse të njëjtat ofrohen për të hedhur poshtë ndonjë akuzë të implikuar lidhur me ndonjë trillim të mëvonshëm.

2.2. Mostër diskreditimi – para dhënies së një deklaratë joadekuate

Elementet

- Dëshmitar është Znj. Petrov.
- Znj. Petrov ka dëshmuar gjatë shqyrtimit të drejtpërdrejtë duke thënë se në momentin e aksidentit ka shikuar kah dritat e semaforit (më drejt: makina e ka goditur këmbësorin, por ajo

vetëm e ka dëgjuar zhurmën e përplasjes).

- Aksidenti ndodhi më 27 shtator të vitit 2004.
- Znj. Petrov dha një deklaratë të nënshkruar në polici më dt. 01 tetor 2004, duke thënë se e ka parë veturën që goditi këmbësorin.

Skenari i rekomanduar

- Hapi i 1-rë: Orientojeni dëshmitarin, përmes pyetjeve sugjestionuese, nga deklarata e pasaktë që e ka dhënë gjatë dëshmisë.

P.sh. “Ju kujtohet, apo jo, të keni dëshmuar gjatë shqyrtimit të drejtpërdrejtë se keni shikuar në drejtim të dritave të semaforit në kohën e aksidentit?”

- Hapi i 2-të: Orientojeni dëshmitarin duke e përkujtuar për rrethanat e dhënies së deklaratës paraprake, dhe për arsyet se pse deklarata paraprake duhet të jetë e saktë. Por, ende mos e përmendni ose mos e identifikoni dokumentin konkret [nëse trupi gjykues ju lejon ta bëni këtë].

P.sh. ▪ “Ju kujtohet se u morët në pyetje nga një polic pas aksidentit?”

- “E dinit që kjo përbënte pjesë e një hetimi zyrtarë?”
- “E dinit që policia duhej ta siguronte kujtesën tuaj më të mirë për ngjarjen, derisa ajo ende ishte e freskët në mendjen tuaj?”
- “Ju kujtohet se ata parashtronin pyetje, kurse ju jepnit përgjigje?”
- “Dhe vallë e patë policin të marrë shënime, apo jo?”
- “Dhe në fund, pasi policia e rrahu deklaratën tuaj në makinë shkrimi ju luti ta lexonit dhe përmirësonit para se ta nënshkruani, apo jo?”
- “Ju, e lexuat, apo jo, dhe bëtë korrigjimet e nevojshme ashtu siç ishte rasti?”
- “Dhe a ndodhi kjo sepse e dinit se sa e rëndësishme do të ishte deklarata e juaj?” ▪ “Dhe natyrisht, kujtesa juaj atëherë ishte mjaft e freskët sepse aksidenti kishte ndodhur disa ditë më parë?”

- Hapi i 3-të: Realizoni qëllimin tuaj! S’këni nevojë t’ia tregoni dëshmitarit dokumentin dhe as t’ia rifreskoni kujtesën atij.

P.sh. A nuk është e vërtetë Znj. Petrov se më 01 tetor të viti 2004, vetëm 4 ditë pas aksidentit, Ju policisë ia nënshkruat këtë deklaratë:

- “Në kohën e aksidentit unë po e shikoja makinën dhe e pashë se si makina e goditi vajzën.”

Shënim: nëse një transkript – përkundër deklaratës së shkruar – e keni në dispozicion, vazhdoni ta pyesni dëshmitarin në këtë formë si më poshtë: “A ju parashtruan këto pyetje dhe a i dhatë ju këto përgjigje të mëposhtme...?”

Nëse pala tjetër ka një kopje të deklaratës dhe haptazi pyet- “Ku e lexoni ate?”, ju duhet të jeni të gatshëm për t’iu përgjigjur: “Po i referohem provës 2 të paditësit për identifikim, faqja 3, paragrafi 2, reshti 3 deri 5.”

“Znj. Petrov, ju a nuk e bëtë këtë deklaratë para policisë?”

- Hapi i 4-të: Vazhdoni. Mos kërkoni nga dëshmitari t’i sqarojë mospërputhjet evidente.

2.3. Konkluzioni

Në fund, duhet të kuptohet se diskreditimi është vetëm një segment i marrjes së dëshmitarëve në pyetje. Përgatitja e duhur për organizimin e procesit të diskreditimit në gjykim nuk është ndryshe nga ajo që nevojitet për marrjen e dëshmitarëve në pyetje. Analiza e thellë e lëndës, të kuptuarit dhe identifikuarit e çështjeve të cilat avokati dëshiron t’i përcaktojë përmes diskreditimit dhe strategjisë për arritjen e atyre qëllimeve, janë elemente thelbësore për diskreditimin e suksesshëm të çdo dëshmitari në gjyq.

3. VËREJTJE PËR ROLIN E GJYKATËSIT

Siç u pa, Ligji i ri i procedurës penale parasheh institute/procedura dhe mekanizma të reja që burojnë nga sistemi akuzator. Nga këto ndryshime, njëri ndër më të rëndësishmit është miratimi i të pyeturit të kryqëzuar. Kjo kërkon që edhe avokatët edhe gjykatësit, të cilat janë mësuar me sistemin e Të drejtës civile, të përshtaten me situatën e re, atë akuzatore. Të pyeturit e dëshmitarit në të drejtën civile është më tepër e udhëhequr nga ana gjykatësisë sa në atë të sistemit akuzatore.

Mënyra e të pyeturit të drejtpërdrejtë, të kryqëzuar dhe të drejtpërdrejtë të përsëritur, që është e zakonshme në sistemet akuzatore nuk ekziston në procedurat e të drejtës civile. Sistemi që parashihet nga LPP është më pak i udhëhequr nga gjykatësi se sa në kontestet gjyqësore sipas të drejtës civile. Kjo do të thotë se pritet që palëttë marrin pjesë në mënyrë më aktive në nxjerrjen e të dhënave nga dëshmitarët, edhe gjatë të pyeturit të drejtpërdrejtë edhe gjatë të pyeturit të kryqëzuar. Gjykatësi, gjithsesi, mbetet në kontrollin e procedurave dhe sipas nevojës do të ndërhyjë që të parashtrijë pyetje të cilat mund të konsiderohen si të domosdoshme për rastin. Në praktikë, kjo do të thotë se gjykatësi, në sistemin e paraparë me Ligjin e ri të procedurës penale:

- do ta orientojë avokatin që t’i kufizojë pyetjet e tij në fusha që janë relevante për çështjen që debatohet. Gjatë kësaj, ai mund vë një kufi të pyetjeve, për shembull, se informatat që nxirren janë ose nuk janë konzistente për çështjen që debatohet apo nuk janë relevante;
- gjithashtu mund të kufizojë, apo edhe të ndalojë, pyetje ku pyetësi që pyet në formë të kryqëzuar thjesht bën pyetje përgjigjet e të cilave tanimë janë dhënë (d.m.th. përsëriten). Ai gjithashtu mund t’ia kufizojë ose t’ia ndalojë pyetësit që pyet në formë të kryqëzuar që të parashtrijë pyetje që për nga natyra janë personale dhe arsyeja e vetme që mund të vërehet për parashtrimin e këtyre pyetjeve është turpërimi ose ngacmimi dëshmitarit.

Në kuadër të Ligjit të ri për procedurë penale parashihet që gjykatësi duhet të mbajë një baraspeshë në mes të lejimit të një hapësire për pyetësin që pyet në formë të kryqëzuar për të parashtruar një sërë pyetjesh të nevojshme për rastin e tij, ndërsa në të njëjtën kohë t'i kontrollojë procedurat ashtu që të pyeturit e kryqëzuar të kufizohet në atë që është relevante dhe kjo të bëhet në mënyrë adekuate. Në kuadër të këtij procesi balancues, gjykatësi do të duhet të kufizohet dhe të përmbahet nga ndërhyrja me pyetje që do të mund ta pengonin pa nevojë rrjedhojën e të pyeturit të kryqëzuar. Në të njëjtën kohë, ai duhet ta ruajë diskrecionin e tij dhe të parashtrrojë pyetje me qëllim që të qartësojë çështjet.

Në raste kur pyetësi që pyet në formë të kryqëzuar kërkon nga gjykatësi që të parashtrrojë ndonjë pyetje të caktuar apo një sërë pyetjesh, gjykatësiduhet të jetë i kujdesshëm dhe duhet ta pyesë pyetësin në formë të kryqëzuar t'i sqarojë arsyet për një gjë të tillë, ashtu që në rast se një sërë pyetjesh nuk lejohen, mbahet procesverbal përkatës, që mund të shërbejë në mënyrë përkatëse për të bërë ankesë.

Qasja më e mirë është që të merret vesh cili është qëllimi prapa pyetjes së caktuar apo serisë së pyetjeve, pa mos e kuptuar dëshmitari këtë.

Sipas LPP, nga gjykatësi penal tanimë nuk kërkohet që ta kërkojë të vërtetën objektive materialekur e ushtron funksionin e tij gjyqësor (shih nenin 284 të ligjit aktual për procedurë penale¹³⁵). Ky obligim tani kalon mbi prokurorin që ta vërtetojë fajin e të akuzuarit jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm (Neni 409(3)). Kjo është një reformë shumë e rëndësishme e procedurës penale që ka pasoja direkte mbi atë se si merren në pyetje dëshmitarët.

Çështjet kryesore që duhet të merren parasysh nga gjykatësit gjatë të pyeturit e kryqëzuar

Sipas LPP, roli dhe funksioni i gjykatësitgjatë marrjes së të dhënave në formë gojore (viva voce) është ndryshuar. Duke pasur parasysh faktin se pritet që palët (prokuroria dhe mbrojtja) ta bëjnë pjesën më të madhe të marrjes në pyetje, dhe duke pasur parasysh faktin se obligimi për ta vërtetuar tezën e tyre jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm bie mbi prokurorin, gjykatësi luan një rol më pasiv, duke u lejuar palëve ta zhvillojnë dosjen nga e cila gjykatësi do ta përcaktojë rezultatin përfundimtar të procesit gjyqësor. Gjykatësi, megjithatë, mbetet nën kontroll të procedurave dhe sipas nevojës do të parashtrrojë pyetje ose do të kufizojë një sërë pyetjesh nga palët.

Duke e shfrytëzuar diskrecionin e tij, sipas LPP gjykatësiduhet:

- të përmbahet nga intervenimi gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit, përveç nëse ata kërkojnë që të qartësohen pyetjet që parashtrohen dhe përgjigjet që jepen. Roli i gjykatësit me parashtrimin e pyetjeve nuk është që ta ndihmojë prokurorin që ta vërtetojë tezën e tij jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, ose ta ndihmojë avokatin mbrojtës që të tregojë se prokuroria nuk mund ta vërtetojë

¹³⁵ Shih nenin 284 paragrafin 2 të Ligjit aktual të procedurës penale: “[...](2) Është obligim i kryetarit të trupit gjykues që të ketë parasysh që gjatë procesit gjyqësor të bëhen inspektive të ndryshme, për ta zbuluar të vërtetën dhe të eliminohet çdo gjë që e vonon procedurën dhe nuk shërben për t’u qartësuar çështjet. [...]”

tezën e saj jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Sipas LPP, gjykatësi nuk duhet të parashtrojë pyetje me qëllim të arritjes së ndonjë qëllimi të kërimit të së vërtetës materiale;

- gjatë të pyeturit të kryqëzuar, tërësia e evidencës merret nga pyetjësugjестive të të autorizuarve të të dyja palëve, të cilat e formojnë bazën e raportit në formë të shkruar, dhe përgjigjet e dëshmitarëve, që ose do ta konfirmojnë ose do ta përgënjeshtrojnë raportin e të autorizuarve të të dyja palëve. Për pasojë, gjykatësi do të duhet t'u kushtojë vëmendje të posaçme pyetjeve të të autorizuarve të të dyja palëve, e poashtu edhe përgjigjeve të dëshmitarëve kur ta vlerësojë tërësinë e evidencës; dhe në rast se ai e konsideron të palejueshme ndonjë pyetje apo një sërë pyetjesh, gjykatësi duhet të mos harrojë ta pyesë pyetësin që pyet në formë të kryqëzuar t'i sqarojë arsyet për parashtimin e pyetjes apo serisë së pyetjeve, ashtu që në rast të ndonjë ankese, ka procesverbal ku shënohen arsyet e pyetësit që pyet në formë të kryqëzuar, të cilat paraqesin bazë për vendimet e gjykatësit.

4. REGJISTRI PËR MARRJEN NË PYETJE TË KRYQËZUAR

Gjatë gjykimit trupi gjykues duhet të tregojë kontroll të arsyeshëm për mënyrën dhe për rendin e marrjes së dëshmitarëve në pyetje. Duke e ushtruar këtë me kompetencë, trupi gjykues mund të ndalojë ndonjë nga pyetjet ose të refuzojë ndonjë përgjigje ndaj një pyetjeje tanimë të parashtuar, nëse konstaton se ajo është jo relevante dhe pa ndonjë bazë lidhur me lëndën.

Si në çdo shkathtësi, ashtu edhe në këto raste, njohja e gjërave fundamentale është thelbësore. Shkathtësia më themelore e avokatit është aftësia për të shqyrtuar dhe kundërshtuar shqyrtimin e dëshmitarëve të palës kundërshtare.

Udhëzime themelore

- Qëllimi i shqyrtimit të dëshmitarëve është nxjerrja e informatave.
- Forma themelore e shqyrtimit të drejtpërdrejtë është dialogu narrativ/bisedues, kurse forma e shqyrtimit të dëshmitarëve nga pala e kundërt është dialogu pyetës.
- Pyetjet, gjatë marrjes në pyetje nga pala e kundërt, duhet të jenë të shkurtra, të thjeshta dhe të kuptueshme për dëshmitarin dhe gjykatësin, sepse: (a) Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve nga pala kundërshtare, pyetjet e ndërlikuara i mundësojnë dëshmitarit t'i shmanget shqyrtuesit; dhe (b) Është e domosdoshme gjykatësi t'i kuptojë pyetjet si dhe radhitjen e tyre.
- Gjatë marrjes së dëshmitarëve në pyetje (nga pala kundërshtare), avokati duhet ta udhëheq dëshmitarin. Është e domosdoshme të kontrollohet dëshmitari gjatë marrjes në pyetje.
- Nëse avokati e di se marrja në pyetje (nga pala kundërshtare) do të nxjerrë informata të pafavorshme, ai duhet të përgatitet për këtë gjatë shqyrtimit të drejtpërdrejtë. Si rregull e përgjithshme, çdoherë është më mirë që të nxirren informatat e pafavorshme gjatë shqyrtimit të drejtpërdrejtë, që të largohet përshtypja e të qenit dredhues dhe t'i lejohet dëshmitarit ta sqarojë vetë përgjigjen e tij.

- Avokati s' duhet t' a marrë në pyetje dëshmitarin e palës tjetër, nëse gjatë kësaj do të ndodhte vetëm përsëritje e shqyrtimit të drejtpërdrejtë.

- Avokati duhet t' i dëgjojë përgjigjet e dëshmitarit dhe s' duhet të mendojë për pyetjen e ardhshme derisa dëshmitari përgjigjet.

- Kundërshtime ndaj ndonjë pyetjeje duhet bërë para se të jepet ndonjë përgjigje. Nëse pyetja zbulon se përgjigjja që kërkohet do të jetë jorelevante dhe me paragjykime, kundërshtimi duhet menjëherë të paraprijë përgjigjen (duhet kundërshtuar menjëherë pasi të parashtrohet pyetja nga avokati opozitar). Bazat e kundërshtimit duhet theksuar saktë dhe konkretisht. Nëse pyetja nuk e zbulon relevancën potenciale të përgjigjes, por përgjigjja e dhënë është relevante, duhet bërë një propozim të menjëhershëm për mospërfilljen e përgjigjes.

- Avokati duhet të protestojë për përgjigjet të cilat s' japin ndonjë përgjigje konkrete ose përbëjnë çështje kundërshtuese. Shqyrtuesi ka të drejtë jo vetëm të kundërshtojë, por edhe të kërkojë nga trupi gjykues që dëshmitari të udhëzohet për t' i dëgjuar pyetjet dhe t' u përgjigjet të njëjtave. Nëse kundërshtimi ndaj ndonjë pyetjeje pranohet, atëherë avokati duhet të ndryshojë pyetjen për ta përmirësuar pyetjen paraprake. Kundërshtimet ndaj ndonjë forme pyetjesh, në përgjithësi, ndodhin kur pyetja është sugjestionuese gjatë shqyrtimit të drejtpërdrejtë. Në këto raste nga dëshmitari kërkohet të bëjë spekulime (supozime) lidhur me pyetjen e dhënë në formë hipotetike supozon për faktet të cilat nuk janë në provat e dhëna.

- Nëse një kundërshtim ndaj përmbajtjes së përgjigjes (p.sh. relevanca, thashetheme etj) pranohet nga trupi gjykues (gjykatësi vendos në favor të palës kundërshtuese), atëherë avokati duhet ta ketë parasysh nevojën e “ofrimit të provës”. Ofrimi i provës kërkon që informatat kundërshtuese të futen në procesverbal, gjë që do t' i mundësojë Gjykatës së Apelit mundësi për të përcaktuar vallë trupi gjykues ka bërë gabim në mospërfilljen e dëshmive të paraqitura.

5. KUNDËRSHTIMET GJATË GJYKIMIT

Derisa të përcaktohen baza të duhura, dëshmitarit s' duhet t' i lejojë të dëshmojë lidhur me ate provë reale. Të pranojë se: E para, dëshmitari duhet të jetë kompetent dhe të dëshmojë për provën duke e pranuar ate. E dyta, provat duhet të jenë të pandryshueshme; dhe E treta, të jenë relevante. Nëse kjo nuk arrihet, avokati i mbrojtjes duhet të kundërshtojë dhe ta detyrojë prokurorinë të paraqesë baza. Nëse nuk paraqiten baza të duhura, atëherë hapi i ardhshëm është të lutet trupi gjykues të mos e përfill atë provë të caktuar. Kundërshtimet më fundamentale gjatë procedurës gjyqësore janë:

- jo relevante (p.sh. dëshmitari është pyetur ose ka dhënë përgjigje e cila nuk është e rëndësishme për lëndën në fjalë);

- mungesë njohurie (p.sh. dëshmitari është pyetur ose ka dhënë përgjigje për të cilën nuk ka njohuri themelore, për shembull një arsimtar në shkollë fillore i cili dëshmon për një aksident rrugor pyetet për cilësitë e ndonjë makine të caktuar);
- mungesë baze (p.sh. dëshmitari pyetet për ndonjë dokument të caktuar edhe pse autenticiteti i dokumentit ende s'është vërtetuar);
- dëshmitari ekspert jep mendime të panevojshme (mungesë njohurie) (p.sh. një ekspert mjekësor i cili ka specializuar në kardiologji pyetet të japë mendim për mirëqenien psikiatrike të të akuzuarit);
- deklarim i gabuar i faktit ose fakteve (p.sh. dëshmitari deklaron gabimisht për ndonjë fakt për të cilin ka prova bindëse, për shembull dëshmitari thekson se ka vendlindje tjetër nga ajo që është theksuar edhe në pasaportën edhe në certifikatën e lindjes së tij);
- dëshmitari bën spekulime (p.sh. dëshmitari pyetet supozojë përgjigjen e ndonjë pyetjeje, për shembull dëshmitari pyetet të japë mendim lidhur me vlerën e mallit që është plaçkitur);
- dëshmitari s'është i përshtatshëm (p.sh. dëshmitari është fëmijë ose psikikisht i sëmurë);
- dëshmitari nuk dëshmon nga njohuritë e veta (p.sh. dëshmitari bën raportimin e ndonjë deklaratë të bërë nga dikush tjetër për ta dëshmuar të vërtetën e çështjes, gjegjësisht, flet thashetheme);
- drejton (p.sh. shqyrtuesi në mënyrë të drejtpërdrejtë, me anë të pyetjeve të veta, i sugjeron dëshmitarit të vet të përgjigjet ashtu si do vet).

6. DHJETË URDHËRAT E KUNDËREKZAMINIMIT NGA IRVING YOUNGER¹³⁶

1. Të jeni të shkurt Të shkurtë, të qartë dhe të përpiktë. Pse? Arsyeja e 1-rë: të mos dështoni. Sa më pak kohë të kaloni gjatë marrjes së dëshmitarëve në pyetje, aq më të pakta janë shanset të dështoni. Arsyeja e 2-të: Një marrje në pyetje e thjeshtë nga ana e avokatit e cila do të ritheksojë pjesën e rëndësishme të rrëfimit absorbohet dhe kuptohet më së miri nga juria. Kurrë mos tentoni të realizoni më shumë se tre çështje gjatë marrjes së dëshmitarëve në pyetje (nga pala kundërshtare). Dy çështje janë më mirë se tre, kurse një çështje është më e mirë se dy.

2. Shfrytëzoni fjalë të rëndomta Juria mund t'i kuptojë pyetjet e shkurtra dhe fjalët e rëndomta. Hidheni fjalën 50 dollarësh në favor të fjalës 2 dollarësh. “Ngisni makinën tuaj” në vend që ta “operoni me makinën tuaj.”

3. Shfrytëzoni vetëm pyetje sugjestionuese Ligji i ndalon pyetjet sugjestive të cilat e përmbajnë edhe përgjigjen gjatë shqyrtimit të drejtpërdrejtë. Avokati nuk është kompetent të dëshmojë.

¹³⁶ Një sublimim nga arti i marrjes së dëshmitarëve në pyetje nga pala kundërshtare, përpilues Irving Younger. Seksioni “Seritë Monografike të çështjeve gjyqësore”, TNK. 1, botuar nga Shoqata e Dhomës së Avokatëve Amerikan, Seksioni çështjet gjyqësore, nga një fjalim i bërë nga Irving Younger në Kuvendin Vjetor të SHAA-s në Montreal të Kanadasë në gusht të vitit 1975, mund ta gjeni në vebfaqen <http://www.dayontorts.com/uploads/file/Younger%20on%20Cross—10%20Commandments.pdf>

Gjatë shqyrtimit të palës kundërshtare, ligji i lejon pyetjet që sugjerojnë përgjigje, kështu që i lejon avokatit t'i vendos fjalët e tija në gojën e dëshmitarëve. Prandaj, shqyrtimi i dëshmitarëve nga pala kundërshtare ju lejon të merrni kontrollin mbi dëshmitarin, ta çoni ju aty ku dëshironi dhe të vërtetoni çështjen tuaj të rëndësishme para jurisë. Mosparashtrimi i këtyre pyetjeve sugjestionuese lë tepër hapësirë të zbrazët. Çka ndodhi pastaj? Dëshiroj të qartësoj disa çështje të cilat i përmendët gjatë shqyrtimit të drejtpërdrejtë? Këto pyetje janë antitezat e një shqyrtimi efektiv nga pala kundërshtare. Çfarëdo pyetje që e lejon dëshmitarin të ritheksojë, shpjegojë apo sqarojë çështjet e bëra gjatë shqyrtimit të drejtpërdrejtë është gabim. Duhet ta bëni dëshmitarin në situatë të tillë që të duket sikur është vënë në autopilot, kështu që të gjitha përgjigjet t'i dalin në një sërë përgjigjeshpo! po! po!.

4. Të jeni të përgatitur Kurrë mos parashtroni pyetje, përgjigjen e të cilës nuk e dini. Marrja e dëshmitarëve në pyetje nga pala kundërshtare nuk është si një e shkuar në peshkim, por një punë gjatë së cilës zbuloni fakte ose surpriza të reja gjatë gjykimit.

5. Dëgjoni! Dëgjoni përgjigjen. Për disa, marrja në pyetje e dëshmitarëve të palës kundërshtare paraqet frikë aktorësh; kjo e bën mendjen konfuzë dhe prodhon panik. Zakonisht e keni të vështirë të parashtroni pyetjen e parë dhe, në përgjithësi, duke menduar për pyetjen e ardhshme ju s'e dëgjoni përgjigjen e parë.

6. Mos grindeni! Mos u grindni me dëshmitarin gjatë marrjes në pyetje. Kur përgjigja e pyetjes suaj është absurde, e rreme, apo e paarsyeshme dhe kontradiktore, ndaluni dhe uluni. Bëni ballë tundimit që të mos reagoni me fjalë: "si mund ta thoni këtë, ose si guxonit të jepni një deklaratë kaq mizore?" Shpesh herë përgjigja e ndonjë pyetjeje nxjerr ndonjë reagim, që nuk e shpjegon absurditetin dhe e rehabiliton dëshmitarin.

7. Shmangni përsëritjet! Kurrë mos e lejoni një dëshmitar të përsërisë atë çka e ka thënë gjatë shqyrtimit të drejtpërdrejtë. Pse? Sa më shumë që përsëritet, aq më të mëdha janë gjasat juria mos t'ju besojë. Marrja në pyetje e dëshmitarëve të palës kundërshtare duhet të përmbajë pyetje të cilat s'lidhen me shqyrtimin e drejtpërdrejtë. Ky shqyrtim s'duhet ta ndjek renditjen e pyetjeve të palës kundërshtare.

8. Mos lejoni shpjegime nga dëshmitari! Kurrë mos e lejoni dëshmitarin të japë shpjegime gjatë marrjes në pyetje nga avokati i palës kundërshtare. Këtë duhet ta bëjë oponenti juaj.

9. Kufizoni pyetjet! Mos parashtroni shumë pyetje. Ndaloni kur të keni realizuar qëllimin tuaj. Priteni arsyetimin e jurisë!

10. Kurseni për sublimim! Kurseni çështjen e fundit për sublimim. Marrja në pyetje e dëshmitarëve nga pala kundërshtare e cila është mirë e përgatitur, e qartë dhe me pyetje sugjestionuese që nuk e diskuton lëndën me dëshmitarët, më së miri mund të sublimohet më së miri në prezantimin e fundit para jurisë.

Rregullat e Irving Younger mund të duken themelore, ato janë relevante dhe efikase në çdo sistem akuzator. Natyrisht, magjia e një shqyrtimi të suksesshëm, bazuar në përmbajtjen e këtyre rregullave të thjeshta, është konstante: përgatitje dhe disiplinë. Ajo çka mund të thuhet nga e gjithë kjo është se çdo shqyrtim i dëshmitarëve të palës kundërshtare ka qëllimin e vet konkret. Asnjë lëndë nuk është prezantuar nëpërmjet një dëshmitari të vetëm gjatë një gjykimi. Më së shumti që mund të arrihet është të zhvillohen disa çështje relevante dhe thelbësore për teorinë e rastit. Pa marrë parasysh sa modeste të duket, kjo është esenca dhe qëllimi i një shqyrtimi të mirë të dëshmitarëve të palës kundërshtare.

LITERATURA

- ACKER, J. R./ BRODY, D. C.: Criminal Procedure - A Contemporary Perspective, Aspen Publ., Gaithersburg, Maryland, 1999.
- ARANELLA, P.: Rethinking the Functions of Criminal Procedure: The Earren and Burger Courts' Competing Ideologies, 72 Georgetown Law Journal, 1983, 185.
- R. BARBERINI/ A. XHORXHETI, Shqyrtimi kryesor i akuzës, Materiale nga projekti Tuining i prokurorisë publike për kriminalitet të organizuar, Ohër/Shkup, 2009.
- V. BAYER, Kazнено procesno pravo, odabrana poglavja, knjiga I: Uvod u teoriju kaznenog procesnog prava, Zagreb, 1995, 269;
- BUZHAROVSKA, G./ KALLAJXHIEV, G.: Reforma e procedurës penale, Përmbledhje e teksteve nga projekti për luftë kundër krimit të organizuar të prokurorisë publike, ISISC, Ohër 2009;
- COUGHLAN, S. G.: The Adversary System: Rhetoric or Reality?, 8 Canadian Journal of Law and Society, 1994, 139.
- DAMASKA, M.: O mjesanju inkvizitornih i akuzatornih procesnih formi, HLJKP, 2/1997, 387.
- DAMAŠKA, M.: Evidentiary Barriers to Conviction and Tëo Models of Criminal Procedure: A Comparative Study, 121 University of Pennsylvania Law Review, 1973, 506.
- DAMAŠKA, M.: The Faces of Justice and the State Authority, Yale University Press, New Haven/ London, 1986.
- DAMAŠKA, M.: Presentation of Evidence and Fact-finding Precision, 123 University of Pennsylvania Law Review, 1975, 1083.
- FRASE, R. S.: Comparative Criminal Justice Policy in Theory and in Practice, vo: Comparative Criminal Justice Systems, 17 Nouvelles études pénales, 1998, 109.
- FRIEDLAND, S.I./BERGMAN, P./TASLITZ, A.: Evidence Law and Practice, Lexis Nexis, 2004.
- GOLDSTEIN, A. S.: Reflections on Two Models: Inquisitorial Themes in American Criminal Procedure, 26 Stanford Law Review, 1974, 1009.
- KUNDËREKZAMINIMI - DORACAK PËR PROFESIONISTËT 97CROSS EXAM 02 AL [R3] 24.02.2011 13:24 Page 97
- GOODPASTER, G.: On the Theory of American Adversary Criminal Trial, The Journal of Criminal Law Criminology, Vol.78, No.1, 1987, 118.

- GRIFFITHS, J.: Ideology in Criminal Procedure or a Third “Model” of the Criminal Process, 79 Yale Law Journal, 19